# monumentet



XEROX COPY

2006

DO NOT COPY

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

# monumentet

botimet ideart
2006

DO NOT COPY

Redaksia:
Prof. Dr. Apollon Baçe - Kryeredaktor
Prof. Dr. Emin Riza - Sekretar Kolegjumi
Prof. Dr. Valter Shtylla - Anëtar
Edlira Çaushi
Latif Lazimi
Sulejman Dashi
Behar Gjoka - Redaktor letrar dhe gjuhësor

© Copyright: Instituti i Monumenteve të Kulturës
Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës
I.M.K. - Rruga "Sami Frashëri", Nr. 33
Tiranë, 2006

Në kopertinë: "Mozaik në Apoloni"
Foto: U. Çikopano

www.ideartlibri.com

botimet ideart
botime@ideartlibri.com
PO BOX 1532, Tiranë (AL)
Tel./Fax: ++355 4 23 32 05

# PASQYRA E LËNDËS


| | | |
|---|---|---|
| **Gjerak KARAISKAJ** | *Një kishë anzhuine në Brosh të Sarandës* | 5 |
| **Frederik STAMATI**<br>**Plikron THEODHORI** | *Llaçet e Kalasë së Petrelës* | 10 |
| **Emin RIZA** | *Gjurmë banesash në vendbanimin – rrënojë të "Bregut të Sterës"* | 27 |
| **Lazër PAPAJANI** | *Një rishikim për periudhat fillestare të disa kalave* | 47 |
| **Hysen IBRA** | *Teqja e madhe e Gjakovës dhe Teqja e Marash – Hisar në Prizren duhen vënë në mbrojtje shtëtrore* | 58 |
| **Valter SHTYLLA** | *Digat e vjetra në Shqipëri* | 68 |
| **Fejas DRAMÇOLLI** | *Xhamia e Hadumit* | 76 |
| **Skënder MIHALÇKA** | *Piktura e Ardenicës* | 86 |
| **Adrian ÇENE**<br>**Gentjan VOKOPOLA** | *Një Krisht i rrallë nën gëlqere* | 115 |
| **Mustafa ARAPI** | *Restaurimi i pikturës murale të realizuar nga Onufër Qiprioti dhe Alivizi, Foka në kishën Shën Mëria në fshatin Vrahogaranxi* | 125 |
| **Solinda KAMANI** | *Qeramika mesjetare dhe pasmesjetare e kishës e kishës së Shën Ndout* | 157 |
| **Uljam ÇIKOPANO** | *Mozaikë antikë e paleokristianë në Apoloni* | 172 |


DO NOT COPY

# CONTENTS


By **Gjerak KARAISKAJ** — Abstract ..... 9

By **Frederik STAMATI**
**Plikron THEODHORI** — Abstrackt ..... 26

By **Emin RIZA** — Homes at (Bregu i Steres)..... 46

By **Lazër PAPAJANI** — Evaluation on the first dating of some castles ..... 57

By **Hysen IBRA** — The "Big Tekke" of Gjakova and the Tekke "Marash Hisar" in Prizren should be under state protection ..... 67

By **Valter SHTYLLA** — Old dikes in Albania ..... 75

By **Fejas DRAMÇOLLI** — Hadum's Mosque in Gjakova (History, architecture, painting and stone plastics) ..... 85

By **Skënder MIHALÇKA** — The Monastery and fresco in Ardenica ..... 114

By **Adrian ÇENE**
**Gentjan VOKOPOLA** — Summary..... 124

By **Mustafa ARAPI** — Restoration of the wall painting in "Saint Maria" Church in Vrahogoranxi village realized by Onupher Qiprioti and Alivizi Foka ..... 156

By **Solinda KAMANI** — Abstract The medieval and post-medieval pottery from the church of st antonio..... 171

By **Uljam ÇIKOPANO** — Antic and paleochristian mosaics in Apolonia ..... 200


DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

# Një kishë anzhuine në Borsh të Sarandës

Monumentet e periudhës së sundimit anzhuin në Shqipëri, më tepër se të rralla, janë të pa identifikuara. Kjo edhe për faktin se një pjesë e tyre janë ndërtuar me teknikën vendase bizantine. Kur Karli I Anzhu në vitin 1280, 7 vjet pas rënies së tërmetit katastrofik në Durrës, urdhëroi të rindërtoheshin muret e kullat e Akropolit, ai porositi të merreshin punëtorë dhe teknikë vendas për kryerjen e punimeve. Një shembull tipik i një ndërtimi me teknikën bizantine të kohës është "Ura e Frëngut", emërtimi i së cilës të kujton menjëherë periudhën anzhuine. Një kala e ndërtuar në Cakran të Fierit, e cila zotëronte një zonë bujqësore, gjithashtu nuk paraqet tipare të veçanta, por nga gërmimet e kryera nga Skënder Muça, ka rezultuar se monedhat i përkisnin principatave latine të lindjes dhe kapnin periudhën nga viti 1274 deri 1301, që përkon me sundimin anzhuin në këto zona.

Gjithashtu kisha "Shën e Premte" në Çetë të Kavajës, e stilit romaniko-gotik, unikale për gjithë zonën duhet të jetë një ndërtim anzhuin. Vlen të përmendim dhe kishën "Shën Kolli" në Manastirin e Mesopotamit, në dyshemenë me pllaka guri të së cilës janë ruajtur gdhendje të luleve të zambakut që ishte simboli i anzhuinëve.

Disa elementë në kalatë tona mesjetare siç janë erkerët prej druri dhe hurdet, të cilat i hasim në Durrës, Bashtovë, Krujë, Petrelë dhe Butrint, do të na çonin në të njëjtin përfundim, por në disa raste ato i gjejmë edhe në fortifikime për artileri, si dhe janë mjaft të përhapura në arkitekturën popullore deri në shek.XIX edhe në zona të thella malore. Kështu që nuk mund të themi asgjë të sigurtë rreth përkatësisë së këtyre ndërtimeve.

Në vitin 1285 anzhuinët braktisën Durrësin, Vlorën dhe Kaninën1, por siç tregojnë të dhënat nga Kështjella e Mashkjezës në disa vende ata duhet të kenë qendruar, deri në fund të shek.XIII.

Fati i Sopotit (Borshi i sotëm) në periudhën anzhuine është i lidhur në një masë të madhe me atë të Butrintit. Anzhuinët u vendosën përfundimisht në Butrint dhe Sopot në vitin 1279, kur këto qendra iu dorëzuan atyre nga despoti i Epirit Niqifori I. Më 7 dhe 12 prill të këtij viti në Sopot u dërguan nga anzhuinët armë dhe ushqime2.

Në vitin 1284 kështjellar i Sopotit ishte Gyjome de Brevia, i cili varej nga kapiteni i ishullit të Korfuzit, Butrintit, Sopotit dhe Himarës. Ndërsa në Butrint anzhuinët qëndruan gjatë. Sopoti nuk dihet nëse përfshihej nën sundimin e tyre ende pas vitit 1287.

Zanafilla e kësaj qendre, një qytet antik i rrethuar me mure me sipërfaqe prej 3ha,



Fig. 1

ka kushtëzuar një popullim të hershëm të një zone relativisht të gjerë ku përfshihej edhe territori i fshatit të sotëm të Borshit. Jashtë mureve të kalasë antike ka patur banesa e ndërtime të tjera në vendin ku ndodhet sot Borshi si dhe në tarracat nën të, në drejtim të detit, ndërsa rreth 2km në juglindje të qendrës administrative të Borshit ishte ndërtuar stacioni romak Akrokeraunia. Pikërisht, fare pranë këtij të fundit, ndodhen rrënojat e një kishe të cilën e gjykojmë si të periudhës anzhuine.

Vendi ku ndodhet kisha quhet Vonja. Prej saj ruhet vetëm apsida drejtkëndëshe, e cila orientohet nga lindja. Muret 80cm të gjerë janë ndërtuar me gurë pllоçakë, gjysmë të punuar të vendosura në rreshta të rregullta horizontale e të lidhura me një llaç shumë të fortë. Apsida është 4,45m e gjerë dhe ruhet në një gjatësi prej 6m. Ajo mbulohej me qemer cilindrik, gjurmët e të cilit ruhen qartë në murin lindor të saj (fig.1). Muret perimetrale arrijnë lartësinë 2.80m. Në të dy muret anësore të apsidës hapeshin dy porta të cilat qëndronin përballë njëra-tjetrës. Nga porta veriore ruhet një pjesë e harkut dhe njëra nga paturat (fig.2). Harku formohet nga gurë pllоçakë të latuar që kanë një gjatësi 30cm dhe gjerësi 6cm. Me gurë të punuar, por më të gjerë kanë qenë ndërtuar dhe paturat e portës. Nefi kryesor i kishës, që shtrihej në drejtim të perëndimit, nuk ruhet më. Shkaku i zhdukjes së



Fig. 2

DO NOT COPY

pjesës kryesore të kishës mund të jetë shkarja e dheut, pasi ajo ka qenë e orientuar në drejtim pingul me shpatin e kodrës. Gjurmë muresh në nivelin e themeleve ruhen 10m larg apsidës në drejtim të perëndimit. Por në gjendjen që ato ruhen nuk mund të themi me siguri nëse i përkasin kësaj kishe apo ndonjë kishe tjetër më të hershme bizantine.

Forma drejtkëndëshe e apsidës, si dhe teknika e ndërtimit me gurë të gdhendur e mospërdorimi i tullave edhe tek harqet, e inkuadrojnë kishën në stilet perëndimore të ndërtimit, që në rastin konkret do t'i shkonte periudhës së sundimit anzhuin të Sopotit.

Anzhuinët gjatë periudhës së sundimit të tyre në Shqipëri themeluan kuvende e



*Në ekspeditë*



*Në ekspeditë*

manastire katolike si dhe krijuan rezidenca të feudalëve frengj të cilët shfrytëzonin tokat bujqësore të dhëna në pronësi.

Por vërehet se menjëherë pas largimit të tyre nga Shqipëria këto ndërtesa që ndodheshin jashtë dhe rreth qyteteve u braktisën tërësisht. Këtë e tregon kështjella e Mashkiezës që pati jetë vetëm një çerek shekulli si dhe kisha "Shën e Premte" në Çetë të Kavajës e cila rezultonte e braktisur deri nga fundi i shek.XVII, kur u riparua dhe u vu në shërbim të klerit ortodoks. Të njëjtin fat duhet të ketë patur dhe kisha e Borshit, emri i së cilës mbetet i panjohur.

1. Historia e popullit shqiptar I, 2002, fq.244.
2. F.Carabellese, Carlo d'Augio nei raporti politici e comerciali con Venezia e l'Oriente, Bari 1911, f.84.

DO NOT COPY

DO NOT COPY









*Pamje të ndryshme nga një ekspeditë*

# Abstract

More than being rare, the anzhuine monuments in Albania are unidentified, because a part of them are built with local Byzantine techniques. "Ura e Frengut"(French Bridge,), "Kalaja e Cakranit "(Cakrani Castle), may be defined as belonging to anzhuine period,

first, because of the name and second, because of the results of the archaeological excavations. In the most distinct complexes of monuments of anzhuine period, there are included only the churches that are off-side the traditional catholic regions. An example of such belonging is "Shen e Premte" church ("Saint Friday" church) in Cete village of Kavaja, built in the Romanic-Gothic style.

The traces of an anzhuine church are found in Saranda's Borsh, in a terrace which is located in the south of today's administrative centre, above the national road that connects Borshi with Saranda. From the church it has been preserved the triangular apse, which is covered with cylindrical ceiling. In the outside walls of the apse, there are maintained the traces of two ports facing each-other. The church is dramatically damaged. The size of the church is not clear. The apse is preserved with a length of 6m and it is 4.45m wide.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Frederik STAMATI
Polikron THEODHORI

# Llaçet e Kalasë së Petrelës

Në literaturën e botuar në Shqipëri kemi dy studime për kalanë e Petrelës, atë të Damian Komatës,[1] dhe atë të bashkëautorëve Apollon Baçe dhe Gjerak Karaiskaj.[2]

Këto studime japin, në këndvështrime të ndryshme historinë e kalasë, në zhvillimin ekonomik-social të epokës dhe ndërtimin e rindërtimin e saj, deri në ditët e sotme.

Studimi i tretë për këtë kala, ky që po paraqitet në këtë shkrim synon të sqarojë çështje të teknologjisë së ndërtimit të kalasë, e sidomos të përdorimit të materialit lidhës, siç është llaçi. Është hera e parë që ne paraqesim një studim të tillë. Jemi të bindur se metodika e përdorur, mbështetur në burime të literaturës dhe konkluzionet tona, do të jenë një shtysë për studime të tjera në këtë fushë dhe do të japin në të ardhmen të dhëna për historinë e materialeve të ndërtimit në vendin tonë.

Sipas Prashnikerit dhe Shaberit kalaja e Petrelës i ka fillimet e saj në shek.II-III, ose në shek.IV-VI, sipas A.Baçes dhe Gj.Karaiskajt, dhe fundin në shek. XIX. Në këtë periudhë kohore ajo është zgjeruar me mure, kullla, stera, etj., është shembur vende-vende e është meremetuar disa herë. Nga kjo lindin edhe vështirësitë për të përcaktuar fazat ndërtimore. Por tani analizimi petrografik apo teknologjik i llaçeve të përdorura na ka dhënë shanse për të kuptuar më mirë ndërtimin e saj dhe për të bërë një restaurim sa më të mirë.

Në studimin e A.Baçes dhe të Gj.Karaiskajt jepen gjashtë faza ndërtimore në kalanë e Petrelës.

Ato janë:

Faza I. Kulla e vrojtimi Nr.1, ose kulla perëndimore, shek.IV-VI.

Faza II. Muri "KLABCDGH", i ndërtuar në mesjetë.

Faza III. Kulla lindore, Nr.3, si dhe muri EF, të shek.XI-XII.

Faza IV. Muri rrethues i jashtëm, që fillon nga porta e hyrjes, ndërtuar në shek.XV.

Faza V. Muri që vesh kullën lindore dhe perëndimore, si dhe murin që lidh këto dy kulla, të shek.XV-XVI.

Faza VI. Mure gjoks mbrojtës "DGH" dhe "IKL", ndërtuar në shek.XVII-XIX.

Në studimin tonë ne u bazuam në këtë përcaktim të zhvillimit kohor të kalasë së Petrelës. Kampionet e llaçit për analizë u morën në ndërtimet më të padyshimta të fazave më me interes, nga artikullshkruesit nën drejtimin e Prof. dr. Gj.Karaiskaj.

Tre janë qëllimet tona:

1. Të përcaktojmë teknologjinë e përgatitjes së materialit lidhës llaç, në faza të ndryshme ndërtimore.

2. Të vërtetojmë me anën e analizës petrografike

se komponentët përbërës të llaçit tregojnë ndërtime të së njëjtës fazë.

3.Të japim ndihmesën tonë, nëpërmjet përfundimeve të studimit, që të realizohet në kalanë e Petrelës një restaurim i pranueshëm, me materiale afërsisht të njëjta me ato origjinale, për të zbutur bymimin dhe tkurrjen që lind në ndërtime gjatë lëvizjes së temperaturës.

Studimi ynë është petrografik për të përcaktuar llojin e materialeve(shkëmb zhavorrit) dhe kimik për të përcaktuar ndikimet e elementëve në cilësinë e llaçit.

Më poshtë po japim petrografinë e llaçeve, realizuar nëpërmjet studimit të shlifeve të përgatitur në mikroskop petrografik.

**Shlifi Nr.1**, përfaqëson "llaçin" midis tullave të kullës perëndimore të kalasë së Petrelës, të fazës së parë të ndërtimit (foto 1). Ky "llaç" petrografikisht mund të përcaktohet:

-Ranor, kokërvogël dhe imët, karbonat-feldspat-kuarcor (zotëron kuarci), me një matrix mergelor të bollshëm, i cili përbën 45-50% të volumit.

*-Klastet karbonatë janë gëlqerorë e mergele* mikrofaunë (e pa përcaktueshme me ruajtje shumë të keqe, Globigerina (?),apo radiolaria (?) *të rikristalizuar* e nganjëherë *të dolomitizuar* në dolomikrosparit, klaste *feldspate* më tepër në trajtën e kristaloklasteve shpesh të sericitizuar; *kuarc* në kristaloklaste e klaste kuarci polikristalin. Shumë rrallë vërehen klaste, olevroliti feldspat kuarcor me matrix siricitik të pa përfillshëm.

*-Matrixi mergelor ka një strukturë të fshehtë pseudonodulare* (vende-vende) dhe "sfera" planktonikësh të imët me ruajtje shumë të keqe. Përgjithësisht ky matrix është i tipit calcimudstone.

Kështu për përgatitjen e llaçit të kullës 1 është përdorur rërë heterogjene e shtratit të lumit Erzen me përbërje karbonate, feldspate e silicore. Në këtë lloj rëre, në rolin e argjilë-gëlqeres kanë shërbyer mergelet e coptuar, duke formuar një lloj gëlqere jo të shuar plotësisht (gjë që dëshmohet nga prania e pseudonadulave të mergelit primar në "matrix", "mergelor" të sotëm).

**Shlifi Nr.2**, përfaqëson llaçin e suvasë në një frengji të katit të dytë të kullës perëndimore të kalasë së Petrelës, e fazës së parë të ndërtimit (foto 2). Petrografikisht ky llaç mund të përcaktohet si një:

*-Konglomerat zhavorr, me klaste karbonatë, matrix mbështetës*, ku "matrixi" përfaqëson një ranor heterogjen *me matrix mergelor* të bollshëm, *që përbën 30-35% të volumit të shkëmbit.*

*-Klastet e mëdhenj* të granulometrisë 2mm diametër, *janë mergele me planktonikë* (tip Globigerina sp. të Kretës së sipërme-Paleogjenit), shpesh të rikristalizuar e dolomitizuar duke zbehur së tepërmi strukturën fillestare depozicionale të tyre. Përgjithësisht janë të rrallë. *Klastet* e granulometrisë "ranore" janë heterogjenë; klaste *karbonatë* si klastet zhavororë, klaste *ranorë kokërrimtë-alevrolite me përbërje feldspat kuarcorë* e matrix serecitik të pa përfillshëm; klaste *feldspate* në trajtë kristaloklastesh nganjëherë me binjakëzim të shpeshtë polisintetik e shpesh të secricitizuar, si dhe klaste *kuarci* në trajtën e kristaloklasteve, klaste kuarci polikristalin etj.

*-Matrixi mergelor*, vende-vende është i tipit mudstone e vende-vende tip calcimudstone. Ky matrix është i bollshëm, e në relacion me klastet e vegjël të imët, edhe në këtë rast, formon një strukturë petrografike "matrix mbështetëse".

Kështu sipas shlifit Nr.2, suvaja e "llaçit" të kullës romake në kalanë e Petrelës është përgatitur duke marrë nga shtrati i Erzenit pak zhavor karbonat por më shumë "rërë" (rërë karbonate, rërë silicore, rërë kuarci), në të cilën pastaj është shtuar argjilë-gëlqerja e përgatitur nga pjekja e gëlqerorëve mergelorë me planktonikë.

**Shlifi Nr.3**, përfaqëson "llaçin" e suvasë së sterës së ujit të kullës perëndimore, të kalasë së Petrelës

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të fazës së parë të ndërtimit (foto 3). Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*Mikronglometrat hererogjen me "matrix ranorik" i përbërë nga klaste kaurci dhe lëndë lidhëse të bollshme merglore.*

*-Fragmentet shkëmbore* (Lithoclastet) me sortim të keq, gjysëm të rrumbullakuar, të madhësisë zhavorore më shumë se 2mm. Diametër, përfaqësohen nga: *ranorë* kryesisht kuarcorë, *deri në alevrolite* dhe shkëmbinj mudrocks; *gëlqerorë* të facies neritike, *silicorë radiolaritë deri radiolarite* me pigment të kuq hematitik, *efuzivë*(?) të ndryshuar etj.

*"Matrix-i"* (në kuptim relativ, ose lënda lidhëse e zhavoreve të përcaktuara më lart, përfaqësohet nga klaste më të vegjël, më të imët, kryesisht *kuarci e kuarcitesh* të madhësisë ranore e alevrite, më të vogla se 2mm diametër) *të lidhur me një lëndë lidhëse meglore*, (përzierje e argjilës me karbonat kalciumi, në raport afërsisht 1:1).

Ky lloj matrixi, gjykuar sipas shlifit të përgatitur, përbën 35-40% të volumit të llaçit duke krijuar kështu një material ndërtimi në trajtën e një mikrokonglomerati heterogjen matrix mbështetës.

**Shlifi Nr.4**, i përket sterës Nr.8 të kalasë së Petrelës të fazës së dytë të ndërtimit (foto 4).

*Ranor*, kokërr vogël-imët, *karbonat-fledspat-kuarcor, me një matrix mergelor të pakët*, interklastik-interkristal klastik që përbën jo më shumë se *10-15% të volumit*.

*-Klastet e granulometrisë ranore* (përgjithësisht 0,5-1mm diametër) *janë jo të sortuar. Ata të përbërjes karbonate janë gëlqerorë e mergele* me planktonikë të zbehtë, sepse gjithmonë janë të prekur nga rikristalizimi, por *në dallim nga klastet e feldspateve e kuarcit ata janë gjysëm të rrumbullakuar*. Të jepet përshtypja e mergeleve me radiolarë(?) apo me planktonikë (?). *Klastet e "rërës silicore"* (klaste e kristaloklaste silicore, kuarci, kuarci polikristalin, feldspati) *gjithmonë janë disi të sortuar* (midis 0,5-1mm diametër), *por gjithmonë janë jo të rrumbullakuar*, pra një "rërë" tipike lumore, e sjellë në shtratin e lumit nga një transport jo shumë i largët.

*-Matrixi mergelor, i pakët*, duket se është përgatitur nga "pjekja" në furrat që përdornin gëlqerorë mergelorë/mergele të llojit calcimudstone (në mikroskop ruhen pseudonodula mergeli me konture jo të rregullt, që ndoshta paraqesin një gëlqere jo plotësisht të shuar.

Kështu llaçi i sterës së ujit Nr.8 është përgatitur me "rërën" karbonate e silicore të lumit Erzen, në pjesën dërrmuese të volumit të llaçit, e megjithëse formon një strukturë petrografike klast mbështetëse (kokërrzat e "rërës" kontaktojnë me njëra-tjetrën), prapëseprapë ky lloj matriksi lidhës është i fortë.

**Shlifi Nr.5**, është përgatitur nga materiali lidhës "llaç" i murit pranë portës së hyrjes në kala, që ndan ndoshta një sterë uji, faza III e ndërtimit (foto 5). Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*-Konglomerat gëlqeror, me klaste të granulometrisë zajore-zhavorore të rrallë, (matrix mbështetës), me "matrix ranor" ku "rëra" (kryesisht silicore e karbonate) është e lidhur me një lëndë lidhëse matrix mergelor, në sasi fare të pakët, 10-15% të volumit.*

*-Klastet*, janë *zhavor deri zaje gëlqerori* biokalkarenit (nuk dallohet microfacies i tyre) me formë të zgjatur deri 12-13 mm. gjatësi, duke shprehur origjinën lumore, si tek shlifi 6 që përcaktohet më poshtë. Këta klaste të mëdhenj të rrumbullakuar, sipas shlifit 7, që përcaktohet më poshtë besohet se përbëjnë 10-15% të volumit.

*"Matrixi ranor" i përfaqësuar nga klaste të granulometrisë ranore* (2mm diametër, në shlifin 5 mesatarisht janë 0,5-0,8mm diametër), nga të rrumbullakuar në jo të rrumbullakuar me qoshe-qoshe, përfaqësohet *nga karbonate të ndryshuar*, por sidomos me klaste *të përbërjes silicore* (klaste e kristaloklaste të *kuarcit*, feldspateve,

klaste ranori kokërrimët/*alevroliti* e shumë rrallë *amfiboli e volkanikë bazaltikë* të ndryshëm. "Rëra" heterogjene, që u përmend më lart, është lidhur me një "matrix mergelor" të paktë. Kjo "rërë" në relacion me këtë lëndë mergelore (matrix mergelor) ka më tepër një strukturë petrografike klastmbështetëse. Kështu, me sa duket në përgatitjen e llaçit janë marrë nga shtrati i Erzenit në sasi të paktë zaje të vegjël karbonati e zhavor karbonat nga lumi, por më tepër "rërë" lumore heterogjene (më tepër me përbërje silicore); këtij materiali i është shtuar argjilë-gëlqere, përgatitur nga mergele jo plotësisht të shuar (gëlqere jo plotësisht e shuar gjë që duket në mikroskop në trajtën e mbetjeve pseudonodula të gëlqeroritt/ mergelit primar.

**Shlifi Nr.6**, përfaqëson llaçin e përdorur në portën e hyrjes kryesore, të kalasë së Petrelës faza IV e ndërtimit (foto 6).Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*Mikrokonglomerat heterogjen, me "matrix" ranorik-merglor.*

*-Fragmentet shkëmbore* (Lithoclastet) *këtu janë më të rrallë*, ata përfaqësohen pak a shumë po ata lloj shkëmbinjsh si në shlifin Nr.1.

*"Matrix-i"* , një përzierje klastesh *kuarci*, e më *rrallë karbonati e* mudrocks, në këtë rast përbëjnë pjesën më të madhe të volumit të llaçit, 65-75% të tij.

**Shlifi nr.7**, përfaqëson "llaç" nga muri i jashtëm rrethues i kalasë së Petrelës, faza IV e ndërtimit (foto 7).Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*-Konglomerat me klaste të granulometrisë së zhavorit* (klaste ranori kokërrimtë-alevroliti, të rrallë me matrix ranor të bollshëm (matriks mbështetës), *i cili përbën* sipas shlifit 10, që përcaktohet më poshtë *deri 85% volumit*.

*-Klastet*, në pjesën më të madhe *janë të granulometrisë ranore*, pra kemi të bëjmë më tepër me një ranor se sa me një konglomerat zhavoror. Klastet janë *gëlqerorë neritikë algalë*, gjysëm të rrumbullakuar deri të rrumbullakuar; *kristaloklaste kuarci, klaste kuarci polikristalin, klaste volkanikësh bazaltikë* të vetmuar; *kristaloklaste feldspati* të sericitizuar, të rrallë. Disa klaste janë zëvëndësuar me hematit. Sortimi e rrumbullakimi i klasteve në përgjithësi është i keq.

*-"Matrixi ranor"* i emërtuar më lart, këtu ka , sikurse edhe në rastet e tjerë, një kuptim relativ. Klastet e përcaktuar më lart të granulometrisë ranore janë lidhur me një matrix mergelor të bollshëm, duke formuar një strukturë petrografike më tepër "matrix mbështetës" se sa klast mbështetëse. Raporti "rërë"/matrix mund të vlerësohet afërsisht 1:1.

Kështu, "llaçi" brenda portës së hyrjes në Kalanë e Petrelës është "gatuar" me "rërë" karbonate e "rërë" silicore, që duhet të jetë marrë nga shtrati i lumit Erzen. Këtij materiali klastik lumor i është shtuar një sasi afërsisht e njëllojtë gëlqere, përgatitur nga gëlqerorët argjilorë që ndodheshin aty pranë, por më tepër nga gëlqerorë të pastër, të llojit calcimudstone me përqindje më të lartë të$CaCO_3$ apo $CaMgCO_3$.

**Shlifi Nr.8**, përfaqëson llaç nga muri i jashtëm rrethues i kalasë së Petrelës, pranë frengjive, faza IV e ndërtimit (foto 8). Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*-Ranor, kokërrimët-vogël, me klaste e kristaloklaste të bollshëm të përbërjes silicore, me një matrix mergelor* të bollshëm i cili përbën *55-60% të volumit të shkëmbit*.

*-Klastet e granulometrisë ranore* (jo më pak se 1mm diametër) dhe më të vegjël, të granulometrisë alevrite (1/16mm), janë *klaste olevroliti feldspat-kuarcor me matrix* sericitik të pa përfillshëm, të rrallë; *klaste kuarci polikristalin të shpeshtë; kristaloklaste kuarci të bollshëm; kristaloklaste feldspati* të rrallë; *klaste silicori radiolarit, të rrallë; klaste serpentiniti të vetmuar*, si dhe *klaste gëlqerori neritik e pelagjik* në shkallë të ndryshme të ndrtyshuar, të rrallë.

DOZO COPY

DO NOT COPY

Klastet e mësipërme kanë një sortim mesatar, por një rrumbullakim të keq, deri një rrumbullakim disi i mirë (klastet e kristaloklastet e kuarcit, eldspatit, silicorëve).

*-Matrixi mergelor* në përqindje pak më të madhe volumetrike në krahasim me klastet me afërsi, mund të vlerësohet në raportin 1:1. Ky lloj matrixi, sipas shlifit 8 është i tipit calacimudstone.

Kështu, "llaçi" pranë fregnjive tek porta e hyrjes së kalasë së Petrelës është përgatitur kryesisht me "rërë" të përbërjes silicore që është marrë nga shtrati i lumit Erzen. Kësaj rëre lumore besohet t'i jetë shtuar si material lidhës gëlqerja e përgatitur nga furrat e pjekjes duke shfrytëzuar gëlqerorët relativisht të pastër që gjenden aty pranë.

**Shlifi Nr.9**, përfaqëson "llaçin" pranë portës anësore të murit të jashtëm rrethues të kalasë së Petrelës, faza IV e ndërtimit (foto 9).Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*-Ranor, kokërvogël-imët, karbonat-feldspat-kuarcor (zotëron kuarci), me një matrix mergelor të bollshëm të tipit mudstone-Calcimudstone, i cili përbën 60-65% të volumit.*

*-Klastet,* jo të sortuar, jo të rrumbullakuar përfaqësohen: nga kuarci (kristaloklaste kuarci, klaste kuarci polikristalin, klaste mikrokuarci), nga feldspati (kristaloklaste gjithmonë të ndryshuar në minerale argjilorë-sidomos të stericitizuar dhe më pak nga "klaste karbonati" (gëlqerorë e mergele biomikritikë shpesh të dolomikritizuar, me sa duket mergele me mikrofosile të moshave gjeologjike të reja, tani me ruajtje shumë të keqe të pa përcaktueshme, ndoshta globigerina sp).

*-Matrix-i mergelor* është i bollshëm dhe ka *një strukturë petrografike "matrix mbështetëse"*.

Mund të thuhet se në përgatitjen e "llaçit" pranë portës anësore të murit të jashtëm rrethues të kalasë së Petrelës është marrë "rërë" heterogjene (por me zotërim kuarci) nga shtrati i Erzenit (ajo është rërë tipike lumore jo e rrumbullakuar). Kësaj rëre i është shtuar një sasi më e madhe argjile dhe gëlqere (por me sa duket më shumë gëlqere, gjë që duket nga klastet e zbehtë të mergeleve tip calcimudstone- që duhet të ishte një gëlqere jo plotësisht e shuar).

**Shlifi 10**, përfaqëson llaçin e marrë në pjesën e poshtme të murit të kullës lindore, të kalasë së Petrelës faza e V e ndërtimit (foto 10). Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*-Konglomerat zhavor, silicorkarbonat, me matrix ranor.*

*-Klastet e mëdhenj* të granolometrisë zhavorore më shumë se 2mm diametër *janë klaste gëlqerorësh me foramireferë tip Amphistegina, Miogiposinoides etj.* që rrjedhin nga gëlqerorë *të Oligocenit terminal, si dhe klaste ranori kokërrimtë-alevroliti feldspat-kuarcor* që rrjedhin nga facies terrigjene të Paleogjenit.

*-"Matrixi ranor" përfaqësohet nga klaste të madhësisë ranore e alevrite* ( me "rërë" karbonate: klaste gëlqerori të ndryshme, mergeli me planktonikë, me "rërë" silicore; klaste e kristaloklaste kuarci e feldspati me sortim rrumbullakim mesatar e të keq të *lidhur me një sasi të bollshme lënde merglore tip calcimudstone (matrix mergelor), i cili në lidhje me klastet e përmendur më lart afërsisht është në raportin 1:1* duke formuar një strukturë petrografike "matrix mbështetëse" (klastet nuk kontaktojnë me njëri-tjetrin).

Kështu, sipas shlifit 10, "llaçi"tek kulla lindore faza e V$^{të}$ e ndërtimit e kalasë së Petrelës është i përgatitur me pak zhavor heterogjen (karbonat e silicor), me më shumë "rërë" karbonate e "rërë" silicore të marrë në shtratin e Erzenit ("rëra" është tipike lumore, jo e rrumbullakuar, me qoshe-qoshe), duke shtuar pastaj argjilë-gëlqeren me sa duket nga pjekja e mergeleve në furrat e përgatitjes së gëlqeres. Kjo gëlqere e shuar (matrixi mergelor) sipas shlifit 10 duket se përbënte 40-45% të volumit të këtij "llaçi".

**Shlifi Nr.11**, përfaqëson llaçin e marrë në pjesën e sipërme të kullës lindore, faza e V e

ndërtimit (foto 11). Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*-Konglomerat zhavoror me "matrix" ranor, matrix mbështetës.*

*-Klastet* e mëdhenj në shlifin 11, me granulometri të zhavorit deri tek zajet (më shumë se 2mm, që arrijnë deri 12mm.) janë *mergele* me mikrofaun (ky lloj zalli në shlifin 11 ka rrumbullakim të mirë e formë të zgjatur duke shprehur qartë origjinën e tij lumore), *ata janë zaje me mikrofosile Globotruncana sp. të Kretës së sipërme, nga zona tektonike e Kastës.*

-*"Matrixi ranor"* (termi "matrix ranor" duhet konsideruar në relacion me klastet e mëdhenj të granulometrisë së zhavorit e zajeve), *përfaqësohet me klaste karbonate* (gëlqerorë, e mergele), *por sidomos me klaste e kristaloklaste* (ranori kokërrimtë) alevroliti feldspatkuarcor, *silicor* radiolarit e në ndonjë rast klaste *volkanikësh bazaltikë* të ndryshuar. Të gjithë këta klaste, *kjo "rërë" heterogjene, është e lidhur me një sasi lënde mergelore më të pakët në krahasim me shlifet e tjerë të analizuar* (me një matrix mergelor i cili në relacion me klastet e përmendur më lart të granulometrisë ranore formon një strukturë petrografike më tepër klastmbështetëse, (klasti mbështetet tek klasti).

Kështu llaçi i përdorur në kullën lindore të kalasë së Petrelës sipas shlifit 11, është përgatitur me pak zhavor karbonat, por në pjesën dërmuese me "rërë" karbonate e sidomos "rërë" silicore nga shtrati i lumit Erzen. Këtij materiali klastik i është shtuar argjilë-gëlqerë (matrix mergelor). Raporti klaste/matriks mergelor, duket se ka qenë afërsisht 3 me 1.

**Shlifi Nr.12**, përfaqëson llaçin e marrë në pjesën e poshtme të kullës jugore të kalasë së Petrelës, faza V e ndërtimit (foto 12). Petrografikisht ky llaç mund të përcaktohet si një:

*-Konglomerat zhavoror, heterogjen me "matrix ranor" me strukturë petrografike matrix mbështetëse.*

*-Klastet e mëdhenj* të madhësisë zhavorore (në shlifin 12 janë më të mëdhej se 2mm., duke aritur deri në 4mm diametër) *janë gëlqerorë e mergele*, nganjëherë me mikrofosile Globigerina e Globorotalia sp. të *Kretës së Sipërme –Paleogjenit*, gjysëm të rrumbullakuar, të ardhur nga zona gjeologjike (tektonike) e Krastës, *e më rrallë klaste ranorë* karbonat feldspat kuarcorë, të molasave.

*Klastet e grundometrisë ranore* (të rërës kokërrtrashë 1-2mm. diametër dhe "rërës" me granulometri më të vogël, si kokërrmesme, kokërrvogël, kokërrimët më të vegjël se 1mm diametër), me rrumbullakim mestar dhe të mirë përfaqësohen nga mergele biomikritikë me Globigerina klaste *ranorë e alevrolite* feldspatkuarcorë, apo *kuarc feldspatore,* klaste kuarci polikristalin, kristaloklaste kuarci e feldspat, klaste,*silicorë radiolaritë; më rrallë ndeshen klaste serpentiniti dhe volkanikë bazaltikë.*

*-Matrixi mergelor*, tip calcimudstone, sipas shlifit 12 përbën deri 45% të masës. Në raport me klastet e përcaktuar më lart, ky matrix është i bollshëm, duke formuar në tërësi për gjithë llaçin një strukturë matrix mbështetëse.

Kështu, llaçi tek kulla jugore e kalasë së Petrelës është përgatitur me "zhavor" e "rërë" heterogjene (më tepër rërë karbonate). Materiali klastik është marrë nga shtrati i lumit Erzen dhe në të është shtuar një sasi e konsiderueshme argjile-gëlqereje tip calcimudstone (gati 45% të volumit).

**Shlifi Nr.13**, përfaqëson llaçin e marrë në pjesët e meremetuara të kalasë së Petrelës mbi murin me tulla të fazës së I të kullës jugore, faza e V-të e ndërtimit (foto 13). Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*-Ranor, kokërrimët-vogël, kuarc-karbonat* (zotërojnë klastet karbonatë të granulometrisë së vogël ranore) *në një matrix mergelor* të tipit calcimudstone, *i cili përbën gati 50% të volumit të shkëmbit.*

*-Klastet* karbonate *janë gëlqerorë të rikristalizuar*

DO NOT COPY

DO NOT COPY

(vështirë të dallohet struktura primare depozicionale e tyre), klaste kuarci (kaurci polikristalin, kristaloklaste kuarci), *ranorë kokërrimët* (feldspat-kuarcorë) që kalojnë *deri në alevrolite* (me po atë përbërje minerale) *dhe ndonjë klast* i rrumbullakuar volkanik bazaltik.

*-Matrixi mergelor, në të vërtetë janë klaste mergeli* të madhësisë së vogël *ranore*, të rrumbullakuar, që kontaktojnë ngjeshur me njëri- tjetrin. Këta klaste mergeli të matriksit (që *të volumit*.

*-Klastet* e granulometrisë ranore, të rrumbullakuar, (*mezi duket të jenë gëlqerorë me foraminiferë e planktonikë të imët*), zakonisht janë të rikristalizuar; *disa klaste të tjerë janë silicorë* radiolaritë (?) të karbonatizuar, *klaste shistemetamorfike* mikore kuarcore; *klaste të metamorfizuar kuarcamfibolite*, ndonjë klast *radiolarit i kuq hematitik, kristaloklaste të imët kaurci*, tepër të rrallë.

***Përmbajtja e elementëve në%***

| Vendndodhja | $SiO_2$ | $Al_2O_3$ | $Fe_2O_3$ | $TiO_2$ | CaO | MgO | $Na_2O$ | $K_2O$ | Humbjet gjatë kalcinimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shtresa e sipërme në kullën jugore | 38.77 | 4.22 | 1.78 | 0.10 | 28.93 | 2.01 | 0.61 | 0.78 | 22.20 |
| Nyjmtëu i perëndimit të vonë anake | 41.12 | 10.64 | 4.87 | 0.40 | 19.60 | 2.62 | 0.61 | 1.14 | 18.70 |

mezi dallohen, në mikroskop) formojnë strukturën e një calcimudstone grainstone. Kështu, llaçi i përdorur për meremetim tek kulla romake është përgatitur duke marrë nga shtrati i lumit Erzen "rërë" prej karbonati e kuarci me granulometri të vogël 0,5-0,8mm. diametër. Kjo është "rëra lumore" tipike (me rrumbullakim të keq përgjithësisht). Për lidhjen e kësaj "rëre" është përdorur argjilë gëlqere (mergel i tipit calcimudstone; gëlqere jo plotësisht e shuar sepse ajo formon në shlifin 13 një matrix granular, granular të fshehtë që mund të jetë një "gëlqere jo plotësisht e shuar").

**Shlifi 14**, përfaqëson llaçin e marrë në murin rrethues KL, të kalasë së Petrelës, faza VI e ndërtimit (foto 14). Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*-Ranor, kokërrtrashë-vogël, me klaste të rrumbullakuar shkëmbinjsh të ndryshuar, me një matrix mergelor të bollshëm, i cili përbën 45-50%*

*-Matrixi mergelor* i tipit calcimudstone ( me më shumë përmbajtje karbonati se sa argjile), përmban edhe ndonjë mikrofosil planktonik tip Globigerina sp. me rrajtje të keqe, dhomëzat e të cilave janë zëvendësuar me hematit. Ky lloj matrixi, *në relacion me klastet* e përcaktuar më lart *formon një strukturë petrografike "matrix mbështetëse"*.

Kështu, llaçi që i përket fazës së VI[të] ndërtimore në kalanë e Petrelës është përgatitur me materialin e marrë nga shtrati i lumit Erzen. Është përdorur "rërë" kryesisht karbonate, e më pak "rërë" silicore, të cilës i është shtuar një sasi e konsiderueshme gëlqere jo plotësisht e shuar(mezi dallohen mikrofosilet Globigerina sp.?); raporti klaste/matrix mergelor është afërsisht 1:1.

**Shlifi Nr.15**, përfaqëson llaçin e murit tek kulla e veçuar Nr.6, në kalanë e Petrelës (foto 15). Petrografikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si

një:

*-Konglomerat heterogjen, me klaste të granulometrisë zajore-zhavorore, matrix mbështetës, ku "matrixi" është një ranor kokërrvogël-mesëm heterogjen me matrix mergelor të bollshëm 35-40% të volumit.*

*Klastet e mëdhenj* (zaje, zhavore) të rrumbullakuar e gjysëm të rrumbullakuar, janë mikrokalkarenite, mergele radiolaritë, silicorë radiolaritë e nganjëherë radiolaritë të kuq, gëlqerorë algalë të Triasit-Jurës të rikristalizuar deri dolomitizuar.

-*"Matrixi ranor"* janë klastet e granulometrisë ranore, po ata lloj gëlqerori-morgeli *si tek klastet e mëdhenj*, por në këtë "matrix ranor" *shquhen* qartë edhe *klaste ranori kokërrimët-alevroliti* karbonat-feldspat-kuarcor, klaste kuarci polikristalin, *kristaloklaste kuarci*, ndonjë klast volkanik *bazaltik* e shumë, shumë rrallë klaste serpentiniti.

*"Rëra"* e sipërpërmendur, *e lidhur me një lëndë lidhëse mergelore të llojit calcimudstone,* e bollshme, formon një strukturë petrografike përgjithësisht "matrix mbështetëse".

Kështu, "llaçi" tek kulla e veçuar Nr.6 në Kalanë e Petrelës është përgatitur me pak zaje-zhavore, heterogjenë, por me më shumë "rërë" heterogjene. Në materialin klastik të marrë nga shtrati i lumit Erzen është shtuar një sasi e konsiderueshme lëndë lidhëse mergelore.

**Shlifi Nr.16**, përfaqëson llaçin e marrë në nymfe i cili datohet i periudhës së vonë antike, por që ka më shumë mundësi të jetë i shek.II të erës sonë[3] (foto 16). Petrogarikisht ky "llaç" mund të përcaktohet si një:

*Mikrokoglomerat homogjen, i kuq, me "matrix" ranorik-merglor.*

*Klaste* në shumicën e rasteve *përfaqësohen nga mudrocks* (argjilite dhe më rrallë alevrolitargjilite) *të pigmentuar* në shkallë të ndryshme *me ngjyrosje hematitike*. Sortimi i klasteve është i keq, kurse rrumbullakimi luhatet i mirë, mesatar dhe i keq.

Të jepet përshtypja se është përdorur një argjilë merglore, e pjekur, e copëtuar, që ka shërbyer më vonë si shtesë zhavori i kuq me përzierje me matrixin merglor gri. Pra, përsëri është përgatitur një mikrokonglomerat me strukturë polimodale, matrix mbështetëse.

* * *

Duke krahasuar njëri me tjetrin llaçet e së njëjtës fazë ndërtimore dhe me ato të fazave të ndryshme mund të arrijmë në këto konkluzione.

1. Llaçet e përdorur për ndërtimet në fazat e ndryshme dhe merametimet e herëpasherëshme është e mundur të dallohen njëri nga tjetri në disa raste, nga përdorimi i materialeve të ndryshme dhe raporteve të tyre. Në këtë këndvështrim mund të thuhet se studimi i A.Baçes dhe Gj.Karaiskajt është i saktë. Po këtu mund të thuhet se duhet rishikuar edhe njëherë trakti i murit KL, llaçi i të cilit është tepër i ngjashëm me llaçin e përdorur në periudhën e V[të] ndërtimore.

2. Muratura e jashtme e Kullës lindore dhe asaj jugore është e njëkohshme.

3. Për përgatitjen e llaçit është shfrytëzuar "rëra" e lumit Erzen e marrë në vende të ndryshme përgjatë shtratit të tij.

4. Për përgatitjen e gëlqeres është përdorur material merglor, që ndodhet pranë Petrelës.

5. Në sajë të përdorimit të materialit merglor llaçi është pasuruar me magnez, duke i dhënë atij veti pucolanike, pra rezistente ndaj ujit.

6. Ndërtuesit që kanë punuar për Kalanë e Petrelës duket se kanë qenë mjeshtra me përvojë, gjë që vërtetohet nga cilësia e llaçit.

7. Evidentohet përvoja e mjediseve të ndërtimit në përzgjedhjen e materialit të përdorura për llaç për muraturë dhe suvatim. Po kështu rezulton kjo përvojë edhe për sterën e ujit të kullës jugore.

8. Në përgjithësi raporti përbërës shkëmbor të ngurtë(karbonatë silicor) me matriksin (argjilë,

DO NOT COPY

gëlqere)ka qenë afërsisht 1:1, me një prirje në drejtim të "rërës". Është vetëm një rast, që ky raport ka qenë 3:1, por pa qëllime teknologjike.

9. Me materialin e analizuar prej nesh në këtë studim është vështirë të flitet sot për sot për një trashëgimi mjeshtërie.

* * *

Për të pasuruar këtë studim u analizuan dy llaçe që paraqesin interes nga përbërja kimike, ai i suvasë së sterës së ujit në kullën jugore dhe llaçi që lidh tullat në numfeun e periudhës së vonë antike.

Rezultatet jepen në tabelën e mëposhtëme.

Ndryshimi që vërehet me sy midis këtyre dy llaçeve, që vjen nga përzierja e tullave të pjekura në llaçin lidhës të nymfeut dhe përdorimit të një llaçi "të pastër" për suvatimin e sterës së ujit me kullën jugore, pasqyrohet edhe në rezultatet e analizës kimike në rritjen e sasisë së $Al_2O_3$ dhe $Fe_2O_3$ në llaçin e suvasë së sterës së ujit. Karakteristikë thelbësore për të dy këta llaçe është përmbajtja relativisht e lartë e MgO, që spjegon vetitë pucolanike të të dy këtyre llaçeve, rezistencën ndaj ujit dhe izolimin e mirë. Kjo bën, përshembull, që stera të ruaj ujin të pa filtruar nëpër llaç për disa muaj.

1. D.Komata, *Petrela një parafortesë e Krujës në luftërat e Skënderbeut, Konferenca II[të] e studimeve albanologjike*, Tiranë 1969, I, f.285-290.
2. Sipas bisedës me Ll.Papajanin , autor i restaurimit të nymfeut.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Foto 1



Shlifi 1



Foto 2



Shlifi 2



Foto 3



Shlifi 3

DO NOT COPY



Foto 4



Shlifi 4



Foto 5



Shlifi 5



Foto 6



Shlifi 6



Foto 7



Shlifi 7



Foto 8



Shlifi 8



Foto 9



Shlifi 9

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Foto 10



Shlifi 10



Foto 11



Shlifi 11



Foto 12



Shlifi 12

DO NOT COPY



Foto 13



Shlifi 13



Foto 14



Shlifi 14



Foto 15



Shlifi 15



Foto 16



Shlifi 16

DO NOT COPY

DO NOT COPY




PLANIMETRIA E KËSHTJELLËS

DO NOT COPY

# Abstrackt

About the literature in Albania, there are studies about the castle of Petrela, that's of samion hamate and tha's of cooperating writers Apollon Baçe and Gjerak Karaiskaj. At the study of Apollon Baçe and Gjerak Karaiskajk are given six structural phases at the Petrela's castle. In are study we concentraded to select time development of Petrela's castle. The analyse's champions were taken at the most intresting buildings. Comparing each other of the same strukture and that of diffrrent we can give thise conclusions. With the analysed document in this study hard to talk about the things were made the castles before

DO NOT COPY

Emin RIZA

# Gjurmë banesash në vendbanimin - rrënojë të "Bregut të Sterës"

Tipologjia dhe karakteri i banesës shqiptare, në të kaluarën dhe më saktë gjatë mesjetës, paraqet një temë me interes për këtë kategori ndërtimore, të lidhur ngushtas me mënyrën e jetesës. Gjurmimet dhe studimet e derisotme[1] për banesën shqiptare para shekujve XVIII – XIX, lidhen kryesisht me banesën fshatare, gjurmë të të cilave, në gjendje rrënojë, ruhen në mbarë Shqipërinë. Përgjithësisht, banesa të thjeshta me muraturë guri në të thatë, apo me lidhës, ato janë përdhese, me gjysëm kat, apo me kat, dhe i përkasin shekujve XIV – XV, si rrënojat e banesave në Varoshin e Kalasë së Sopotit në Borsh[2], apo rrënojat e banesave në vendbanimin e braktisur të Kamenicës[3] të shekujve XIV – XVI, etj.

Pranë vendbanimit të Konispolit, në perëndim të tij, ruhen rrënojat e një vendbanimi fshatar, i cili thirret me dy emra, Bregu i Sterës dhe Qafa e Stismave. Të dy këto emërtime, me gjasë janë të mëvonshme, apo më saktë lidhen me periudhën pas braktisjes së tij sepse i pari lidhet me një pus që grumbullon ujët e një burimi, prandaj emërtohet sterë, ndërsa emërtimi stisma duket si shtrembërim i termit në gjuhën greke ktisma, që do të thotë ndërtesë. Kërkuesi, Halil Shabani, në vitin 1983, kreu ndërhyrje të karakterit gërmim – pastrimit, për të nxjerrë në pah vlerat e banesave – rrënojë të këtij vendbanimi. Në vitin 1984, gjurmuesi Leonard Suli, së bashku me topografin Mensur Bezhani dhe skicografin Sotiraq Terezi, u njohën me këtë vendbanim, i cili u vrojtua me kujdes dhe u dokumentua në topografinë e tij, si dhe u dokumentuan grafikisht mbarë rrënojat, krahas dokumentimit fotografik. Gjurmuesi Leonard Suli, në një artikull mbi banesat popullore të rrethit të Sarandës[4], përmend shkurtas edhe banesat – rrënojë të këtij vendbanimi duke mos e bërë atë objekt të një trajtimi të veçantë. Autori i këtij artikulli, pjesëmarrës në ekspeditën e përmendur, mbi bazën e materialit grafik dhe fotografik të ekspeditës së udhëhequr prej Leonard Sulit dhe shënimeve vetjake, duke vlerësuar këto dëshmi në kuadrin e historisë së banesës shqiptare, ndërmori këtë publikim[5].

Duke vrojtuar gjurmët e sotme të vendbanimit – rrënojë të Bregut të Sterës, (Tab.1) mund të pohohet se ai shtrihej mbi një rrafsh shkëmbor të zhveshur, afërsisht në formën e një sipërfaqeje katërkëndëshi kënddrejtë, me përmasa rreth 220 X 90 m, pra prej rreth 2 ha. Lartësia mesatare e truallit të vendbanimit është rreth 200 m, mbi nivelin e detit. Pjerrësia e truallit shkëmbor, në drejtimin veri – jug, është rreth 23%. Në gjendjen e sotme quhen rrënojat e 22 ndërtimeve, me gjasë të gjitha të banesave, pa përjashtuar ndonjërën prej tyre me funksione ndihmëse. Për të zbutur pjerrësinë e truallit të ashpër, në hapësirën e vendbanimit ndeshën mure terracimi, me muraturë të thatë

guri, me gjatësi 2 – 8 m, përgjithësisht në formë të drejtë, pranë banesave, apo lidhur me trupin e tyre, kryesisht për të siguruar hyrjet. Banesat janë ngritur larg njëra – tjetrës rreth 10 – 50 m, duke u shtrirë në formë vargu gjatë vijave të niveleve. Ashtu si përgjithësisht, në vendbanimet fshatare të mesjetës dhe mesjetës së vonë (shek XV – XIX) në Shqipëri, ngritur mbi troje të pjerrët shkëmborë, ndërtimet kryesisht banesa, vendosen me aksin gjatësor normal rënies së truallit. Kjo vendosje diktohet prej synimit për të përshtatur ndërtimin me truallin, me sa më pak ndërhyrje për shkak të fortësisë së tij. Pikërisht për arsyet e mësipërme, ashtu si edhe në vendbanime antike, psh. në Çukën e Ajtoit[6], dhe deri vonë në troje të pjerrët, në fshat dhe në qytet, vendosja e banesave[7] dhe përgjithësisht ndërtimeve normal rënies së truallit, është një dukuri gjerësisht e përhapur, në Shqipëri dhe më gjerë.

Gjurmët e rrënojave të banesave, të lejojnë të ndjekësh konturin e mureve të banesave dhe shpesh të arrish në përfundime të sakta mbi zhvillim në lartësi të tyre, për arsye se, në përgjithësi, këto kompozime të thjeshta vazhduan të ndërtohen në trojet shqiptare deri, krahasimisht vonë, rreth mesit të shekullit XIX. Nga gjurmët e derisotme, është e pamundur të përcaktosh nëse pranë banesave ka pasur ndërtime ndihmëse me struktura të qëndrueshme, sepse gjurmë të tilla nuk ndeshen, me përjashtim të ndonjë rasti të diskutueshëm të ndërtimeve me sipërfaqe të vogla rreth 10 – 12 m$^2$. Ndërtimet ndihmëse të përkohshme si vatha për bagëti, apo kafshë ngarkese, nuk përjashtohen. Lidhur me mënyrën e sigurimit të jetës së banorëve, besojmë se blegtoria do të ketë qenë ekonomia kryesore, krahas bujqësisë, në trojet e gjera përpara vendbanimit. Lidhur me sigurimin e ujit për vendbanimin, në gjendjen e sotme ruhet vetëm një burim natyror, pranë banesës n.15, i cili mblidhet në një sterë, në formë pusi.

Siç përmendëm, sipas llojit, gjurmët e vendbanimit – rrënojë të Bregut të Sterës, i përkasin kategorisë së banesës. Sipas kateve dallohen dy lloje banesash, përdhese (Fig.1) dhe me gjysmëkat (Fig.2). Banesat përdhese përbëjnë shumicën duke qenë rreth 70% të mbarë kësaj kategorie ndërtimore në këtë vendbanim.

Prej gjurmëve ekzistuese mund të arrihet, pak a shumë bindshëm në kompozimin volumor të banesave (Fig.3,4), në disa raste në përcaktimin e hapësirave të hyrjeve, ndërsa për elementë të tjerë të banesave nuk gjenden dëshmi apo gjurmë. Edhe përse i përket teknikës së ndërtimit, mund të ndiqet vetëm ajo e muraturës.

Siç përmendëm, klasifikimi tipologjik i shembujve të banesave, në gjendje rrënojë, në banesa përdhese dhe ato me gjysëmkat, në rastin e dhënë është njëherazi edhe klasifikim tipologjik, i cili lidhet me kompozimin volumor të këtyre ndërtimeve.

Banesat e klasifikuara, përdhese, në disa raste mund të ketë qenë banesa me gjysmëkat. Këto dyshime, lidhen me të dhëna të pamjaftueshme prej shqyrtimit të rrënojave, të cilat megjithatë nuk cënojnë dukshëm klasifikimin tipologjik të banesave në shqyrtim. Përgjithësisht forma planimetrike e banesave është katërkëndësh kënddrejtë, me gjerësi 2.5 – 5.4 m, ndërsa me sipërfaqe rreth 13 – 42 m$^2$. Forma e katërkëndëshit kënddrejtë, në disa shembuj, paraqet veçanti në mënyrën sesi trajtohet faqja ballore, apo , rrallë, ajo fundore e banesës. Duke konsideruar këtë trajtim të faqes ballore, në kategorinë e banesës përdhese, dallojmë variantin e parë me ballë të drejtë, rakorduar në qoshe jashtë dhe brenda me kënd të drejtë, variantin e dytë me ballin në qoshet e brendshme kënddrejta, ndërsa jashtë të harkuara, variantin e tretë me faqen ballore në formë gjysëm cilindrike dhe variantin e katërt, me ballin e përparmë të harkuar, ndërsa në dy shembuj, i njëjti harkim ndeshet në ballin fundor. Kuptohet se ky kategorizim nuk mund të konsiderohet thelbësor,

DO NOT COPY

por anësor, sepse nuk ndikon në kompozimin volumor të banesave, tiparit thelbësor të tyre.

Banesat me gjysmëkat, sipas vrojtimit, katër shembuj të tillë, dallohen për shkallëzimin e njohur në volum, i cili bën që hapësira të banesës të përshtaten me rënien e truallit shkëmbor. Banesat me gjysmëkat e kanë gjerësinë 3.35 – 4.90 m, ndërsa sipërfaqja e nivelit të sipërm të tyre luhatet prej 31 – 40 m². Kompozimi i tyre shfaqet tepër i tipizuar, siç e ndeshim deri vonë në shekullin XIX.

Vlerat e rëndësishme të këtyre rrënojave, të cilat me gjasë i përkasin një periudhe krahasimisht të hershme, kushtëzojnë paraqitjen në këtë artikull të 17 banesave – rrënojë, me një përshkrim të përmbledhur dhe dokumentacionin grafik të gjendjes.

Banesa n.1 (Tab.II), ngritur rreth qëndrës së vendbanimit, në radhën e poshtme të tij, është shembull i thjeshtë i banesës përdhese me vendosje normal truallit, sipas aksit gjatësor. Forma planimetrike është katërkëndësh kënddrejtë. Sipërfaqja e banimit është 30.15 m². Rrënojat e lejojnë të përcaktohet hyrja në faqen lindore, me hapësirë rreth 1.5 m siç duket për të mbajtur portën e vetme, përbri saj është ndërtuar një mur – pritë. Gjurmë elementësh të tjerë nuk ruhen, as në muraturën prej gurësh të thatë, me trashësi 70 cm, as në brendësi.

Banesa n.2 (Tab.II), gjithashtu banesë përdhese në plan, në formën e katërkëndëshit këndrejtë, paraqitet si rast i vetëm i vendosjes së saj, sipas aksit gjatësor, në drejtim të pjerrur, verilindje – jugperëndim. Kjo vendosje shpjegohet me synimin për t'iu përshtatur truallit me pjerrësi më të vogël të kësaj hapësire. Ritheksojmë se ky rast i vetëm , shoqërohet me shembuj të pakët me luhatje të vogla të aksit gjatësor të banesës ndaj drejtimit normal me rënien. Gjurmët e muraturës nuk mbyllin mbarë konturin e mureve anësorë të banesës dhe nuk bartin asnjë shenjë mbi elementë të ndryshëm arkitekturorë. Kjo banesë është më e vogla e vendbanimit, me gjerësi 2.5 m dhe sipërfaqe 12.5 m².

Banesa n.3 (Tab.II), është më e madhja e banesave përdhese të vendbanimit. Ajo ka gjerësi prej 5.4 m dhe sipërfaqe prej 42.12 m². Në gjurmët e konturit të muraturës që mbyll volumin prizmatik të banesës, me bazë katërkëndësh kënddrejtë, shihet qartë hapësira e derës rreth 1.50 m. Përbri saj, në pjesën e sipërme, një pritë terracimi e mbron hyrjen. Në brendësi të hapësirës së banesës njëkthinëshe, ndeshim dy elementë, të cilët përsëriten edhe në banesat e tjera. Është fjala për një prag murature të ngritur, përbri hyrjes së vetme të banesës, gjatë gjithë gjerësisë, i cili mendojmë se diktohet prej rënies së truallit shkëmbor, duke lejuar nivelësimin e të dy sipërfaqeve që formohen. E sipërmja, e cila ka në pjesën fundore një lloj podiumi me gjerësi 80 cm, duket se ka qenë hapësira ku ishte ndërtuar vendi i hapur i zjarrit.

Banesa n.4 (Tab.II) është një shembull i rrallë i ndërtimit krejt pranë një banese tjetër, pikërisht asaj n.3. Forma planimetrike, në dallim prej shembujve të tjerë i afrohet katrorit. Bashkëmbështetur murit lindor, është ndërtuar një pritë, normal tij. Gjurmët e muraturës, me gurë të thatë, nuk tregojnë asnjë shenjë lidhur me elementë të ndryshëm të banesës. Afërsia me banesën n.3 dhe përmasat, krahasimisht të vogla të kësaj banese, na shtyjnë të hedhim hipotezën e ndërlidhjes funksionale të të dy ndërtimeve.

Banesa n.5 (Tab.II) ashtu si banesa n.4, është një ndërtim i vogël me sipërfaqe 13.80 m², në plan është thuajse në formë katrori. Në rrënojat e muraturës, dallohet hyrja e vetme lindore, me hapësirë 118 cm, ndërsa në brendësi nuk ruhen gjurmë të asnjë elementi funksional.

Banesa n.6 (Tab.II), gjithashtu përdhese, dallohet prej pesë pararendësve, vetëm për një karakteristike teknike. Është fjala për rakordimin në formë harku në plan, të të dy qosheve që formohen prej murit ballor dhe dy anësorëve.

DO NOT COPY

Banesa ka shtrirjen dhe kompozimin e thjeshtë të njohur. Brenda hapësirës, ruhet dhëmbëzimi i muraturës, i cili formon dy rrafshet e shfrytëzueshëm të banesës. Rrënojat nuk ruajnë asnjë element funksional.

Banesa n.7 (Tab.III), për nga kompozimi dhe trajtimi i qosheve ballore të muraturës është i njëjtë me banesën n.6. Gjithashtu edhe në brendësi, rrafshi i truallit ndahet në dy pjesë prej një muri në formë shkalle.

Banesa n.8 (Tab.III) shfaqet si shembulli i vetëm në mbarë ndërtimet – rrënojë të Bregut të Sterës, tek i cili bashkimi i dy mureve anësore të kësaj banese, në faqen ballore arrihet nëpërmjet një gjysëm cilindri, apo në plan gjysëm rrethi. Hapësira e hyrjes së vetme për në banesë, gjithmonë në faqen lindore të çon, do të thoshim, në shtresën e standartizuar, me dy rrafshe të ndarë prej një numri tërthor. Rrafshi i prapmë, ka në pjesën fundore podiumin e hasur në banesën n.3. Ashtu si dhe në banesa të tjera, hyrja, në pjesën e sipërme mbrohet prej një muri pritës. Rrënojat e kësaj banese, ruajnë përveç hyrjes për në banesë edhe një hapësirë ndriçimi me zhvillim vertikal, me një gjerësi 30 cm, në qendër të harkut ballor, e cila është gjurma e vetme e këtij lloji, në mbarë banesat – rrënojë.

Banesa n.9 (Tab.III), i përket bashkësisë së atyre shembujve, të cilët murin ballor e kanë të ndërtuar në formën e një harku. Madhësia e harkimit është e ndryshme në banesa të ndryshme. Prej vijës që bashkon të dy qoshet ballore, harku në qendër largohet prej saj prej 25 – 90 cm. Në rastin e banesës në shqyrtim kjo largësi është 35 cm. Kjo mënyrë e ndërtimit të murit ballor të banesës, nuk ka asnjë ndikim në formulimin kompozicional të saj. Kështu hyrja e vetme për në banesë, me hapësirë 1,36 m, gjendet në faqen lindore. Në brendësi rrafshi i truallit shkëmbor, të mjedisit të vetëm të banesës, kufizohet, në pjesën fundore, me podiumin e njohur edhe në shembuj të tjerë.

Banesa n.10 (Tab.III) ka të njëjtin kompozim si banesa n.9, me murin ballor të harkuar lehtë. Në rrënojat e banesës, ruhet qartë hyrja e vetme lindore me hapësirë 1.47 m, si dhe me podiumin fundor me gjerësi 50 cm.

Banesa n.11 (Tab.IV), gjithashtu është e variantit me murin ballor të harkuar. Rrënojat nuk lejojnë që të përcaktohet hapësira e hyrjes, gjithashtu në to nuk mund të hetohet ndonjë element funksional i banesës.

Banesa n.12 (Tab.IV), ngrihet në skajin lindor të venbanimit – rrënojë. Në gjendjen e sotme, përveç gjurmëve të konturit të mureve rrethues, nuk ndeshet asnjë gjurmë elementësh të ndryshëm funksionalë të banesës.

Banesa n.13 (Tab>IV), së bashku me rrënojat e një banese tjetër, janë shembujt e vetëm të një vendosje të veçantë të banesës, lidhur me orientimin e faqes së murit i cili është në formë të harkuar në plan. Ky mur, si rast i veçantë, nuk ndërtohet në pjesën ballore të banesës, por në pjesën fundore të tij. Prej rrënojave nuk hetohet asnjë gjurmë elementësh të banesës. Në faqen lindore, normal saj është ndërtuar një mur i vogël, pritë, i cili për analogji me rastet paralele, të sugjeron qënien e hyrjes në këtë faqe të muraturës.

Siç kemi përmendur, prej grupit të banesave të kompozuara me skemën e njohur, me thyerje volumesh, duke qenë banesa pjesërisht përdhese dhe pjesërisht me kat, e cila tashmë njihet me emërtimin banesa me gjysmëkat, në rrënojat e Bregut të Sterës, ndeshen katër shembuj. Banesa n.14 (Tab.IV) paraqet njërin prej këtyre shembujve. Ajo ngrihet në pjesën perëndimore të vendbanimit. Ndërtimi, si zakonisht, vendoset me aksin gjatësor normal vijave të niveleve. Ai në plan ka formën e një katërkëdëshi kënddrejtë. Dy mure të vegjël prite, janë ndërtuar normal mureve gjatësorë të banesës. Kjo banesë është më e madhja e vendbanimit, duke pasur një sipërfaqe banimi

DO NOT COPY

rreth 59 m², në të dy nivelet. Mjedisi i poshtëm, ruan hapësirën e derës prej 1.56 m. Lartësia e këtij mjedisi, luhatet rreth 1.5 m. Në murin lindor, ruhen edhe gjurmët e hyrjes për në pjesën e sipërme përdhese të banesës. Përbri murit verior është ndërtuar edhe dhëmbëzimi i njohur, i cili shërben për vendosje pajisjesh shtëpiake.

Banesa n.15 (Tab.V), është gjithashtu një shembull i banesës së kompozuar me gjysëmkat. Ajo dallohet prej shembujve të tjerë, të të njëjtit lloj, për dy veçanti: së pari, hyrjet për në volumin përdhes dhe atë pjesërisht përdhes dhe, pjesërisht me kat, nuk ndërtohen si zakonisht në faqen lindore të muraturës, por dera e poshtme është ndërtuar në faqen lindore, ndërsa ajo e sipërmja në faqen perëndimore të mureve që konturojnë volumin e banesës. Së dyti, si rast i vetëm, në mbarë vendbanimin, pranë faqes lindore të banesës është hapur, apo më saktë, gdhendur një hapësirë në formë pusi, në të cilin grumbullohej uji i një burimi. Kështu ky pus, në të vërtetë ishte një sterë, ose rezervuar për grumbullimin dhe ruajtjen e ujit të pijshëm. Besojmë se kjo sterë, e një lloji të veçantë, i ka dhënë edhe emrin, Bregu i Sterës, mbarë vendbanimit. Përpara banesës, është ndërtuar një mur – pritë. Rast i veçantë duhet mbajtur ndërtimi i platformës fundore, në hapësirën e prapme në formë trekëndëshi.

Banesa n.16 (Tab.V), është gjithashtu e kompozuar me gjysëmkat në volum. Në dallim prej dy shembujve të mësipërm, ajo dallohet për një veçanti teknike, e cila është unikale në mbarë banesat – rrënojë të Bregut të Sterës. Është fjala për rakordimin me hark të dy qosheve të brendshme, që formohen prej bashkimit të murit jugor me ata lindorë dhe perëndimorë. Kjo karakteristikë, nuk ka ndikim në formulimin kompozicional. Kështu volumi i poshtëm shërbehet prej një dere te vetme me hapësira 1.60 m. Volumi mbi të, pjesërisht në kat dhe pjesërisht përdhes, nuk shfaq veçanti.

Banesa n.17 (Tab.V) nga pikëpamja teknike, shquhet për ndërtimin e ballit jugor, në formë të harkuar, si dhe për ndërtimin e hyrjes në volumin e poshtëm, në murin anësor perëndimor. Të dhënat e tjera mbi këtë banesë – rrënojë, nuk ndryshojnë prej atyre pararendëse.

Rrënojat e banesave në vendbanimin e braktisur të Bregut të Sterës, kanë një rëndësi të veçantë për ndriçimin e evolucionit të banesës shqiptare në shekuj. Numri i tyre, krahasimisht i madh dhe disa veçanti teknike, i rendisin ato në një vend të veçantë në bashkësinë e vendbanimeve – rrënojë në trojet e Shqipërisë.

Ky vendbanim, i shtrirë mbi një pjerrësi shkëmbore të çveshur, natyrshëm ka një vendosje spontane, e cila dallohet për shtrirjen e vendbanimeve përgjatë vijave të niveleve, duke formuar, afërsisht dy radhë ndërtimesh. Nga vrojtimi i gjendjes së sotme të rrënojave, përveç disa mureve të vegjël terracimi, ngritur shpesh pranë banesave, nuk ndeshet asnjë gjurmë muresh rrethues, ndërsa mund të supozohet qënia e ndonjë ndërtimi ndihmës pranë disa banesave. Gjithashtu, nuk ndeshet ndonjë gjurmë rrugësh, apo rrënojash të ndonjë ndërtimi kulti, etj.

Banesat, në variantin përdhes dhe me gjysëmkat, janë me hapësira të vogla, me vendosjen e njohur me aksin gjatësor normal vijave të niveleve, praktikë e ndeshur në mbarë hapësirën e Shqipërisë në këtë gjini ndërtimesh, në fshat madje edhe në qytet, ngritur mbi troje të pjerrët. Repertori i mjediseve është minimal, njëkthinësh në banesat përdhese, ndërsa dykthinësh në banesat me gjysëmkat. Gjurmët e elementëve të ndryshëm funksionalë, në rrënojat e banesave të këtij vendbanimi të braktisur, janë tepër të pakëta. Ato i përkasin, në radhë të parë, hapësirave të dyerve, përmasat e të cilave luhasin prej 1.00 – 1.60 m. E vetmja hapësirë ndriçimi, e cila ruhet pjesërisht i përket banesës n.8. ajo është në formën e hapësirave vertikale, me gjerësi 30 cm në mbarë trashësinë e murit. Elementi i tretë, i cili ndeshet në

DO NOT COPY

DO NOT COPY

rrënojat e banesave, është ai i një podiumi me muraturë, përbri murit fundor të banesës me gjerësi 50 – 80 cm dhe lartësi prej rrafshit të truallit, 60 – 85 cm. Në një shembull të vetëm, atë të banesës n.15, ai shtrihet në plan në formë trekëndëshi. Ky element, me gjasë, shërbente për vendosjen e enëve, siç e ndeshim në shembuj të vonë të banesave të të njëjtit tip.

Materialet kryesorë, për të mos thënë të vetmit, që përdoreshin për ndërtimin e banesës, janë guri dhe druri. Të dy këta gjendeshin mjaftueshëm dhe pranë vendbanimit.

Me gurë ndërtohej muratura. Ndërtimi kryhej me gurë të thatë, pra pa lidhës. Trashësia e muraturës luhatet prej 60 – 75 cm. Ndërtimi i muraturës, përgjithësisht bëhet me dy faqe, të brendshmen dhe të jashtmen, të cilat lidhen pa ndonjë rregull, sipas gjerësive të ndryshme të gurëve. Madhësitë e gurëve janë të ndryshme dhe ata i janë nënshtruar një përpunimi të lehtë. Shihet përpjekja për ndërtimin e rreshtave horizontalë (Fig.5), me lartësi të ndryshme, duke përdorur edhe gurë të vegjël nivelues, pa qenë ky një synim për të arritur me çdo kusht. Shihet përpjekja për mos përputhjen e fugave vertikale. Nuk ndeshet asnjë gjurmë e përdorimit të brezave përforcues të drurit.

Duke gjykuar prej dëshmive në shqyrtim dhe njohjes së ndërtimeve paralele, të mëvonshme, të së njëjtës gjini, mund të hedhim hipotezat e mëposhtme për hapësirat dhe elementët mungues arkitekturorë dhe trajtimin e tyre teknik. Kuptohet se mbarë muratura ka qenë prej mur guri të thatë, mbuluar më çati me strukturë druri, dyujshe, duke qenë ballet tërthore në formë kallkani. Mungesa e mbeturinave të tjegullave të shtyn të mendosh se mbulimi duhet të ketë qenë prej kashte, pasi rrasa guri nuk duken në rrënojat. Sigurisht hapësira e banimit e vetme në banesat përdhese dhe me gjasë e tillë edhe në banesat me gjysëmkat, nuk ka pasur tavan. Mendojmë se mjedisi i poshtëm i banesave, kompozuar me gjysëmkat, ka qenë përdorur për kafshët e ngarkesës, apo bagëtitë. Vendi i zjarrit sigurisht ka qenë i hapur, me platformën e njohur pranë murit fundor, apo mbështetur në të. Nuk mund të flasim për suvatim të brendshëm. Shtresa që ndante pjesën në kat, të banesës prej mjedisit të poshtëm, sigurisht ka qenë prej strukture trarësh veshur me dërrasa. Hapësirat e ndriçimit, sigurisht të pakta, kanë lënë vetëm një gjurmë te banesa n.8. Dyert sigurisht prej druri, me gjasë duhet të kenë qenë njëflegërshe, më së shumti të hapura për të mundësuar ndriçimin. Shtresa e banesave përdhese, apo e hapësirës së mjedisit përdhes, në banesat me gjysëmkat, ka qenë drejtpërdrejt mbi truallin shkëmbor. Përmasat e vogla të banesës dhe mungesa e mjediseve të hapur, besojmë se janë tregues të mbisundimit të ekonomisë blegtorale në jetën e banorëve të këtij vendbanimi.

Rrënojat e banesave në vendbanimin e braktisur të Bregut të Sterës, përsa i përket kompozimit, nuk paraqesin ndonjë risi në bashkësinë e banesave fshatare në vendbanimet – rrënojë të gjurmuara deri më sot në truallin e Shqipërisë. Dy karakteristika teknike të banesave të vendbanimit në shqyrtim, i shkëpusin ato prej simotrave. Është fjala për formën e harkuar, apo gjysëm rrethore të murit ballor të banesave, e cila deri më sot është e vetme në rrënojat e banesave që datohen në harkun kohor të shekujve XIV – XVIII, si dhe për teknikën me mur guri pa lidhës, e cila ndeshet krahasimisht rrallë, si në rastin e një banese në afërsi të Kalasë së Sopotit. Duke u nisur prej të vërtetës se forma rrethore është më e vjetër se ajo e konturimeve me bashkime me kënd të drejtë dhe prej teknikës së vetme të muraturës së banesave në shqyrtim, mendojmë se ato janë më të hershme se rrënojat pranë Kalasë së Sopotit që datohen në harkun kohor të shekujve XIV – XVI. Mungesa e të dhënave prej burimeve të shkruara dhe e

mbeturinave të objekteve, pranë rrënojave të Bregut të Sterës, të cilat mund të shërbenin si elementë datues, na lë në fushën e hipotezës lidhur më datimin e këtyre rrënojave. Lidhur më datimin e tyre [8], Halil Shabani i datoni të periudhës antike (shek.IV – II. P.e. së re), ndërsa Neritan Ceka, të fillimit të mesjetës së mesme. Me mendimin e këtij të fundit bashkohet edhe Leonard Suli. Edhe ne përjashtojmë përkatësinë antike të këtij vendbanimi – rrënojë, duke qëndruar me tezën e Neritan Cekës. Më ngushtaas mendojmë se rrënojat e Bregut të Sterës, gjithë duke qenë në fushën e hipotezës, i përkasin shekujve X – XI.

1)Emin Riza – Pirro Thomo, Karakteri dhe tiparet e vendbanimeve të banesave fshatare shqiptare në shek. XIV – XVIII, "Kultura Populore" 1983,2.
2)Emin Riza, Arkitektura e banesës popullore në zonën e Bregut të Detit, (Labëri), "Monumentet", 1980,19.
3)Emin Riza – Aleksandër Meksi, Ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës, "Monumentet", 1974, 7-8.
4)Leonard Suli, Banesa popullore e rrethit të Sarandës (shek.XV – XX), "Monumentet", 1988, 2.
5)Vizatimet e këtij artikulli janë përpunuar për botim prej Bashkimk Penxhës, mbi bazën e rilevimeve dhe përpunimeve të Sotiraq Terezit. Fotot janë të Hysen Çollakut.
6)Apollon Baçe – Vera Bushati, Vështrim mbi banesën prehistorike dhe qytetare në Iliri dhe Epir, "Monumentet", 1989,1.
7)Emin Riza, Lidhja e ndërtimeve me truallin, "Vepra të mjeshtërve tanë", Tiranë, 1983.
8)Leonard Suli, Banesa popullore e rrethit të Sarandës, (shek.XV – XX), "Monumentet" 1988, 2, fq.136.



*Rrugë e një banese përdhese*

DO NOT COPY

DO NOT COPY



*Pamje e vendbanimit -rrënojë të (Bregut të Sterës)*



*Rrugët e një banese*

DO NOT COPY



*Rrugët e një banese*



*Rrugët e një banese me gjysëmkat*

DO NOT COPY



DO NOT COPY




*Vendbanimi - rrënojë i Bregut të Sterës*

DO NOT COPY



DO NOT COPY



DO NOT COPY



DO NOT COPY



DO NOT COPY



DO NOT COPY



DO NOT COPY



DO NOT COPY



# Homes at (Bregu i Steres)

The character of Albanian home in the passed and along medieval period gives us an interesting theme for this constructive group, united with the way of living. The research and scientific works about the Albanian home before XVIII-XIX (eighteen-nineteen) centres are united with the village home, signs that are bad, damaged, are preserved all around Albania. Near the home of Konispol, in west is preserved a village home that is called with two names, Bregu i Steres and Qafa e Stismave. Looking at the signs at home at Bregu i Steres, we can say that he was placed (shkembor) place, in form of surface of a geometric picture 90 (ninety grades), with dimensions about 220 (two hundred twenty) x 90 m(ninety metres). The medium height of the place of home is about 200 m (two hundred metres) above the sea level. Like we said, like the character, the kind, the signs of home of Bregu I Steres belong to the home group. We can make the difference of two kinds of homes ; in ground and a half stare. From the signs, it can be arrived, more or less in the composition of homes, sometimes in selection of enters spaces, but for the other elements of homes we can't find signs. Like we said, from the homes group that is structured with the known (skeme). The absence of documents and of objects, near Bregu i Steres, that could be dating elements, lives us in axiom answers.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Lazër PAPAJANI

# Një rishikim për periudhat fillestare të disa kalave

Në revistën "Monumentet" të vitit 1974, nr. 7-8 dhe të vitit 1975 nr. 9 janë botuar dy artikuj, njëri për kalanë e Prezës[1] dhe tjetri për kalanë e Peqinit[2]. Mbasi bëhet përshkrimi i hollësishëm i planimetrive dhe i teknikave të ndërtimit, duke filluar fazat e ndërtuara në periudha të ndryshme me karakteristikat e tyre të veçanta, në fund bëhet një vendosje kronologjike dhe datimi i secilës periudhe ndërtimi.

Duke u mbështetur në vrojtime më të hollësishme në mënyrën e ndërtimit, duke i krahasuar edhe me ndërtime të tjera, me teknika ndërtimi të përafërta me këto dy kala, duke u mbështetur dhe analizuar më me kujdes periudhën dhe ngjarjet historike, mendoj se periudha fillestare (e parë) e ndërtimit në to duhet të rishikohet, për të dhënë një mendim më të saktë apo të përafërt me periudhën e fazës së parë fillestare, të ndërtimit të këtyre dy kalave. Ndërsa përshkrimi i formës i planimetrisë fillestare, i teknikës së ndërtimit, veçimi dhe përcaktimi i fazave, shtesat e ndryshme që ju takojnë periudhave më të vona me mënyrën dhe karakteristikat e veçanta të ndërtimit, mendoj se janë të sakta.

Në luginën e lumit Shkumbin, që në lashtësi kalonte një nga rrugët më të përshatshme dhe më të rëndësishme që lidhte pjesën perëndimore të Ilirisë së Jugut me zonën në brendësi të Ballkanit. Mendohet që në fillimet e veta kjo rrugë është quajtur Rruga e Kandavisë, me këtë emër përmendet edhe në shek. I p. Kr., ndërsa pjesë të saj po me këtë emër njihen edhe më vonë. Me pushtimin romak të Ilirisë dhe me shtimin e konflikteve ndërmjet Romës dhe Maqedonisë rëndësia dhe roli i kësaj rruge shtohet.

Në të kryhen punime për përmirësimin dhe organizimin sa më të mirë të lëvizjeve, si zgjerime, kalime në vende më të përshtatshme, shtrimin e trasesë, paisje me ura etj. Në shek. I-II m. Kr. ajo pajiset edhe me stacione. Tani ajo njihet me emrin Rruga Egnatia (Via Egnatia). Më vonë rreth shek. III-IV m. Kr., për ta bërë sa më të njohur dhe më të lehtë udhëtimin në të, nga udhëtarë të ndryshëm u përpiluan disa itinerare[3].

Me shumë interes është se ato janë lista rrugësh dhe harta grafike, ku janë shënuar emri i vendit ku niste rruga, drejtimi që merrte, stacionet ku kalonte dhe vendi ku përfundonte. Për Rrugën Egnatia janë hartuar tri itinerare. Më i pari është ai që njihet me emrin e Antoninëve[4] që mendohet se është përpiluar në vitet 212-218, në kohën e sundimit të perandorit romak Karakalla. Në pjesën që bën fjalë për rrugën nga Hydruni (Otranto) nëpër Apoloni dhe prej këtej nëpër Maqedoni në Kostantinopol, mbas qytetit të Apolonisë shënohet Ad Novas (Nova e Lushnjës), pastaj Klodiana-Skampis dhe me radhë deri sa përfundon në Kostantinopojë. Po kështu edhe

DO NOT COPY

në tabelën grafike "Tabula Peutingeriana"[5], për të cilën mendohet se kompilimi fillestar mund të jetë bërë në gjysmën e parë të shek. III m. Kr., dhe redaktimi përfundimtar në shek. IV. m. Kr. Në pjesën që bën fjalë për Rrugën Egnatia nga Durrësi (Dyrrahi) në Kostantinopojë, stacioni i parë që shënohet mbas qytetit të Durrësit prej ku fillon, është Klodiana (Clodiana), në vazhdim Skampini dhe të tjerët me radhë. Ndërsa në itinerarin e Burdigales[6], i hartuar në vitin 333, m. Kr. Në rrugën nga Heraklea nëpër Maqedoni në Aulone (Vlorë), në pjesën e rrugës mbas stacionit Treiekto (Ura e Haxhi Beqarit), deri në stacionin Marusia (Golemi i Lushnjës) shënohen edhe tri stacione të tjera: Hiskampis (Skampis), Ad Quintum (Fikas, Bradashesh), stacioni tjetër Klodiana (Clodiana) vazhdon me stacionin Marusio (Golem i Lushnjës) etj. Studiuesi austriak Hani[7] në vitin 1863 e përshkoi në këmbë trasenë e rrugës së vjetër duke krahasuar dhe korrigjuar distancat e shënuara në itinerarët e vjetër dhe bëri identifikimin e disa stacioneve të rrugës me qytetet dhe vendet e banuara. Stacionin e Skampit dhe të Klodianës që shënohen pranë njëri-tjetrit në të gjitha itineraret i vendosi: Klodianën në qytetin e vogël të Peqinit dhe Skampin në atë të Elbasanit.

Në itinerarin e Burdigales, (viti 333) përcaktohet edhe kategoria që tregon madhësinë e secilit stacion rrugor. Për Skampin dhe Kldianën shënohen si stacione të kategorisë "mansio", ku udhëtarët dhe karvanët, përveç ndërrimit të kuajve , mund të bënin qëndrime dhe pushime të gjata, të kryenin shërbime të nevojshme, ku kishte vende ku mund të kalohej nata, për të fjetur. Po në këtë intenerar, ndërmjet stacionit të Klodianës dhe Skampinit, vendoset stacioni Ad Quintum, që identifikohet me rrënojat e termeve dhe nymfeut, të zbuluara në fshatin Bradashesh të Elbasanit.

Në intenerar shënohet si stacion i një kategorie më të ulët "mutacio". Në ndryshim me "mansiot", këtu bëhet vetëm një pushim i shkurtër, mund të ndërroheshin kuajt dhe të vazhdohej udhëtimi. Në kohën kur ishte kompiluar ky itinerar (viti 333 m. Kr), Kalaja e Skampinit, aq më tepër ajo e Klodianës nuk kanë qenë ndërtuar. Në rast të kundërt edhe në qoftë se Skampini do të kishte marrë formën e një qyteti, do të ishte cilësuar si "Civitates", ashtu si Ohri etj. Stacionet e Skampinit dhe të Klodianës edhe në itinerarin e Burdigales cilësohen të kategorisë "mansion", që janë më të mëdha dhe të zhvilluara nga ato të kategorisë "mutacio", por shumë më të vogla nga "Civitates". Cilësimi i tyre si stacione "mansio", tregon se këtu, duke u nisur nga pozicioni gjeografik dhe rëndësia që kishin për rrugën, po formohej një qendër e organizuar banimi, më e madhe dhe më e zhvilluar në krahasim me pjesën më të madhe të stacioneve të tjera. Si pasojë e ngjarjeve historike, ky proçes në shek. IV m. Kr, me sa duket pas vitit 333 m. Kr., në Skampin që ndodhet në një vend më të favorshëm dhe në kryqëzim rrugësh kryesore ndërtohet kalaja[8] dhe merr formën e një qyteti. Në stacionin tjetër në të njëjtën kategori "mansion" në Klodianë me sa duket ky proces fillon më vonë dhe zhvillohet më ngadalë. Në zonën e qytetit të sotëm të Peqinit janë gjetur gjurmë banimi[9], të shek. III-Iv m. Kr, Tab I, ndërsa në kodrat pranë qytetit dhe në drejtim të fshatit Karinë dhe në krahun tjetër drejt fshatit Fatishe, gjurmët e banimit janë edhe më të hershme.

Ngjarjet dhe situatat historike janë përcaktuese në shumë vendime dhe veprime ashtu si mund të jenë për ndërtimin e një kalaje. Në shek. III-IV m. Kr., perandoria romake ishte në etapën e shthurjes së rendit skllavopronar dhe, si pasojë, po kalonte periudha tepër të vështira. Luftërat e mëdha pushtuese, që e furnizonin perandorinë me krah pune, ushtarë dhe të ardhura të tjera, kishin përfunduar.

Si pasojë mungesa e krahëve të punës solli pakësimin e prodhimit,. Kriza e përgjithsme u shfaq në varfërimin e pjesës më të madhe të popullsisë. Rënia e prodhimit zejtar ndihet në lidhjet tregtare

me krahinat e ndryshme, si pasojë edhe qytetet kalojnë në vështirësi. Kalohet në ekonominë bujqësore, lind lakmia për krijimin e pronave të mëdha në dëm të pronarëve të vegjël dhe të mesëm. Si pasojë e kësaj krize, pushteti qëndror dobësohet, klasa sunduese në provinca kërkon që të shkëputet nga pushteti qëndror , duke e acaruar edhe më tepër krizën e përgjithshme. Kjo gjendje nuk la pa prekur edhe ushtrinë. Perandorë të ndryshëm si Karakalla, Kostandini I, Valentiniani u munduan me vendime dhe dekrete të shumta të qetësonin gjendjen dhe t'i zgjatnin jetën perandorisë. Gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale krijoi kushtet për trazira të brendshme të popullsisë fshatare dhe qytetare. Edhe në kufijtë verilindorë të perandorisë gjendja ishte kritike. Duke përfituar nga gjendja e brendshme e trazuar e perandorisë përqëndrimi dhe sulmet e fiseve barbare bëhen të shpeshta dhe përbënin një rrezik të madh për të.

Në shek. III m. Kr. masa të mëdha gotësh mundën disa herë t'i shpërthenin kufijtë e perandorisë duke kaluar edhe lumin Danub për tu vendosur në territorin e Gadishullit Ballkanik. Krahinat e Ilirisë për një kohë të gjatë nuk u prekën nga sulmet dhe pushtimet barbare. Vetëm pas betejës në Adrianopojë në vitin 378 ndërmjet ushtrisë romake dhe gotëve të perëndimit (vizigotëve), gotët mundën të shtrihen në krahinat perëndimore të Ballkanit dhe të dilnin në brigjet e detit Adriatik. Megjithatë, në krahasim me pjesën tjetër të perandorisë, pjesën perëndimore, këtu gjendja ekonomike ishte më e mirë, kështu që në vitin 330 kryeqyteti i perandorisë u shpërngul nga Roma në Konstandinopojë duke marrë emrin e perandorit Kostandin, themeluesi i të cilit qe[10]. Kalimi i qytetit kryesor në pjesën lindore të perandorisë bëri që kjo pjesë e perandorisë të marrë një rëndësi të veçantë. Gjithashtu, edhe komunikimet ndërmjet dy pjesëve të një perandorie do të ishin më të mëdha dhe më të shpeshta. Një nga mjetet për këtë lidhje do të ishte edhe rruga tokësore, që në këtë rast është Rruga e vjetër e Kandavisë, që deri tani njihet me emrin Rruga Egnatia. Në gjysmën e dytë të shek IV m.Kr, si pasojë e gjendjes së përgjithshme të shqetësuar të perandorisë, e cila shtohej nga dita në ditë, dhe me pushtimin e territoreve ilire dhe daljen e fiseve barbare gote në brigjet e Adriatikut, lëvizjen tepër të nevojshme në rrugën Egnatia e bënte të pasigurtë edhe me rreziqe të mëdha.

Nevoja e një periudhe tjetër fortifikimesh në vendet më të përshtatshme ishte e domosdoshme për të ruajtur funksionin normal të saj[11].

Për herë të parë emri Klodiana (Clodiana) del në shek. III m.Kr si stacioni i Rrugës Egnatia. Stacioni ka zënë vend në një pllajë të ulët në krahun e djathtë të lumit Shkumbin. Nga lindja kufizohet me vargun e kodrave. Pllaja zbret në të gjitha anët me pjerrësi të lehta. Më vonë, në pjesën më të sheshtë, në anën jugperëndimore është ndërtuar kalaja. Kalaja si pjesë e stacionit ka pasur si detyrë të krijonte një gjendje sigurie për vetë stacionin dhe të kishte më mirë nën kontroll dhe të siguronte një lëvizje të lirë në Rrugën Egnatia. Kalaja ka formën katërkëndëshe 57 x 51 m, ka madhësinë sa për vendosjen e një garnizoni ushtarak. Ka drejtim diagonal veri-jug. Në të katër qoshet ka pasur nga një "kullë" me planimetri në formë rrethi. Në mes të gjatësisë së murit lindor ka një kullë katërkëndëshe, e dalë pak nga linja e murit rrethues 10x1m. Porta kryesore ka qenë në anën perëndimore, pranë së cilës, me sa duket, kalonte edhe rruga. Sot nga kalaja e periudhës së parë mendoj se ruhet pjesa më e madhe e mureve rrethuese. Nga kullat ruhet vetëm ajo në qoshen lindore, kulla e rrumbullakët, me gjurmën e një frengjie në pjesën e sipërme Tab. II, d. Gjurmë të periudhës së parë ruhen edhe në disa raste në kullën veriore dhe atë jugore, aty ku lidhen me murin rrethues. Në kullën veriore, në pjesën e murit më të vjetër, ku lidhet me murin rrethues lindor, ruhet pjesërisht një frengji e thjeshtë

DO NOT COPY

për katin e parë dhe gjysma e një frengjie për katin e dytë të kullës me një pjesë të harkut me tulla që e mbyllte nga sipër. Tab. II, a. Sipas gjurmës së harkut del që frengjia të ketë qenë e ngushtë dhe e lartë 0.50 - 0.60 m Tab. II, b.c. Duke e lidhur gjurmën që shohim në kullën e rrumbullakët (ajo ka qenë e gjerë nga brenda kullës dhe ngushtohej nga jashtë), themi ka qenë frengji për luftimet me shigjeta. Tab II, o, rikonstruksioni i frengjisë pamje nga brenda.

Teknika e ndërtimit e periudhës së parë ka karakteristikat e veta të veçanta që e dallojnë nga pjesët e tjera të ndërtuara më vonë. Ajo ruhet mjaft mirë në pjesën e poshtme të mureve që kanë qenë të mbuluara dhe të ruajtura nga dheraf. Në kullën e rrumbullakët, plotësisht e periudhës së parë, në pjesën e brendshme të saj, që për një kohë të gjatë ka qenë e mbushur me dhe, teknika fillestare e ndërtimit ruhet në gjendje shumë të mirë. Muri është ndërtuar me gurë lumi të lidhur me një masë të madhe llaçi. Në fugat ndërmjet gurëve llaçi është vendosur me bollëk duke kaluar edhe mbi faqen e gurit, rrafshohet me kujdes dhe pritet pjerrtas me mistri, duke krijuar një kornizë për pjesën e dukshme qëndrore të gurit.

Llaçi ka ngjyrë të bardhë dhe është përzierje rëre të imët me shumë gëlqere. Tab III, a, b: Tab IV, a, b. Kjo mënyrë punimi mund të themi se është karakteristika kryesore për periudhën e parë të ndërtimit, por sot kjo mënyrë punimi nuk ruhet në pjesën e murit që ka qenë në kontakt me agjentët atmosferikë. Mund të mendohet se duhet të ketë edhe fortifikime të tjera, ku, për arsyet që përmendëm, këto gjurmë dhe të tjera janë zhdukur dhe ndërtimi i tyre vendoset në periudha të tjera në rastet më të mundshme si ndërtime mesjetare.

Një mënyrë ndërtimi, plotësisht e ngjashme me këtë, po kështu edhe në përbërjen e llaçit, e shohim në pjesën e poshtme në murin e nymfeut në Bradashesh të Elbasanit, në stacionin rrugor të Rrugës Egnatia, Ad Quintum Tab III, a. Termet dhe nymfeu janë ndërtime të periudhës së pushtimit romak shek II m, Kr[12]. Po kjo mënyrë punimi shikohet edhe në kala të tjera në vendin tonë të ndërtuara në periudhën e pushtimit romak dhe në antikitetin e vonë si Kalaja e Elbasanit, muri i Portës së Durrësit, Kalaja e Ndroqit, Lalmit,[13] etj.

Në dy sondazhe të kryera në oborrin e kalasë në Peqin, pranë murit rrethues në thellësinë 1.60 dhe 1.45 m, doli themeli i murit i mbështetur mbi një shtresë 20-30 cm të lartë me copa tjegullash solene të shek. I-III m. Kr. Themeli ngrihet 0.40-0.50 m mbi to, formon një xokël 0.25 m mbi të cilin lartësohet muri rrethues.

Në mbështetje të të dhënave të mësipërme si në formën kuadratike, karakteristike për "Kastrot" romake, në mënyrë të veçantë në të dhënat historike, në teknikën e ndërtimit dhe të dhënat e sondazheve, mendoj si kohë më e mundshme dhe më e përafërt e ndërtimit të periudhës së parë, fillestare, të kalasë duhet të jetë çereku i fundit i shek IV dhe fillimi i shek V m. Kr. Kjo periudhë është e njohur për ndërtimet fortifikuese që kryen Perandoria Romake në territorin ilir për të mbrojtur bregdetin lindor të Adriatikut, që mund të ishte tepër i rrezikshëm për kalimin e fiseve gote në Gadishullin Apenin.

Edhe Kalaja e Prezës ka mjaft karakteristika të përafërta me kalanë në qytetin e Peqinit. Ajo ka formën katërkëndëshe si "Kastrot" romake, megjithëse është ndërtuar në pjesën më të lartë të kodrës, duke ju përshtatur terrenit. Qëllimi kryesor i saj ka qenë kontrolli mbi rrugën që kalonte poshtë, pranë kodrës.

Rruga fillonte në Durrës, në Vorën e sotme merrte drejtimin nga veriu për të shkuar në drejtim të Lezhës (Lissos), Shkodrës (Scodrinon) etj.

Pranë kësaj rruge, në fshatin Borizanë kemi mundur të hetojmë gjurmët e një stacioni rrugor, për të cilin mendojmë se mund të jetë stacioni Pistum që shënohet "Tabula Peutingeriana"[14]. Edhe për sa i takon teknikës së ndërtimit, që është

DO NOT COPY

punimi i llaçit në fugat ndërmjet gurëve e gjejmë edhe këtu. Në të dy shpatullat e portës kryesore të kalasë të bie në sy mirë kjo mënyrë punimi e llaçit. Në të dyja këto shpatulla shikohet se muri i kalasë fillestare ruhet në lartësinë 1-130m. Kur kalaja është rindërtuar, muri i ndërtuar rishtas është vendosur në vazhdim mbi murin e vjetër. Vija e bashkimit të dy mureve që u takojnë periudhave të ndryshme me pak kujdes dallohet mirë. Ndërtuesit e murit të ri kanë parë dhe me sa duket u ka lënë përshtypje të mira kjo mënyrë punimi, prandaj edhe ato vetë janë munduar që në murin e ri fugat t'i punojnë ashtu si të parët e tyre. Ndërtuesit e tinj janë munduar të ngjasojnë punimin e tyre me të vjetrin, por ai ndryshon si në mënyrën e punimit edhe në cilesinë e përgatitjes së llaçit. Periudha e parë ruhet në disa pjesë edhe në murin rrethues dhe në kullat e kalasë.

Në vitet e Luftës së Parë Botërore, Kalaja e Prezës vizitohet nga shkencëtarë shumë të njohur austriakë Kamilo Prashniker dhe Arnold Shober. Mbas një udhëtimi të gjatë, të nisur nga Durrësi, ashtu si e thonë edhe vetë, u sorollatën për një kohë të gjatë nëpër kodra, kur kulla e sahatit dhe minareja e xhamisë me orë të tëra i përshëndeste nga larg. Më në fund, të lodhur dhe në një kohë kur po binte muzgu i mbrëmjes, arritën. Të dy shkencëtarët, pavarësisht nga lodhja dhe ndriçimi i pakët, mundën të dallonin gjurmët e murit të vjetër në hyrje të kalasë[15]. Për periudhën e parë të ndërtimit ashtu si edhe për kalanë në qytetin e Elbasanit, ata mendojnë se u takojnë shekujve III-V m. Kr. Për vjetërsinë e Kalasë së Prezës ka shprehur mendimin e vet dhe historiani i Skënderbeut Marin Barleci, kur thoshte se në Kalanë e Prezës duhet të ketë qenë Qyteza e Partineve[16].

Kushtet historike për Kalanë në Peqin (Clodiane) janë të njëjta edhe për kalanë në kodrën e fshatit Prezë, po kështu edhe mënyrat e vjetra të ndërtimit për kalanë fillestare janë plotësisht të ngjashme. Mendoj se edhe në kalanë e Prezës faza e parë, kalaja fillestare, është ndërtuar në të njëjtën periudhë me fazën e parë në Kalanë e Peqinit, në çerekun e fundit të shek. IV dhe fillimin e shek. V m. Kr.

Ka mendime se në zonën e Prezës, përveç kalasë që shohim sot, duhet të ketë qenë edhe kalaja më e vjetër, për të cilën bën fjalë Barleci, por ajo duhet kërkuar në një vend tjetër. Kërkimet tona për të gjetur gjurmët e një kalaje të dytë nuk kanë dhënë rezultat. Jam i mendimit se i vetmi vend i mundshëm për ndërtimin e një kalaje është pikërisht vendi ku ndodhet në periudhën e parë, fillestare, të kalasë që shohim sot për të cilën po flasim.

Jam i mendimit se edhe Kalaja e Bashtovës e ndërtuar pranë degës jugore të Rrugës Egnatia, pranë lumit Shkumbin dhe urës që i shërbente rrugës, gjurmët e së cilës shikohen edhe sot, faza fillestare duhet të jetë ndërtuar po në këtë periudhë. Në muret e saj në disa raste shikohet mënyra karakteristike e punimit të llaçit në fugat dhe faqet e gurëve. Kjo teknikë vërehet edhe në murin e anës perëndimore, që është rindërtuar më vonë mbas një shembjeje,[17] por është vetëm një imitim. Edhe për Kalanë e Ishmit mendoj se fillimin duhet ta ketë po në këtë periudhë. Studiuesi Aleksandër Matkovski në studimin për kryengritjet sanxhakun e Ohrit në vitet 1566-1574 bën fjalë edhe për kalanë e Ishmit si ndërtim i sundimit turk[18]. Ai paraqet 19 dokumente,[19] në disa prej tyre bëhet fjalë për ndërtimin e kalasë në vitin 1574-1575[20]. Po në këtë artikull tregon se pushtuesit osmanë në pjesën më të madhe rindërtonin kalatë e vjetra. Mendoj se dokumentet dhe shkresat e dërguara nga Porta e Lartë për probleme ndërtimi edhe në raste rindërtimesh ato cilësoheshin si ndërtime të mirëfillta, po kështu mund të jetë rasti edhe në këtë kala. Kalaja e Ishmit e vendosur në një pozicion strategjik përveç zonës përreth, kontrollonte edhe grykëderdhjen e lumit në det.

Një pozicion i tillë për ndërtimet fortifikuese në

DO NOT COPY

periudhën e antikitetit të vonë, për mbrojtjen e qytetit të Durrësit do të ishte tepër i kërkuar.

Me shumë të drejtë është shprehur mendimi se në periudhën e antikitetit të vonë një numër kalash janë vendosur në disa breza duke formuar një sistem mbrojtës për qytetin e Durrësit[21]. Jam i mendimit se edhe kalatë në Peqin, Bashtovë, Prezë, ndoshta edhe Ishëm, përveç funksionit të tyre, edhe këto bëjnë pjesë në sistemin fortifikues për mbrojtjen e zonës dhe qytetit të Durrësit, kur rreziku i dyndjeve dhe sulmeve barbare ishte bërë tepër i madh.

DO NOT COPY

1. Lazër Papajani, Kalaja e Prezës, "Monumentet", Tiranë 1974, nr. 7-8, fq. 167-181.
2. Lazër Papajani, Kalaja e Peqinit "Monumentet", Tiranë 1975, nr. 9, fq. 55-76.
3. Selim Islami-Frano Prendi-Hasan Ceka-S. Anamali, Inteneraret, "Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë", Tiranë 1965, fq.307.
4. Vepër e cituar, fq. 314.
5. Vepër e cituar, fq. 308.
6. Vepër e cituar, fq. 317.
7. Neritan Ceka-Lazër Papajani, Rruga në luginën e Shkumbinit, "Monumentet", Tiranë 1971,1,fq.50.
8. Gjerak Karaiskai, Kalaja e Elbasanit, "Monumentet", Tiranë 1971,1, fq.69.
9. Neriatn Ceka-Lazër Papajani, Rruga në luginën e Shkumbinit, "Monumentet", Tiranë 1971, 1, fq.52.
10. Selim Islami-Kristo Frashëri, Historia e Shqipërisë, vol. I, Tiranë 1959, fq.132-138.
11. N.Ceka-L.Papajani, Rruga në luginën e Shkumbinit, "Monumentet", Tiranë 1971, fq. 53. N. Ceka-M.Korkuti, Arkeologjia, 1993, fq.407.
12. N.Ceka-L.Papajani, nymfeu dhe termet e stacionit Ad Quintum, "Monumentet", Tiranë 1972, 4, fq. 29-51
13. Gjerak Karaiskaj-A Baçe, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë, "Monumentet", Tiranë, 1975, 9, fq. 5-33.
14. L. Papajani-G.Pani, Rrugët dhe banimet pranë tyre në antikitet, "Tradita në arkitekturë dhe në art" Tiranë 1980, fq. 3-9.
15. K. Prashniker-A. Shober, Kalaja e Prezës, "Kërkime arkeologjike në Shqipëri dhe Mal të Zi", Vjenë 1919, fq. 149-150. Kalaja e Elbasanit, fq. 105, botimi shqip. Botimi i ri, Tiranë 2003, Kalaja e Prezës, fq. 81-82. Kalaja e Elbasanit, fq. 57.
16. M. Barleci, "Historia e Skënderbeut", botimi I, Tiranë 1964, fq. 247-248. Botimi II, Tiranë 1967, fq. 249-250. Botimi III, Tiranë 1983, fq. 326-327.
17. Gj. Karaiskaj, Kështjella e Bashtovës, "Monumentet" Tiranë, 1973, 5-6, fq. 59-76.
18. A. Matkovski, Kryengritje të panjohura në Sanxhakun e Ohrit në vitet 1566-1574, "Studime Historike", Tiranë 1973, 3, fq. 53-66.
19. A. Matkovski, vepër e cituar, fq. 177-206. Në fq. 184, në dokumentin nr. 16, datë 8 shkurt 1574, përmendet Kalaja e Peqinit, pranë Elbasanit, me emrin Beklet, emër që u vendos mbas pushtimit nga turqit.
20. Gj. Karaiskaj, Kështjella e Ishmit, "Monumentet", Tiranë 1978, 15-16, fq. 243-248.
21. Gj. Karaiskaj-A. Baçe, vepër e cituar, fq. 5-25.




DO NOT COPY

DO NOT COPY





*Mur i shek. II në Nimfeun e stacionit Ad Quintum të rrugës Egnatia në Bradashesh të Elbasanit*



*Mur i periudhës fillestare në kalanë e Peqinit. Në kullën e rrumbullakët nga brenda*

DO NOT COPY

DO NOT COPY



*Mur i periudhës fillestare në kalanë e Prezës. Në dy shpatullat e hyrjes.*



*Mur i shek. II në Nimfeun e stacionit Ad Quintum të rrugës Egnatia në Bradashesh të Elbasanit*

DO NOT COPY

# Evaluation on the first dating of some castles

In the magazine "Monuments" of the year 1974, No 7-8 and that of the year 1975, no 9 two articles are published. One of them is about the castle of Preza and the other about the castle of Peqin. At the end is mentioned the period when they are dated.

Based on more specific observations, including the way of construction and historical events, I think that the first dating of those two castles should be reconsidered.

In the itineraries of the III- IV century A.C is mentioned the Egnatia road, first there is mentioned the Claudine station, and than that of Scampi followed by others.

The Austrian scientist Hahn, in 1863 mànaged to determine their itinerary, Clodiana with the town of Peqin and Scampi with the town of Elbasan. During the time when those itineraries are created the castles of Elbasan and Peqin haven't been built. Traces of inhabited places that belong to the III-IV century A.C are found in Peqin while in the direction of the village Fatishe and Karine the traces are more ancient.

In the itinerary of Burdigale dated in 333, the station of Clodiana is determined as a station belonging to mansion category, where apart of the changing of horses there were inns where someone could pass the night. These details show that here has started to be created a new inhabited center and at the end of IV century and beginning of V century A.C might have been built the castle which was in the function of the Egnatia road. I arrived in these conclusions taking into consideration the way of construction especially the way of fugue, with a lot of mortar that appears over the stone surface, inclined with shaped trowel, forming in this way a frame around the surface of stone. This way of construction is clearly seen in the castles of late antiquity. This is preserved in the bottom of the walls, where they could be protected.

There might be even other castles where these traces have disappeared and their construction is dated in other periods, in most of the cases they are dated as medieval constructions.

The castle of Preza has many similar characteristics with the castle of Peqin. This castle controlled the road that passed near it, that started from Durres and went to Lezha, Shkodra etc. The specific way of using mortar in the fugues between the stones, which is characteristic for this way of construction, is found even here.

During the First World War, the castle of Preza is visited by the well-known Austrian scientists Kamilo Prashniker and Arnold Shober. They thought that the first phase of the castle belongs to the 3-5 century A.C. This is mentioned as an old castle even by the Skanderbeg's historian, Marin Barleti, when he says: "here might have been the Town of Partins". To my opinion even the castle of Preza is dated in the same period as the castle of Peqin, at the end of IV and beginning of the V century A.C. the castles of Bashtova, near Egnatia road and maybe the castle of Ishem are dated in the same period. They are part of the fortifying system of castles that protected the town of Durresi.

DO NOT COPY

Hysen IBRA

# Teqja e madhe e Gjakovës dhe Teqja Marash-Hisar në Prizren duhen vënë në mbrojtje shtetërore

Trashëgimia monumentale meriton trajtim institucional pa dallim përkatësie etnike, fetare dhe veçorive të tjera, por duke u mbështetur në vlerat, historike, artistike, shkencore, arkitektonike, konfeksionale etj. Studiuesi i njohur Emin Riza, shkruan se: *Gjurmimi, vënia nën mbrojtje, studimi, restaurimi dhe administrimi i monumenteve, paraqesin një njësi të vetme, nëse do të kishin në konsideratë, vlerësimin e monumenteve si termin sintetizues të synimeve për ruajtjen e kësaj trashëgimie kulturore shumë-përmasëshe, për sot dhe për brezat e ardhshëm. Synimi për depërtimin në ecurinë e përbërësve të mësipërm padyshim kërkon zbatimin e metodës së analizës, duke shkëputur terma të veçanta, për të shtjelluar ato në zhvillimin kohor, duke mundësuar kështu ndjekjen e ndryshimeve*[1]). Ndërkaq, sipas përfundimit të akteve ndërkombëtare për konservimin dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore të përcaktuara në Athinë më 1931, Venecia më 1964 dhe në Romë më 1981, me nocionin *trashëgimi historike,* nënkuptojmë, jo vetëm disa objekte arkitektonike, por dhe lagjet e qyteteve apo fshatrave; vendzbulimet, lokalitetet, objektet e paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe vlerat dhe pasuritë natyrore etj. të cilat në vetvete përmbajnë cilësi për qytetërimin njerëzor dhe për zhvillimin e tij ose për ndonjë ngjarje historike dhe të caktuar. Raporte, këto që me kohë kanë fituar një rëndësi kulturore, historike, arkitektonike, arkeologjike, etnografike, konfeksionale, estetike, shkencore, arsimore etj.[2])

Nuk ka dyshim se, institucioni i trashëgimisë së krijuar prej njeriut në shekuj dhe asaj natyrore, si njëri prej përbërësve kryesore të urbanistikës, sot zë vend me rëndësi në planifikimin dhe rregullimin e hapësirës dhe të venbanimeve të një vendi dhe më gjerë në arenën ndërkombëtare, duke u sanksionuar me dispozita ligjore dhe duke u rregulluar me akte juridike, urbanistike (akte ligjore, nënligjore, plane, projekte dhe programe: hulumtuese, zbuluese, konservuese, restauruese, rikultivuese, revitalizuese, mirëmbajtëse dhe shfrytëzuese të trashëgimisë monumentale).

Hapësirat shqiptare, si dje në kufijtë autoktonë etnikë iliro-shqiptarë, ashtu edhe sot në kufijtë tejet të tkurrur ruan pasuri të mëdha historiko-kulturore. Gjatë historisë funksionimi i institucioneve fetare në trojet shqiptare përgjithësisht ka luajtur rol pozitiv për çështjen kombëtare, përkundër dhe disa dobësive. Në këtë kontekst edhe teqet dhe personalitetet fetare të tyre, si shehët dhe dervishët kanë pasur një rol pozitiv në këtë aspekt që dëshmohet edhe nga ky citat: *Nga çdo pjesë e studimit dalin rezultate shkencore të besueshme se funksionimi dhe roli i teqeve, nuk është mbështetur vetëm në ceremonitë fetare, por ato kanë pasur rol të gjerë kulturoro-historik. Në radhë të parë kanë ndikuar shehët e njohur të arsimuar të teqeve, të cilët kanë lënë gjurmën në kultivimin dhe zhvillimin*

DO NOT COPY

*e mendimit filozofik*[3]). Po ky autor më tutje thotë: *Rendet e dervishëve dhe teqeve ekzistojnë që nga kohët e hershme në Kosovë, Maqedoni, Sanxhak dhe në vende të tjera fqinje. Ata, kryesisht shfaqen edhe para depërtimit të osmanllinjve, ndërsa veprimtarinë e tyre e zgjerojnë me forcimin e pushtetit osman në këtë pjesë të Ballkanit. Ky ishte një proces i gjatë, i cili fillon në shek. XV – XVI dhe vazhdon deri para një periudhe jo fort të largët. Në disa rajone, para së gjithash në Kosovë dhe në Shqipëri, rendet e dervishëve ekzistojnë e veprojnë edhe në kohën tonë*[4]).

## Teqja e Madhe e Gjakovës dhe Teqja e Marash-Hisarit në Prizren, janë të një "barku" dhe të tarikatit "Sa'adi"

Teqja e Madhe e Gjakovës dhe Teqja e Marash-Hisarit në Prizren janë të një barku dhe i njëjti tarikat — Sa'adi. Këto dy teqe e kanë prejardhjen prej Pashallëkut të Bushtallinjve të Shkodrës, pikërisht prej Sheh Sulejman "Axhix Baba", koha e sundimit të Bushatllinjve la gjurmë në kujtesën historike të popullit, prandaj quhet **Koha e Vezirit**. Ja çfarë thotë konsulli austriak në Shkodër, Th. Ippen: *Periudha e sundimtarëve autoktonë është për Shkodrën, periudhë lulëzimi në kohën turke. Çdo gjë e shënuar që duket në qytet është nga kjo kohë*[5]). Autorët turq *Tariki Xhevdet dhe Sejahatnamesi* të **Evlija Çelebiut**, na njoftojnë se Bushatllinjtë, u kthyen nga katolicizmi në islamizëm në fillim të pushtimit të Shkodrës nga sulltan Mehmeti II më 1479[6]). Sipas Sheh Ismail Halil Agës, pema gjenealogjike e familjes së Bushtallinjve të Shkodrës, prej kalimit të tyre në islamizëm e deri te Sheh Sulejman "Axhiz Baba" është kjo:

Brezi I - Jusuf Beu, Sundimtari i Parë i Sanxhakut të Shkodrës, lindur më 1432, kaloi në islamizëm më 1479.
Brezi II - Mehmet Pasha
Brezi III - Jusuf Pasha II
Brezi IV - Ymer Pasha dhe vëllezërit e tij Sulejman Pasha, Ibrahim Pasha dhe Ahmed Pasha[7]).

Sipas traditës shqiptare, nëse në familje lind ndonjë fëmijë, atë e pagëzonte mysafiri, që ndodhej në konak. Edhe Mehmet Pashë Bushatin, e pagëzoi *sulltan Mehmeti II, i cili ishte mysafir në datën e lindjes së tij, duke ia dhuruar emrin e vet*[8]). Vlen të theksohet se *sulltan Mehmeti II Fatihu, ka jetuar prej v. 1432 – 1481*[9]). Sipas Sheh Muhamedit të Teqes së Madhe të Gjakovës, *Sheh Sulejman Efendi* "Axhiz Baba" (1537 – 1652), ka lindur në Shkodër, ku i kreu mësimet fillestare dhe medresenë shkëlqyeshëm. Në Stamboll mbaroi studimet e larta islame. Duke e parë se ishte inteligjent dhe njëri nga më të dalluarit e caktuan me detyrë të shenjtë, imam në xhaminë e oborrit mbretëror. Pastaj kreu edhe detyra të tjera të rëndësishme, si sekretar dhe një kohë mbante kronikën e ngjarjeve që zhvilloheshin në oborrin mbretëror[10]). Sipas këtij autori, Sheh Sulejman "Axhiz Baba" në Gjakovë, ka ardhur më 1582, ndërsa në Prizren ka shkuar më 1607, ku dhe ka themeluar Teqen **Marash-Hisar**. Ka ndërruar jetë më 1652 në moshën 115 vjeçare[11]). *Gjatë qëndrimit në Stamboll u martua dhe pas një viti (1567) i lindi dhe fëmija i parë, të cilin e quajti Danjoll... gjatë kohës sa ishte në postin e Sheh Ul Islamit, i lindi fëmija i dytë, më 1572, të cilin e quajti Lutfullah, kurse në vitin 1575, i lindi fëmija i tretë, të cilit i dha emrin Abdylvehap*[12]).

### Tarikati Sa'adi

Sipas Dr. Selçuk Eraydin, *feja paraqet një grup rregullash të vendosura nga ana e Allahut xh. sh. për nxitjen e njerëzve në rrugë të mbarë... Në themelin e çdo feje ekziston nënshtrimi ndaj dëshirës absolute. Qëllimi i vërtetë i gjendjes metafizike është ngritja shpirtërore dhe moralizimi*

*i qytetarëve. Ndërkaq, Sheriati është rrugë e Allahut e përcaktuar për robtë (njerëzit — H. I.) e tij me qëllim që ata të sistematizojnë jetën e tyre, ndërsa në terminologjinë e tesatvufit, tarikat do të thotë, rruga e cila të shpie te Allahu xh. sh. Sheriati (e drejta fetare islame) është më i përgjithshëm, kurse tarikati është më special*[13]). Sipas, Sheh Muhamed Shehu, të Teqes së Madhe në Gjakovë tarikatet e pranuara zyrtarisht në botë janë 12: **1)** Kadiri; **2)** Rufai; **3)** Sinani; **4)** Bektashi; **5)** Sa'adi; **6)** Halveti; **7)** Bedevi; **8)** Mevlevi; **9)** Shahzeli; **10)** Desuki; **11)** Nakshibendi; **12)** Bajram – Melami[14]). Themelimi i tarikatit Sa'adi i madhëruari Saadeddin me dërgimin e zotërisë sonë Hazretit Pir-i Xhibaviu (1172 – 1279)[15]). Sipas, Sheh Muhamed Shehut, tarikati Sa'adi është njëri prej tarikateve më të përhapur në botën islame. Është mjaft i përhapur në trojet shqiptare dhe më i përhapuri në qytetin e Gjakovës. Nga Gjakova prej Sheh Sulejman "Axhiz Babait", zuri të përhapej nëpër trojet shqiptare. Së pari në qytetin e Prizrenit, dhe më vonë nëpër vendbanime të tjera duke u përhapur nëpër tërë Ballkanin.[16])

## Arsyet e vënies nën Mbrojtje të këtyre dy Objekteve Monumentale — Teqes së Madhe të Sheh Shefqetit në Gjakovë dhe të Tyrbes Marash – Hisar në Prizren

Vënia në mbrojtje institucionale, rivitalizimi, restaurimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi racional dhe me një përkujdesje institucionale ndaj trashëgimisë monumentale, paraqesin aktin më vlerësues, të institucioneve dhe qytetarëve të një vendi ndaj trashëgimisë kulturore, e cila ka rëndësi shkencore, kulturore dhe historike.

Sipas nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen e Përmendoreve të Kulturës[17]), përmendoret e kulturës mbrohen me qëllim:

- Të ruajtjes së përmendoreve në gjendjen e papërdhosur dhe burimore;
- Të krijimit të kushteve sa më të vlefshme dhe për marrjen e masave të nevojshme për mirëmbajtjen e tyre të rregullt;
- Të pengimit të çdo veprimi me kryerjen e të cilit mund të ndryshohet drejtpërdrejtë apo tërthorazi cilësia, forma, rëndësia apo pamja e përmendoreve të kulturës;
- Të sigurimit të kushteve që përmendoret e kulturës sipas destinimit dhe rëndësisë së tyre t'u shërbejnë nevojave kulturore të njerëzve, punëtorëve dhe bashkësisë shoqërore.

Kurse sipas nenit 2, paragrafi 2.1, Projektligji për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës, ende të panënshkruar nga Shefi i UNMIK-ut (PSSP të OKB-së), me këtë ligj trajtohet trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe e luajtshme, e cila, kryesisht konsiston në:

- Monumente, si vepra arkitekturore, vepra monumentale të skulpturës ose të pikturës, elementët ose strukturat e karakterit arkeologjik, mbishkrimet dhe grupet e elementëve që kanë vlera të veçanta nga aspekti historik, artistik ose shkencor.

Ndërkaq sipas nenit 3 të Kartës Ndërkombëtare për Konservimin dhe Restaurimin e Monumenteve dhe Siteve, Venecia 1964[18]; konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë kanë për qëllim që të ruajnë jo vetëm veprën artistike, por edhe dëshminë historike. *Sipas nenit 7* të kësaj konvente *"Trashëgimia është e pandarë nga historia, dëshmitar i së cilës është dhe mjedisi në të cilin është e vendosur..."*[19].

Në këto rrethana të vënies në mbrojtje dhe përkujdesjeve të duhura, ndër veprimet juridiko-administrative më të qëlluara për institucionet përkatëse të komunës së Gjakovës dhe të Prizrenit, si dhe ato përkatëse të Qeverisë së Kosovës, do

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të ishte edhe vënia në mbrojtje dhe përkujdesje institucionale të Teqes së Madhe dhe të Tyrbes së Sheh Shefqetit të Teqes së Madhe në Gjakovë si dhe të Tyrbes e të Teqes Marash – Hisar, me kompleksin e saj në lagjen e njohur të Prizrenit - Marash.

Teqja e Madhe dhe Tyrbja e Sheh Shefqetit në Gjakovë dhe Tyrbja e Teqja e "Axhiz Babasë", në Marash – Hisar në Prizren, e meritojnë vënien nën mbrojtje dhe përkujdesje institucionale për shumë arsye. Ato janë institucione fetaro – publike që kanë kontribuar në aspektin fetar dhe kanë vlera arkitektoniko-historike. Me të drejtë akademiku Jashar Rexhepagiqi, shkruan: Axhiz Babai është një personalitet që ka merita të mëdha për kulturën islame dhe veçanërisht për themelimin dhe popullarizimin e tarikatit Sa'adi në Gjakovë, Prizren dhe në pjesë të tjera të Kosovës e më gjerë. Teqja e Madhe në Gjakovë ka qenë dhe ka mbetur kryesorja për të gjitha teqet e Rendit Sa'adi nën të cilën janë subordinuar të gjitha teqet e këtij rendi, në radhë të parë ato të Kallitaxhizi, në Kosovë, në Maqedoni, Shqipëri dhe në vendet e Serbisë J (Kosovën L, Sanxhaku i Pazarit të Ri dhe Sanxhaku i Nishit – H.I.) ku kanë ekzistuar dhe ekzistojnë këto teqe[20]. Pastaj për Axhize Babën, thuhet: Axhize Baba përveç divaneve (përmbledhje poezish) në gjuhën turke dhe persiane ka shkruar dhe për moralin, filozofinë dhe mistikën islame. Më së shumti ka shkruar në Teqen Marash – Hisar, në Prizren. Një vepër e tij për etikën dhe tesatvufin ruhet në bibliotekën Akif Valideja në Stamboll. Për Sheh Sulejman Axhiz Baba, dëshmohet se ka ditur 42 disiplina filozofike, shoqërore dhe të shkencave natyrore[21]. Në vazhdimin e veprimtarisë së vet fetaro-shoqërore Sheh Sulejman Efendiu, duke qenë i kënaqur se tani në Teqen e Madhe kishte trashëgimtarin e denjë, Sheh Danjollin, ai vetë me djalin e tretë e më i vogli, Abdylvehapi, u shpërngul në Prizren me qëllim që atje të themelonte një teqe të re për tarikatin Sa'adi[22]. Në tërësinë e kontributit fetaro-publik të Sheh Sulejman Axhiz Babait, me djemtë e tij, duhet veçuar se të dy djemtë e Sheh Sulejman Axhiz Babës, vijojnë mësimet e Medresesë, dhe pasi i kryenë ato me sukses, emërohen që të shërbejnë, në xhaminë e Hadumit në Gjakovë, Sheh Danjolli si imam, dhe Sheh Lurtfullahu si muezin[23]). Personalitete të tjera, të jetës fetare dhe shoqërore të këtyre dy institucioneve të shquara fetare dhe publike janë:Musa Efendi Shehu (1870 – 1944), i cili ishte njëri nga udhëheqësit e Lidhjes II Shqiptare të Prizrenit dhe myfti (klerik i lartë musliman), i lindur në Gjakovë. Ai kishte një kulturë të gjerë, përparësi i jepte shkollimit, lirisë dhe mirëqenies së popullit. Nëpërmjet shoqërive bamirëse, Merhamet dhe Gajret, ai e fokusoi veprimtarinë e vet kombëtare, fetare dhe bamirëse, duke kërkuar edhe ndihma për atdhetarët shqiptarë. Ai në kohë të vështira, u vu në krye të Lidhjes II së Prizrenit... Komunistët pushkatuan më 1944, edhe Sheh Hysen Shehun (1912 – 1989), lindur në Prizren, filloren e kreu në vendlindje, të mesmen në Shkodër, ndërsa studimet e larta i kreu në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Stambollit. Pas kthimit në vendlindje, Prizren, ai punoi në disa institucione, por në v. 1954, drejtoria e atëhershme për arsimin në Prizren e pushoi nga puna, sipas "diagnozës", tashmë të njohur edhe ndërkombëtarisht: i papërshtatshëm në pikëpamje politiko-morale. Personalitet tjetër të këtij barku familjar, që duhet përmendur është Sheh Qamil Shehu (1885 – 1928). Ndër fetarët dhe veprimtarët e shquar të dy teqeve të sipërshënuara, pa dyshim, duhet veçuar Sheh Shefqeti (1900 – 1952), i cili lindi në Gjakovë. Pas kryerjes së shkollimit të lartë, në moshën 29 vjeçare, pra më 1929, përgatitet të shkojë në Sham (Damask) të Sirisë në Teqen e Sheh Ibrahimit, për ta marrë Hilafetnamen (dëshminë për sheh), por u pengua, u sulmua dhe u burgos nga qeveritarët dhe veglat e Serbisë pushtuese, duke e burgosur në Damask dhe Kosovë disa herë, për shkak të qëndrimit dhe veprimtarisë fetare dhe kombëtare.

DO NOT COPY

Duhet theksuar qëndresa e tij ndaj shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Gjakova dhe e tërë Kosova, prej pushtetit të egër sllavo-komunist. Sheh Shefqeti, i Teqes së Madhe, ka gëzuar një respekt dhe nderim të madh pa marrë parasysh tarikatin, fenë dhe kombin në Kosovë e më gjerë, të cilin e ruan edhe sot. Shumë qytetarë përbetohen "pasha Teqen e Madhe dhe pasha Sheh Shefqetin". Por, ai ishte i përbuzur dhe i urryer nga pushteti antishqiptar serb i vendosur në Kosovë dhe i servilëve të tij, siç dëshmohet me faktin se sipas traditës, Sheh Shefqeti pas ndërrimit të jetës, ai duhej të varrosej në Tyrben e Teqes së Madhe të Gjakovës, për çka edhe ishte hapur varri më 12 mars 1952, mirëpo nga komiteti i komunistëve dhe nga komuna e Gjakovës, erdhi vendimi që rreptësisht të ndalohet varrimi i Sheh Shefqetit në Tyrben e Teqes së Madhe në Gjakovë, por duhet të varroset në varrezën e qytetit apo diku tjetër. Sheh Shefqeti njihte gjuhët lindore si dhe frëngjishten. Pas kryerjes së detyrës fetare ai ushtronte mjeshtërisht zejen e zdrukthtarisë. Prej shkollës së tij, dolën shumë mjeshtër të përcaktuar mirë kombëtarisht dhe profesionalisht.

Teqja e Madhe në Gjakovë dhe Teqja Marash – Hisar në Prizren, i kishin dyert e hapura për të gjithë ata që shkonin për mirë dhe nevoja të arsyeshme. Në rrethana të personaliteteve të këtyre institucioneve fetare, duhet veçuar Esad Sheh Abdylvehapi, me përgatitje universitare, Xhemil Muhamed Shehu, arkitekt i diplomuar dhe Aqif Muhamed Shehu, veprimtar, sportist dhe kryetar i Asamblesë Komunale në Gjakovë, pas v. 2000 dhe Senullah Sheh Jahjaja, inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, etj.

### Rëndësia arkitektonike trashëgimore e Teqeve në Gjakovë dhe në Prizren

Komplekset arkitektonike të Teqes – Tyrbes, Teqja e Madhe në Gjakovë dhe të Tyrbes e Teqes Marash – Hisar në Prizren kanë rëndësi të shumëfishtë. Sheh Sulejman Axhiz Baba, më 1582, erdhi nga Damasku në Gjakovë vetë i pestë (me gruan dhe tre djemtë). Aty filloi të ndërtojë një teqe më 1582, që edhe sot ekziston dhe quhet Teqja e Madhe. Ajo ngrihet në Fushë të Sahatit, në mes të qytetit, afër lumit Krena dhe Shtëpisë së Shëndetit Isa Grezda. Në kompleks ndërtimet kapin një sipërfaqe deri në 40 ar. Përveç Teqes dhe Tyrbes me kobure dhe disa varezave në oborrin e Teqes, janë edhe shtëpitë e djemve të Sheh Shefqetit, përkatësisht të nipave të tij. Teqja dhe Tyrbja e Teqes së Madhe, sidomos interieri, shquhen me një arkitekturë dhe dekor autokton shqiptar dhe oriental fetar islam të tarikatit përkatës. Veçmas një radhitje, zbukurim dhe mirëmbajtje kanë koburet e shehlerëve, të dervishëve dhe shehzadeve etj., 25-sish.

Në kompleksin Ndërtimor të Teqe – Tyrbes Marash – Hisar, fjala marash, në gjuhën persiane, do të thotë: gjelbërim – freski. Ky kompleks ngrihet në pjesën më të bukur të qytetit të Prizrenit, në pjesën VL të tij, rrëzë shkëmbit të Kalasë dhe buzë Lumbardhit të Prizrenit. Kompleksi i Teqe – Tyrbes Marash – Hisar, në Prizren, kishte një sipërfaqe 90 ar. Në kuadër të Teqes Marash – Hisar, gjendeshin ndërtesa e Teqes, Tyrbja, Xhamia, mulliri me gjatë guri dhe 10 – 15 shtëpi me oborre. Në afërsi të Teqes dhe të Tyrbes ka pasur edhe varre të familjarëve të Shehut. Kompleksin e ndan vija e ujit për mullinjtë dhe një krua me gjashtë gurra, lisa, dhe një rrap mjaft i vjetër dhe tejet i bukur është një simbol dhe mit. Kujtesa popullore tregon se kur filloi të ndërtojë shtëpinë e tij, disa njerëz e pengonin punën, por Sheh Sulejmani, rrinte i qetë, duke u nxehur pranë zjarrit! Ata jo vetëm që e pengonin ndërtimin, por edhe i bërtisnin duke i thënë: Çohu dhe ik prej këtu...! Sheh Sulejmani mori tre dru nga zjarri, që po digjeshin dhe iu tha: Këto tri dru të kallne po i nguli në tokë, nëse zënë rrënjë e çelin gjethe, atëherë a kishit me më lejue me ndërtue shtëpinë këtu? Posi jo! – i thanë ata. Me fuqinë e Perëndisë, Sheh Sulejmani i nguli drutë e djegura

në tokë, të cilat zunë rrënjë dhe çelën gjethe aty për aty…[24])! Sikurse shumë objekte fetare, publike dhe private shqiptare edhe Teqja Marash – Hisar nuk i shpëtoi djegies dhe rrënimit bashkë me disa varre të familjes së Sheh Sulejman Axhiz Babës, më 1950. Pastaj këtij kompleksi iu mor një sipërfaqe e madhe për ndërtimin e një motel – restoranti për qëllime politike, duke synuar ta shkatërrojnë dhe shëmtojnë kompleksin tejet piktoresk, atraktiv dhe domethënës, historik dhe etnografik, që shquhet edhe me vlerat mjedisore. Mjerisht edhe qytetarët ndërtuan dhe rindërtuan objekte në këtë kompleks në kundërshtim me vlerat burimore dhe rëndësinë që ka ai. Madje edhe pas v. 1999, ka ndërtime dhe rindërtime në kundërshtim me vlerat burimore të kompleksit, siç kemi rastin me ndërrimin e vendit të krojeve, me mbylljen e mullinjve dhe me ndërtimin dhe shndërrimin e shtëpive në lokale për affari etj.

### Pikëpamjet rreth lashtësisë së Tarikatit Sa'adi në Ballkan, përkatësisht të Sheh Sulejman Axhiz Babait në Gjakovë dhe Prizren

Sheh Ismail Agai, tarikatin Sa'adi, në veprën e vet *Vendet e shenjta Shqiptare – Tarikatet,* shkruan: *Ndër përhapësit e parë të Tarikatit Sa'adi, historikisht i argumentuar njihet Axhize Babai me origjinë nga Bushatllinjtë e Shkodrës, Shqipëri. Axhize Babai u vesh Irshad Kalif në Sham të Arabisë, aty nga shek. XV dhe u caktua në Gjakovë, Kosovë për të përhapur zavien (zgjerim i tarikatit Sa'adi në Ballkan), fakt për këtë sot janë tyrbe e teqe të Axhize Babait në Prizren, ku sot, ka shkuar drejt një institucioni fetar ballkanas me lidhjet e saj shpirtërore Teqen e Madhe të Sa'adive*[25]). Ndërkaq në librin e dytë, *Tarikari Islam Sa'adi,* ky autor shkruan: *Sheh Axhiz Babai, ka lindur në Shkodër – Shkodër. Rrjedh nga dera e Bushatllinjve dhe nip i ish-Vezirit të Shkodrës, i diplomuar në Turqi dhe bërë Kalif nga dora e ndritur e Ibrahim Ebul Vefa në Dergjahin e zotërisë sonë (udhërrëfyesit) Sër Sadedin El Xhibaviut në Hazret Pir dhe është varrosur në Prizren në v. 1748, ku ka dhe teqen e tij. Ka jetuar 111 vjet.*[26]) Në rastin e dytë përkatësisht në këtë rast, del se, Sheh Sulejman Axhiza Baba, ka lindur më 1637, pra 137 vjet më vonë, sesa ka theksuar në librin e parë, në shek. XV. Të dhënat e librit të dytë se ka vdeur në v. 1748 dhe ka jetuar 111 vjet, i mbështetur në referimin siç vijon: *data e lindjeve të Shehlerëve janë përafruar nga të dhënat e disa Gjenezave të Gjakovës, nga puna e vyer e Sheh Muhamedit të Teqes së Madhe të Sa'adive (në Gjakovë ¯ H. I.).*[27]) Sipas autorit Vefa Karahoda, Sheh Sulejman Axhiza Baba, themelues i tarikatit Sa'adi të Teqes së Madhe në Gjakovë dhe të Teqes Marash – Hisar në Prizren, lindi në v. 1537 në Shkodër. Ishte i biri i Ahmed pashë Bushatlliut, dhe rridhte nga një familje e pasur dhe besnike[28]). Kjo e dhënë përputhet edhe me të dhënat e Sheh Muhamed Shehut, i cili shkruan: *Sheh Sulejman Efendiu, është i biri i Ahmed pashë Bushatlliut, ai lindi në Shkodër, në v. 1537 dhe vdiq më 1652 në Prizren ¯ H. I., që do të thotë që ka jetuar 115 vjet. E dhënë,kjo që përafërsisht përputhet me të dhënën se ka jetuar 111 vjet. Por nuk përputhet viti i lindjes i Sheh Sulejman Axhiz Babait për 137 vjet.*

Sheh M. Shehu i Teqes së Madhe në Gjakovë, nuk pajtohet me konstatimin e Hasan Kaleshit, i cili thotë: *Sheh Sulejmani përveç që ka përhapur mësimin e vet nëpër Rumeli, ai është themelues i Teqes së Madhe Sa'adi në Gjakovë. Teqja, është e ndërtuar në v. 1732 – 1733. Kur është rritur djali i tij, Danjolli, ka shkuar dhe është vendosur në Prizren, ku ka ngritur Teqen në lagjen Marash (1733) …Axhize Babai, është varrosur në Prizren, në v. 1747.*[29]) Po ashtu Shehu i tanishëm i Teqes së Madhe në Gjakovë, z. Sheh Muhamed Shehu, nuk pajtohet as me mendimin e Nexhat Krasniqit, i cili në punimin; Dy Dokumente Gjenealogjike të Rëndësishme, botuar në revistën *Dituria Islame,*

DO NOT COPY

nr. 59/'94, f. 13 – 19, thotë se: *Teqja e Madhe në Gjakovë e themeluar më 1732 – '33, dhe Teqja e Axhiza Babait në Marash, Prizren, janë themeluar më 1734*[30]).

Sheh M. Shehu i Teqes së Madhe në Gjakovë, nuk pajtohet me konstatimet e këtyre dy autorëve të sipërshënuar, të cilët nuk dallojnë në mes veti, sa i përket viteve të shënuara të themelimit të teqeve sa'adi në Gjakovë dhe në Prizren, ngase *nuk i mbështesin konstatimet e veta në faktografi.* Libri i shënimeve ¯ ditari (divani) i Teqes së Madhe në Gjakovë në original nuk ekziston, sepse është djegur në v. 1934, kurse përshkrimet e tij, nuk janë identike, por janë përshkruar sipas dëshirës së autorëve të tjerë. Pastaj, këta dy referees nuk më kanë këshilluar as mua, që t'iu jap gjenealogjinë e shehëve të Teqes së Madhe nga Sheh S. A. Babai e deri sot. Kurse në librin *Dervishët, Rendet dhe Teqetë,* nga akad. J. Rexhepagiqi, thuhet: *Medoemos duhet tërhequr vërejtja se disa të dhëna lidhur me themelimin dhe fillimin e kësaj téqeje, si dhe themelimin e teqesë së rendit sa'adi në Prizren, nuk përputhen me dokumentet, të cilat i posedon Teqja e Madhe në Gjakovë. Këtu posaçërisht duhet veçuar grafika e gjenealogjisë së shehëve të Teqesë së Madhe Sa'adi në Gjakovë,të cilën, siç thekson vetë, e ka hartuar Shehu i Tanishëm, ¯ Muhamedi ¯ në bazë të Divanit dhe burimeve të tjera, që e ka përfunduar më 31. 12. '89. Në dokument gjejmë emrat e tërë shehëve me vitin dhe vendlindjen. Ndryshe nga data të cilat i kanë shënuar H. Kaleshi, N. Krasniqi, N. Hafizi etj., në këtë dokument jepen të dhëna: se Sheh S. A. Babai ka ardhur në Gjakovë, më 1582 dhe shumë shpejt ka themeluar këtu Teqen e Madhe, ¯ se A. Babai ka shkuar në Prizren më 1607, ku së shpejti themeloi teqén në Marash, se Sheh Sulejman Efendiu, ka vdekur më 1652, ¯ se edhe sot ekziston tyrbja e tij në Marash, Prizren, se teqja e tij në Marash, nuk është rrënuar më 1945, as më 1947, por më 1950.*[31])

Për lashtësinë e Teqes së Madhe të Gjakovës dëshmon edhe ky citat: *Por, Ali Shehu i Teqes së Madhe, pasi mori leje nga Kajmekani e pyeti Shefki Aganë se cilët ishin të sëmurët dhe sa ishin*[32])? Është fjala për sëmundjen (epideminë) e murtajës që u shfaq në Iliri (Ballkan) në v. 1495 – 1567 ... dhe murtaja e tretë rreth v. 1646[33]). Edhe kjo e dhënë përputhet përafërsisht me të dhënat e Sheh Muhamed Shehut, në librin e tij, *Sheh Shefqeti dhe Teqja e Madhe* (në shërbim të zotit, në shërbim të popullit, f. 86).

Akademiku Jashar Rexhepagiqi në librin e theksuar, i referohet autorëve serbë, malazezë, maqedonë, boshnjakë, turq, shqiptarë etj. si: Liljana Çoliç, Xhemail Çehajiç, Aleksandër Stojanovski, Evlija Çelebiu, Kosta Kostiq, Sabit Uka, Branislav Nushiq, Mark Tirta etj. që dëshmojnë se *teqe e tyrbe shqiptare ka pasur edhe në Nish, Podgoricë Shkup, Vranjë, Quperli (Veles), Kumanovë, Manastir, Tivar, Ulqin, Uzhicë etj.* Mjerisht në shumicën e këtyre vendeve dhe vende të tjera këto objekte janë zhdukur bashkë me dëbimin me dhunë të shqiptarëve nga trojet e tyre autoktone. Fatkeqësisht, ende, për këto vlera nuk po tregohet interesi i duhur.

E dhënë tjetër që e dëshmon se Sheh S. A. Babai ka lindur më 1537 në Shkodër, kurse në Gjakovë ka ardhur më 1582, është ajo se *xhamia e Hadumit në Gjakovë, ka filluar të ndërtohet rreth v. 1571 dhe ndërtimi i saj ka zgjatur gati një çerek shekulli - deri më 1594*[34]. *Derisa* Sheh Sulejmani e zhvillonte veprimtarinë e vet në teqe, djali i tij i madh, Danjoll Efendiu (1567), ishte muezin në xhaminë e Hadum Agait, kurse djali i dytë, Lutfullah Efendiu (1572), ishte muezin po në të njëjtën xhami[35]. Pastaj kemi dhe rrapin e madh shekullor të mbjellë nga vetë Sheh S. A. Babai, për çka ka dhe rrëfime për mënyrën e mbeltimit të tij.

Sheh M. Shehu i Teqes së Madhe, kishte vërejtje për librin e Akad. J. Rexhepagiqi, *"Dervishët, Rendet dhe Teqetë"*, Pejë '99, si në f. 18, *nuk janë*

DO NOT COPY

*caktuar datat e ndërtimit të teqeve në Gjakovë dhe Prizren.* Baba Danjolli nuk ka pasur teqe dhe tyrbe në Tepelenë dhe Pezë etj., siç theksohet në f. 152 të librit në fjalë. Në f. 177, gjenealogjia është treguar gabimisht, sepse mungon djali i dytë i Sheh Lutfiut, Akif Efendiu (1860). Tërë tekstin e përshkon mungesa e datave apo mos-përputhja e tyre me të vërtetën, etj.

### Trashëgimia Monumentale Shqiptare pa Përkujdesjen e Duhur Institucionale

Trashëgimisë monumentale, institucionet shtetërore dhe profesionale, por edhe qytetarët, duhet t'i kushtojnë kujdes parësor, veçmas asaj që ka qenë në shënjestër nga pushteti i okupuesit serb në Kosovë. Këto vlera të shumta me rëndësi të veçantë, janë nën ndikimin e dhëmbit të kohës dhe ndonjëherë të dorës së pamëshirshme të njeriut të pandërgjegjshëm. Edhe ato monumente që janë restauruar dhe janë vënë nën mbrojtje në Kosovë pas luftës shkatërrimtare dhe genocidit serb (1. 10. '97 – 12. 6. '99), nuk u vunë nën mbrojtje dhe përkujdesje, sipas përparësive, rëndësisë dhe vlerave. Kështu lagjia Marash, si pjesë përbërëse e Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit mbeti anash. Kujdes duhet treguar dhe për lagjet, komplekset ndërtimore, kalatë, lokalitetet arkeologjike, ndërtesat dhe kullat e shkatërruara, veçanërisht në luftën e fundit në Kosovë.

Gjatë kësaj lufte objektet me vlera historiko-kulturore shumë prej të cilëve të vëna në mbrojtje si monumente, kryesisht të përkatësive shqiptare u dëmtuan dhe u shkatërruan. Mjaft të përmendim Çarshinë e Gjakovës, një numër të madh banesash popullore, kryesisht të tipit kullë, të cilat u shkatërruan, duke prurë një dëm të pallogaritshëm në këtë trashëgimi kulturore. Edhe monumentet shqiptare të kultit musliman pësuan shkatërrime të papara.

Prej 560 xhamive sa kishte gjithsej para luftës në Kosovë, 218 u dogjën, u shkatërruan dhe u dëmtuan. U dogjën dhe u shkatërruan nga themeli 4 medrese të vjetra, ndërsa u shkatërrua në tërësi objekti i ri i medresesë Alaudin në Prishtinë, u dogjën dhe u shkatërruan 3 teqe, 1 hamam, 75 dyqane pronësi vakëfi, u dogjën e u shkatërruan 302 shtëpi të imamëve. Nga dora vrastare serbe u vranë 16 imamë, 1 punëtor administrativ i Kryesisë së Bashkisë Islame dhe 14 nxënës dhe ish-nxënës së Medresesë së Mesme Alaudin në Prishtinë... U shkatërruan 86 minare, 117 mihrabe, 120 tyrbe, 114 kube, mbi 560 arabeska origjinale dhe autoktone të artistëve shqiptarë, madje disa të vjetra dhe me shekuj, mbi 12 mijë dorëshkrime dhe mushafë të djegur.[36] Ndërkaq objektet e restauruara, nuk u restauruan sipas gjendjes dhe vlerave burimore, siç e patëm rastin me kullat në Kosovë, veçmas në Junik. Kujdes i veçantë i duhet kushtuar gjurmimit sistematik në mbarë hapësirën e Kosovës për të identifikuar ndërtimet me vlera historiko – kulturore, pavarësisht prej llojit të tyre dhe kohës së ndërtimit, të cilat duhet të vihen, sa më parë në mbrojtje. Prania e trashëgimisë kulturore të Kosovës, nuk i përket vetëm asaj por mbarë njerëzimit dhe si e tillë përkujdesjet shumëplanëshe për të duhen shtuar dhe thelluar në përputhje me kriteret e njohura ndërkombëtare.

DO NOT COPY

1) E. Riza; *Mbrojtja dhe Restaurimi i Monumenteve në Shqipëri,* Tr. 1997, f. 7.
2) Vladimir Brguljan; *Sistemi ndërkombëtar i mbrojtjes së vlerave kulturore dhe natyrore,* Zagreb-Beograd 1985, f. 172.
3) *Akad.* Jashar Rexhepagiçi; *Dervishët dhe Teqetë në Kosovë, Sanxhak dhe në Rajonet e Tjera në Rrethe,* Pejë 2003, f. 7.
4) *Po aty,* f. 9.
5) Hamdi Bushati; *Bushatllinjtë,* Shkodër 2003, f. 29.
6) *Po aty,* f. 34.
7) Sheh Ismail Halil Aga; *Tarikati Islam Sa'adi,* Tr. 1996, f. 35.
8) Bushati; *vep. cit.,* f. 42.
9) Pasho Baku; *Fjalor Enciklopedik,* Tr. 2002, f. 461.
10) Sheh Muhamed Shehu; *Sheh Shefqeti dhe Teqja e Madhe,* Gjakovë 1998, f. 74.
11) *Po aty.*
12) Vefa Q. Karahoda; *Sheh Sulejmani "Axhiz Baba" dhe Tarikati "Sa'adi",* Prizren-Gjakovë 1997, f. 10-11.
13) Dr. Selçuk Eraydin; *Tesatvufi dhe Tarikatet,* Tetovë 2001, f. 301-302.
14) Shehu; *vep. cit.*, f. 38.
15) Karahoda; *vep. cit.*, f. 6.
16) Shehu; *vep. cit.* f. 71-72.
17) Gaz. Zyr. e Kosovës; nr. 19/1977.
18) T. Marsoviç; *Zashtita Graditeljskog Nasljedja,* Zagreb-Split 1938, f. 134.
19) *Po aty,* f. 135.
20) Rexhepagiqi, *vep. cit.,* f. 192.
21) 1. Enciklopedia Islame I, Stamboll 1950, f. 601 dhe 666. 2. Sheh Aga; *vep. cit.*, f. 45.
22) Shehu; *vep. cit.*, f. 77.
23) Divani i Axhize Babës, f. 66-67.
24) Shehu; *vep. cit.,* f. 74.
25) Sheh Aga; *Tarikatet Islame Shqiptare,* Sadizma-Tropojë 1995, f. 28.
26) Sheh Aga; *vep. cit.,* f. 49.
27) *Po aty.*
28) Karahoda; *vep. cit.,* f. 9.
29) **1.** *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame,* Prizren '91, f. 40. / **2.** *Pr. Dr.* Jashar Rexhepagiçi; *Dervishët, rendi dhe teqet,* Pejë '99. f. 139.
30) Rexhepagiqi; *burim i mësipërm,* f. 139.
31) *Po aty,* f. 176.
32) J. Buxhovi; *Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit,* Prishtinë '82, f. 53.
33) *Po aty,* f. 77.
34) Shehu; *vep. cit.,* f. 99.
35) *Po aty,* f. 77.
36) H. Sabri ef Bajgora; *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (shkurt '98 - qershor '99),* Prishtinë '00, f. 8.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

# The "Big Tekke" of Gjakova and the Tekke "Marash Hisar" in Prizren should be under state protection

Through all the course of the Albanian history the religious institutions have played a constructive role for the nationwide issue.

Among the religious institutions in Kosovo, we should mention the big Tekke in Gjakova, that of Marash Hisar in Prizren and that of Sa'adi Tarikat. Those institutions have their starting point from the period when the Bushatllinj feudalists ruled. The Sa'adi tarikat is widely extended in the Albanian tribes, especially in Gjakova, later in Prizren and other inhabited centers. The Big Tekke in Gjakova and the tekke of Axhiz Baba and their respective **"tyrbe" (mausoleums over the Moslem grave)** deserve the protection of the state and the institutional care that derives from it. The big Tekke of Gjakova remains the main tekke among the other tekkes of the Sa'adi rank. The Sheh Suleiman Effendi (1537-1652) or "Axhize Baban" is the man who built the before mentioned tekkes in Gjakova and Prizren.

The Big Tekke in Gjakova and the tekke of "Axhize Baba" in Marash –hisar in Prizren together with their Tyrbe have their contribute, in the religious aspect, and have also architectural and historic values.

The Big Tekke in Gjakova is founded in 1582, in the central part of the town near the Krema River.

The Big Tekke of Gjakova and its tyrbe are distinguished for their architecture and decoration. There are founded not only native decorative elements but also oriental ones.

The construction complex of the tekke and the tyrbe of Marash Hisar in Prizren are built in the most beautiful part of the town, in the north-eastern part of it, in the bottom of the castle rock along the Lumbardh River that passes through the town.

The complex has suffered damages of different levels, but it still keeps historical and cultural values.

These are the reasons why these two tekkes and their tyrbe should be protected as monuments, which come in nowadays as a touchable testimony of the past.

DO NOT COPY

Prof. Dr Valter SHTYLLA

# Digat e vjetra në Shqipëri

Me një terren përgjithësisht malor, Shqipëria karakterizohet nga burime të shumta ujore. Gjatë gjithë historisë së tij populli ynë e ka përdorur ujin në mënyrë racionale duke ndërtuar vepra të ndryshme për këtë qëllim. Prej antikitetit e deri në mesjetën e vonë në trojet tona janë ndërtuar ujësjellsat, krojet, sterat, puset, mullinjtë, dërstilat etj, mjaft prej të cilave ruhen deri më sot. Në krahina të ndryshme të vendit hasen ndërtime të tilla historike që mbrohen ligjërisht me statusin e monumenteve të kulturës. Një kategori e rëndësishme e ndërtimeve ujore kanë qenë digat për grumbullimin e ujërave në rezervuarët ujëmbledhës. Fshatarët vendas, duke shfrytëzuar burimet ujore dhe terrenin e përshtatshëm gjithmonë kanë tentuar të ndërtojnë diga në afërsi të tokave të tyre. Digat si një ndërtim i nevojshëm për bonifikimin e tokave bujqësore përfaqësojnë objekte hidroteknike që në vendin tonë janë njohur që në kohët antike, siç dëshmohet nga Diga e Krapsit në luginën e lumit Gjanicë në krahinën e Mallakastrës (Fig 1). Diga e Krapsit në luginën e Gjanicës, është ndërtuar në kufijtë e fshatrave Kraps e Lalar. Ajo ka një gjatësi të konsiderueshme, prej 133m dhe një gjerësi 4,7m. Ujëmbledhësi i krijuar grumbullonte rreth 1milion $m^3$ ujë.[1]. Diga e Krapsit përfaqëson një konstruksion hidroteknik të periudhës romake, që i takon shekujve I - II e.s, ku shënohet dhe një intesitet i ndërtimeve të tilla në trojet e Perandorisë Romake. Në vazhdim, po në luginën e lumit Gjanicë ndodhet një tjetër pritë për bonifikimin e tokave buqësore.

Kjo është Prita e Patosit, me gjatësi 40m dhe gjerësi 2.4 m e ndërtuar gjatë shekujve IV-VI të antikitetit të vonë.

Me ardhjen e romakëve në Ballkan në shekullin e II p.e.s u rrit ndjeshëm intensiteti i ndërtimeve. Romakët patën një traditë të njohur në llogaritjen dhe ndërtimin e veprave hidraulike dhe hidroteknike, duke bërë objekte me vlerë në gjithë trojet e vendeve të Ballkanit, përfshirë dhe Shqipërinë.

Deri në ditët tona, një digë bonifikimi e periudhës romake ruhet gartë në fshatin Krane të Sarandës, buzë rrugës nacionale Muzinë – Sarandë, poshtë kodrës së vendbanimit antik të Finiqit(Fig 2). Diga e Kranes nga pikëpamja topografike mbyll një gropë në fundin e kodrave duke formuar një ujëmbledhës të vogël. Në gjendjen e sotme, nga kjo digë ruhet një fragment muri me gjatësi rreth 40m dhe gjerësi 1.35m. Si konstruksion diga paraqet një mur guri me trashësi 1.35m, i përfocuar nga ana e poshtme me kontraforte me trashësi 80 cm. Muri i gurit në dy nivele ndërpritet me nga katër rreshta tullash, të cilat datohen nga shekujt I – II e.s. Ato janë 4.5cm të trasha, 16 cm të gjëra dhe 29 – 33 cm të gjata. Përcaktimi i këtij muri si digë ujëmbledhëse mbështetet nga topografia e terrenit dhe nga zgjidhja konstruktive e vetë murit. Veç kësaj diga ndodhet pranë qendrash të njohura si Finiqi, Onhezmi, Butrinti etj.

Një rast tepër interesant në llojin e vet është Diga e Funarsit në zonën e Librazhdit (fig 3). Diga ose muri i Funarës, siç e quajnë banorët e zonës,

ndodhet tek vendi Funarsi i Balliut, rreth 1 km, mbi fshatin, në lindje të tij. Diga e Funarsit është ndërtuar për grumbullimin e ujërave të përroit të Funarës me qëllim vaditjen e tokave të fshatit. Rezervuari i ujit arrinte një sipërfaqe prej rreth 30 ha. Diga e Funarsit është ndërtuar në një grykë të përshtatshme të përroit dhe ka formë të kurbët në planimetri, me fryrjen nga ana e brendshme. Gjatësia e digës arrin 34m. Nga pikëpamja tipologjike kjo digë ka një zgjidhje interesante për kohën (fig.4). Ajo është ndërtuar me dy perde muresh, i jashtmi dhe i brendshmi, të ndarë ndërmjet tyre prej një kanali (boshllëku) në mes, i cili mbushet me argjil. Duket qartë se në këtë rast kemi të bëjmë me tipin e një dige hark guri me bërthamë argjili, një shëmbull i njohur edhe sot në teknikën e ndërtimit të digave. Nga ana e poshtme e digës, murit të jashtëm, i mbështeten kontraforte mur guri për përballimin e presionit hidrostatik të ujit dhe të presionit të dherave. Në gjëndjen e sotme Diga e Funarsit ka arritur mjaft e dëmtuar. Asaj i mungon gjysma e perdes së sipërme, ndërsa muri i poshtëm, apo i jashtëm, është mjaft i rrjepur. Në mesin e digës është hapur një vrimë për kalimin e ujërave të përroit. Nga kontrafortet e anës së poshtme, ruhen vetëm gjurmët e njërës prej tyre.

Lidhur me datimin e digës bonifikuese interesante të Funarsit, unikale në llojin e vet ndoshta dhe përtej Shqipërisë, nuk ka asnjë të dhënë dokumentare apo dhe verbale. Mbështetur kësisoj vetëm në teknikën e ndërtimit, diga e Funarsit mund të mendohet si një ndërtim i rëndësishëm hidroteknik i shekullit të XVIII-të, kur në Shqipëri pati një shtrirje të gjerë ndërtimi i urave, veprave hidraulike, konstruksioneve hidroteknike etj.

Një krahinë e Shqipërisë, e pasur me ndërtime ujore gjatë mesjetës së vonë, ka qenë Lunxhëria e Gjirokastrës. [2]Këto lloj objektesh që ruhen ende dhe që pjesërisht funksjonojnë edhe sot, i takojnë përgjithësisht shekujve XVIII-XIX, por ky fakt nuk do të thotë se mjeshtëria e lunxhjotëve në këtë fushë e ka pasur origjinën në këtë kohë. Pukvili në fillim të shekullit të XIX-të shkruante se "Dhoksati Nokova dhe Këllezi, fshatra të Lunxhërisë, formojnë një bashkësi të vjetër shqiptarësh, që ushtrojnë prej kohësh të lashta në Perandorinë e Lindjes mjeshtërinë e terezitjes së ujit ose të çezmaxhinjve publikë".

Në mesin e shekullit të XVII-të Çelebiu shprehet: "Mjeshtrit shqiptarë të çezmave e ujësjellsave kryenin punimet e tyre sipas llogaritjeve të holla dhe matjeve gjeometrike."Në një dokument të prillit 1679, ku bëhet fjalë për kalanë e Gjirokastrës, janë përmendur fshatrat Sujollë - Xhijanë, që janë ngarkuar me detyrën e matjes së ujit.

Nga pikëpamja administrative në fund të shekullit të XVIII-të – në fillim të shekullit të XIX-të fshatrat e Lunxhërisë ishin çifliqe të Ali Pashë Tepelenës, në kohën e të cilit në këtë krahinë u ndërtuan mjaft vepra hidraulike. [3]

Një nga familjet më të njohura për mjeshtrinë e realizimit të objekteve ujore, ka qenë ajo e Xhakollarëve. Në qendër të fshatit Dhoksat ruhet në gjendje të mirë banesa dykatëshe e tyre, e ndërtuar rreth vitit 1830, në ambjentet e së cilës ruhen instalime hidraulike interesante(fig 5).

Në gjysmën e shekullit të XIX-të njihet mjeshtri Jorgaq Xhako, pas tij i biri Thanasi. Në ditët tona, në krahinën e Lunxhërisë që nga Selcka, në skajin jugor të saj, e deri në fshatin Nokovë, në skajin verior, ruhen mjaft objekte hidraulike, shumica ende në gjendje pune, të zgjidhura me aftësi profesionale. Kështu janë krojet e ujit të pijshëm, mullinjtë e drithit, urë-kanalet për vaditje, si dhe mjaft ura e kalldrëme të rrugëve mesjetare të karvaneve.

Një kategori e spikatur ndër këto lloj ndërtimesh, që evidentohet qartë në këtë krahinë, janë dhe digat apo pritat e ujit, të cilat në këto anë i quajnë,"Bende" me sa duket nga fjala "penda ujore."

Fshatrat e Lunxhërisë ndodhen në rrëzë të malit të Lunxhit, ndërsa tokat i kanë poshtë në fushë. Pikërisht për vaditjen e këtyre tokave, buzë malit poshtë përrenjve, janë përshtatur bendet. Këto janë prita të ndërtuara me mure guri masive me llaç gëlqere, pas të cilëve grumbullohet uji i përroit për vaditje. Në qendër të bendit, në nivelin fundor të tij është hapur një vrimë, e cila në anën e sipërme, nga ana

DOKTORATURË

e basenit, gjatë natës mbyllet me dërrasa. Në këtë mënyrë, gjatë natës, uji i përroit grumbullohet në gropën para bendit, për t'u shkarkuar ditën nëpër kanale vaditëse.

Në Lunxhëri sot ruhen tri bende, në fshatrat Këllez, Nakovë e Mingul, dy të parat funksionojnë ende në kohën e sotme. Bendi i Rigës mbi prroin e Gurrës në fshatin Këllez nuk akumulon shumë ujë (fig 6). Muri i bendit, në nivelin e kreut ka gjatësinë 15m, gjërësinë 2m, e lartësinë 4 metra. Ai është me seksion variabël, pasi në dy nivele 80 centimetërshe, trashet me 10cm, duke arritur kështu në fundin e tij trashësinë 2,2m. Në qëndër të bendit poshtë, ndodhet vrima me hapsirë 1.3m, e lartësi 1.7m, që gjatë natës zihet me dërrasa për grumbullimin e ujit. Muratura e bendit është e ndërtuar me gurë të zinj dhe shtuf pllakë me trashësi 8-16 cm. Seksioni variabël i bendit përbën një tip kontrafortë nga jashtë për përballimin e presionit të ujit. Bendi i Këllezit gjatë natës akumulon rreth 150 $m^3$ ujë. Për shkarkimin e ujrave të tepërta bendi nuk ka vepër shkarkimi të rregullt. Uji i tepërt derdhet në të majtë të bendit, ku kreu ka nivel më të ulët. Një tjetër bend në shfrytëzim është ai i Nokovës, i ndërtuar poshtë fshatit mbi prroin e Nakovës me gjatësi 16 m, akumulon gjatë natës një volum uji rreth 400 $m^3$.Prita prej muri guri me lartësi 5.5m është tip kontraforti, me një zgjerim prej 20 cm, nga ana e poshtme në gjysmën e lartësisë (fig 7). Në kreun e tij muri i bendit ka një trashësi prej 1.9m. Në qoshen e majtë kreu i bendit ka një ulje prej 40cm për shkarkimin e ujrave të tepërta. Në murin e bendit është vrima e daljes së ujit për vaditje në hapsirë drite 60cm, e lartësi 2.5m , me qemer cilindrik sipër (fig 8). Një bend më i goditur nga ana konstruktive ruhet në fshatin Mingul, mbi prroin me po këtë emër, gjatë rrugës që të çon në Manastirin e Shpërfytyrimit. Sot ky bend nuk përdoret pasi është i mbushur me prurje të ngurta nga sipër. Bendi i Mingulit me gjatësi 17m, gjërësi 2.1m e lartësi qëndrore 4m, në ndryshim nga dy bendet e tjera të sipërpërmendura për përforcimin e murit pritës ndaj presionit të ujit, nga ana e poshtme anash vrimës fundore ka dy kontraforte. Kontrafortet të larta deri në kreun pritës, janë ndërtuar me një kënd ndaj murit vertikal të pritës. Muri me trashësi 1.6m poshtë trashet me 20cm. Poshtë, në qëndër, është vrima e daljes së ujit me qemer cilindrik me hapsirë drite 1.25m dhe lartësi 1.6m.

Bendi i Mingulit sipër në qoshen e majtë ka një kamare, ndoshta me datën e ndërtimit, e cila sot nuk është më.

Sa i takon kohës së ndërtimit të bendeve të Lunxhërisë, nuk ka asnjë të dhënë historike. Sigurisht, si objekte vazhdimisht nën presionin e ujit, të grryerjeve dhe mbushjeve nga prrenjtë,nuk kanë mundur të rrezistojnë gjatë, për këtë arsye,origjina e ndërtimit të tyre, vështirë se ulet nën shekullin e XIX-të kur në Lunxhëri ushtronin veprimtarinë e tyre mjeshtrit e Familjes Xhako nga Dhoksati.Veç bendeve që ruhen në këmbë në krahinën e Lunxhërisë ka pasur dhe bende të tjera për vaditjen e tokave. Në fshatin Qestorat, në fundin e kodrinave në një breg buzë fushës ka qënë një bend për vaditje. Për ndërtimin e tij si dhe për gjithë elementët përbërës të tij, si vepra e marrjes së ujit sipër Qestoratit, kanali i furnizimit etj, sipas thënieve të vendasve u investua nga Ali Pashë Tepelena i njohur në këto anë për sipërmarjet e tij në fushën e ndërtimeve.

Evidentimi i digave, konstruksioneve të rëndësishme hidroteknike, pasuron gamën e ndërtimeve historike në vendin tonë, duke vlerësuar dhe faktin që ato përbënin objekte me tregues të lartë profesional dhe tepër cilësor.

DO NOT COPY

1) S.Muçaj, Veprat ujitëse në luginën e Gjanicës, revista "Iliria" 2/1983 fq.227

2)V.Shtylla,Ndërtimet e vjetra ujore të mjeshtrave nga Lunxheria,Monumentet 1/1987(33)fq.151

3)F.Pouqueville,Vouage en Moree,a Constantinople en Albanie et dans plusieurs outres parties de l'empire Ottomane pedant les annes 1798-1801,Paris 1805,II

4)E.Çelebi,Sejjahatnamesi,Istambul,1721,II,631

5)Turqisht:Su-ujë dhe joll rrugë, rruga e ujit.S Pulaha Qendresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shekulli XVI deri në fillim të shekullit XVIII,Tiranë 1978,145.

6)V.Shtylla,Krijimet e hershme hidraulike të mjeshtrave nga Lunxheria, revista "Perla" 3/2002 fq.69



Fig. 1



Fig. 2

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY




Fig. 5



Fig. 6

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7




Fig. 8

DO NOT COPY

# Old dikes in Albania

Albania, a country with mountainous terrain, is characterized by many water sources. During the history, our people have used water in a rational way, building different water works. A special category of those water constructions were the dikes to create water-collecting reservoirs. Dikes, as a necessary construction for the reclamation of the grain land, are a hydro- technical object known in our country from the distant past. This is testified by the dike of Kapsi in Gjanica - Mallakaster in I-II century, which collected about 1 million m3 of water. Traces of roman dikes of the same period exist even in Krane of Saranda, near Foinice, where is still noticed a wall 40m long.

In our country, from the medieval period, are preserved some dikes of land reclamation. The most interesting is the dike of Fenarsi in Librazhd, which from the technique of construction is a unique object. It consists of two parallel walls with a vacancy between them filled with argil. It is 34m long. This dike is the typical presentation of the dike with argil filling; a technique used even in the dikes built nowadays. The region of Lunxhëria in Gjirokastra has an old tradition in water construction works. Except the springs, water mains, dippers, etc. the Lunxhëria people are famous even for the building of dikes for the reclamation of grain- lands. In the villages Nokovë, Mingul and Këllëz exist small dikes for the collection of water, which are called by the villagers " Bende" (cistern/small water reservoir). These small reservoirs had a hole in the middle of them, which was blocked during the night to collect the water, used to water the land of Lunxhëria below them. The reservoirs of Lunxhëria are water works that belong to the XVIII century when in this region was famous the hydraulic mastery of Xhaho family. In Dhoksat the ancient reservoirs, as historical constructions enriches the cultural values in Albania that have the legal status of cultural monuments.

DO NOT COPY

Dr. Fejaz DRANÇOLLI

# Xhamia e Hadumit

## Historiku, arkitektura, piktura dhe plastika

Veprat e artit të realizuara gjatë sundimit të Perandorisë së osmanllinjëve të ngelura në Kosovë, natyrisht se nuk mund të krahasohen me krijimet monumentale të pjesëve të tjera ku ishte përhapur arti i Islamit, por janë me rëndësi të veçantë për territorin në fjalë. Këto ndërtime arkitektonike sakrale, në veçanti pos tjerash, dokumentojnë përhapjen dhe ekzistimin e vlerave të artit në këtë pjesë të Ballkanit, pra të Evropës. Në Kosovë kemi një numër të konsiderueshëm të xhamive klasike monumentale të realizuara në shek. XV, XVI, XVII dhe më pas. Një ndër këto objekte fetare është edhe Xhamia e Hadumit në Gjakovë e ndërtuar në dekadën e fundit të shekullit XVI. [1]

Gjakova si qytet i Kosovës kishte pozitë të përshtatshme gjeografike si dhe kushte të favorshme për zhvillimin e saj gjatë periudhave të kaluara historike. Qyteti i Gjakovës (Fig. 1 ) i takon pjesës jugperëndimore të fushëgropës së Rrafshit të Dukagjinit. Është i vendosur në kryqëzimin e rrugës së rëndësishme transverzale Via de Zenta, ose të Zetës (Shkodër-Kosovë) me atë longitudale të Rrafshit të Dukagjinit. Gjakova shtrihet në bregun e majtë të lumit Erenik duke përfshirë edhe dy anët e përroit Krena dhe në lindje të pëllajës së Çabratit. Pra qyteti në fjalë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe gjendet në rrugën e rrafshit të Dukagjinit, në drejtim Pejë- Prizren. Kemi indikacione si dhe dëshmi të kulturës materiale se në vendbanimin e qytetin të Gjakovës është jetuar edhe gjatë periudhës antike. Kjo dëshmohet nga të gjeturat të objekteve të lëvizëshme, fatkeqësisht tejet të varfëra, por dokumentuese për ekzistimin e objekteve të kulturës materiale në këtë lokacion. Qyteti ekzistues i takon periudhës osmane. Në fakt, në bazë të të dhënave historike, Gjakova njihet qysh nga dekada e pestë të shekullit XIV, më saktësisht nga viti 1348, kur i takonte nahijes së Alltun-ilisë, me qendër në Junik. Ndërkaq sipas burimeve të kulturës materiale, ndërtimeve arkitekturale monumentale, ajo njihet nga dekada e fundit të shek. XVI.

**1. Gjerësisht, F. Drançolli, Xhamia e Hadumit në Gjakovë, Arkivi i Kosovës, Vjetari XVIII-XIX, Prishtinë, 1984.**

## Tregu lokal si specifitet shqiptar

Në bazë të defterit të vitit 1571, Gjakova është ende fshat, ishte qendër pazari. Me një status të këtillë jetoi deri më 1582. Dhjetë vjetë pas, prej 68 familjesh shqiptare, sa kishte atëherë Gjakova, 13 ishin të islamizuara e të tjerë krishterë. Gjakova si fshat i reduktuar me qendër të vogël kryente funksionin e tregut lokal. Ky treg lokal është një

specifitet për Gjakovën si dhe qytetet shqiptare gjatë shekullit XV, deri në fillim të atij XVI. Është me interes të cekët se specifiteti i zënë në gojën nuk ishte karakteristike për qytetet e Perandorisë osmane.
Në këtë periudhë, në mbarim të shekullit XVI, konkretisht në vitin 1594/95 Hadum Sylejman Efendia-Hadum Aga e ndërtoi xhaminë, e cila po ashtu edhe mban emrin e donatorit-financuesit të objektit në Gjakovë. Xhamia sipas traditës, u ndërtua në fushën e Jakë Vulës nga edhe bëhet emërtimi i qytetit Jakovë.

### Tregu, xhamia dhe çarshia

Tregu lokal, Xhamia e Hadumit në shekujt e mëvonshëm, XVII, XVIII, XIX e XX luajtën rol të rëndësishëm në karakterin urbanistik të qytetit, Çarshisë së Madhe të Gjakovës e më se lidhet ndërtimi i këtij kompleksi urbano-arkitektonik. Pra, koha e ndërtimit e kompleksit në fjalë lidhet me paraqitjen e zejtarëve dhe të përpunimit të të prodhimtarisë së zejtarëve, që zunë të vendosën rreth mureve të xhamisë së Hadumit. Më këtë lidhet e dhe rritja e banorëve të Gjakovës, e cila numerikisht fillon të shtohet qysh nga shekulli XVII. Gjakova prej një fshati në gjysmën e dytë të shek. XVII u zhvillua në qytet, ku lulëzonte zejtaria, tregtia, ekonomia. Kjo qe pasojë e migrimit të popullsisë së ardhur nga fshati. Këta të ardhur kishin për qëllim të largohen nga fshati dhe t'i ikin shfrytëzimit feudal, me ç'rast zunë të merren me zejtari. Kjo gjë ishte karakteristike për tërë qytetet shqiptare të asaj kohe. Mirëpo, ekonomia, si dhe numerikisht Gjakova filloi të bjerë në fund të këtij shekulli, pra në shek. XVII, meqë përjeton një rënie të madhe sikurse edhe qytete të tjera të Kosovës.
Xhamia e Hadumit, (Fig. 2) vepër e rëndësishme e arkitekturës shqiptare të periudhës osmane, u sendërtua me qëllim të përhapjes së fesë islame të pushtuesit osman, të përhapjes të islamizmit në këtë pjesë të Kosovës. Në fillim kjo gjë ishte përshpejtuar veçanërisht në qytete, e që kishte për qëllim islamizimin e qytetarëve.

### Gjakova në shënimet e Evlija Çelebiut

Përveç xhamisë së Hadumit, në shekullin XVII, kur tanimë kishte marrë fizionominë e një qyteti, u ndërtuan edhe objekte të tjera të kultit-sakral si dhe profan e publik. Për këto ndërtime si dhe qytetin e Gjakovës mjaft mirë flet, përshkruan edhe udhëpërshkruesi turk Evlija Çelebi, i cili kaloi këndej pari në shekullin e cekur, konkretisht më vitin 1663. Çelebiu, pos tjerash, në një mënyrë na paraqet edhe një gjendje statistikore të objekteve sakrale dhe profane të Gjakovës. Sipas tij në këtë periudhë Gjakova kishte 2000 shtëpia disa mesxhide dhe dy xhamia monumentale, hane të mbuluara me plumb, hamamin e bukur dhe 300 dyqane.
Përshkrimi i udhëpërshkruesit turk dëshmon për një rritje dhe zhvillim të zejtarisë, tregtisë, ekonomisë si dhe të numrit të banorëve, të cilët u morën me këtë punë. Pra, lirisht mund të nxjerrim përfundimin se Gjakova në shekullin XVII formohet si qytet me plot kuptimin e fjalës.

### Arkitektura e xhamisë së Hadumit

Xhamia e Hadumit, si ndërtim arkitektural e mbuluar me kube, i takon formave klasike të xhamive të grupit të stilit kosovar.
Xhamia e Hadumit ka bazë katërkëndshe, këndrejtë me minare, e cila del nga muri jug-perëndimore me bazë në formë këndrejtë. Planimetria a skema kompozicionale e saj përbëhet nga këto pjesë: salla e lutjeve, hajati që zë vend në fasadën veri-perëendimore të veprës si dhe minares. Po ashtu duhet cekur se përreth xhamisë janë varret me nishane të realizuara në plastikë guri, të graviruara, të mbishkruara në gjuhë të vjetër osmane. Në të kaluarën në këtë pjesë të xhamisë u varrosen anëtarët e familjeve të

DO NOT COPY

DO NOT COPY

njohura të Gjakovës. Kjo e cekur ishte karakteristike edhe për veprat, xhamitë e qyteteve të tjera kosovare. Në kuadër të kompleksit të xhamisë ishte edhe hamami ( nuk ekziston), hani i Haraqive (ende ekziston, por i adaptuar, i transformuar gjatë kohës ), ndërtesa e bibliotekës së vjetër të objektit nga viti 1671( bibloteka nuk ekziston, u dogj nga forcat serbe gjatë luftës së vitit 1999 dhe në tërësi u rrënua në vitin 2000 ) si dhe mejtepi nga viti 1777, po ashtu i adaptuar.

### Salla e lutjeve

Salla e lutjeve ka vëllim unik dhe është e mbuluar me kupolë. Kjo sallë ka planimetri katrore dhe në të hyhet nga dera e cila gjendej në fasadën veri-perëndimore. Dera është e mbuluar me arkitrah paksa harkor. Salla, me vëllimin e saj unik, është e mbuluar me kube të konstruktuar drejpërdrejti mbi të nëpërmjet të trompeve në qoshet e mureve konstruktive. Madhësia, diametri i kubeut është 13.50 m. Ndërsa lartësia prej dyshemesë është 12. 60 m. Për këtë të cekur është specifike se kubeu qëndron në tetë pilastra të forta dhe në konstrukcion të trompeve. Kjo mënyrë e konstruktimit paraqet të vetmen zgjedhje të këtillë ndërtimore në territorin e Kosovës. Duhet cekur se në këtë pjesë konstruktiv, në tamburin e xhamisë nuk kemi hapje a dritare, pra kemi të bëjmë me një kube të verbër. Sa i përket ndriçimit salla e lutjeve merrë dritë nga gjithsejt 11 dritare. Çdo faqe e kubit, për dallim nga ajo veri-perëndimore, ku ndodhet hyrja ka nga tri dritare. Edhe në këtë pjesë, mbi portal kemi një hapje të vogël gjysëm harkor. Dritaret si elementë konstruktivë-arkitektonike janë të vendosura në dy radhë, në formë piramidale. Në radhën e parë janë të konstruktura në mënyrë simetrike nga dy dritare në çdo faqe, përkatësisht në katër pamje të mureve konstruktive. Këto dritare janë të mbuluara me arkitra, por kanë edhe timpanone të verbërta që mbarojnë me harqe paksa të mprehta. Ndërkaq, në radhën e dytë ka të konstruktuar vetëm një dritare. Kjo dritare e mbuluar me hark të mprehtë ndodhet pikërisht nën tambur, në të tre muret anësore, pos asaj veriore. Dritaret e xhamisë së Hadumit, ato të rendit të parë, nga jashtë janë të siguruara me parmakë të metaltë.

### Mihrabi dhe mimberi

Si në çdo xhami edhe në këtë të Hadumit përballë hyrjes është mihrabi. Mihrabi (Fig. 3) gjendet në mesin e murit jug-lindor dhe përherë është i orientuar në drejtim të Mekës. Ky element është i thelluar në mur në formë nike me pjesën e sipërme gjysmë konike. Pos mihrabit këtu në të djathtë të tij është mimberi që shërben për predikim. Mimberi përbëhet prej: derës, shkallëve dhe balldahinit. Pra si shifet mimberi ka formë tradicionale të trajtave të mimberëve dhe është e punuar në tërësi nga druri. Të tëra elementët e drurit janë të gdhendura dhe të pikturuara në atë mënyrë që i përgjigjen trajtimit tektonik të këtij elementi.

### Mahfili

Të tëra nga druri është realizuar edhe mahfili, i cili qëndron mbi shtyllat, kolonat e profilizuar të drurit. Mahfili a galeria si pjesë konstruktive-arkitektonike e funksionale pos që e pasuron dhe thënë monotoninë e volumit të sallës së faljeve veçohet edhe me dekoracione plastike e pikturale. Galeria zë vend në anën veri-perendimore mbi hyrjen në sallën e lutjeve, në tërë gjerësinë e saj. Pos që mbështetet për murin veri-perëndimor ajo qëndron edhe mbi kolona, shtylla të drurit. Në mahfil arrihet nëpërmjet shkallëve të minarës. Si pjesët tjera të xhamisë edhe mafili është i tërë i pikturuar, natyrisht me motive të botës bimore.
Dyshemeja e xhamisë në kohë ishte e shtruar me pllaka tullash të pjekura të formës gjashtëkëndore.

Mbi dyshemenë në fjalë janë të shtruara qilimat.

### Elementët konstruktive, trompet

Vëllimi i jashtëm kryesor me kube përbëhet nga pjesa kubike dhe kubeu. Vëllimi kryesor nga ana e jashtme është mbështjellur, konstruktuar nga gurët e latuar. Gurët janë marrë në afërsi të Gjakovës, matanë Erenikut, në mes të Devës dhe fshatit Guskë. Ndërkaq faqet e brenshme të mureve janë me tulla dhe të suvatuara. Për të realizuar, konstruktuar kuben e xhamisë nga vëllimi i kubit është kaluar në tetëkëndësh. Në rastin konkret, gjatë këtij procesi të ngushtimit, në katër qoshet, skajet, formohen trajtat e çerek topit-trompet të cilat në të dy anët e jashme mbarojnë në kurorë dhe janë të veshura me plumb. Pjesa konstruktive, e cila fillon nga vëllimi, përkatësisht nga trompet e vazhdon, përfundon në kurorë, ku fillon kalota e xhamisë na paraqet tamburin si element konstruktive-arkitektonke. Tamburi në xhaminë e Hadumit është e ulët dhe tetë faqëshe. Për dallim nga pjesë të tjera të objektit sakral, trompet dhe në tërësi kubeu i xhamisë është konstruktuar, muratuar me tulla të pjekura. Nga kurora e tamburit fillon mbulesa me plumb e kubesë së objektit në fjalë.

### Hajati i xhamisë

Tremi a hajati i xhamisë së Hadumit përfshin pamjen veri-perëndimor dhe ka një zgjidhje tradicionale të këtyre mjediseve të veprave klasike monumentale jo vetëm në Kosovë dhe pjesë të tjera shqiptare, por edhe për Ballkanin. Mjedisi në fjalë shërben ( në rast nevoje, kur në sallën e lutjes nuk ka vend apo arrihet me vonesë) për lutje, falje të namazit. Hajati mbulohet me tri kube të madhësisë së vogël. Këto kube si dhe ajo kryesorja janë të veshura me mbulesa të plumbit.
Nga jashtë në hajat hyhet drejtpërdrejt. Pjesa ndërmjetëse e hajatit është në nivel të sallës së lutjeve. Nga kjo pjesë të hajatit, e cilia e ndanë në dy pjesë të barabarta mjedisin në fjalë, hyhet në sallën e lutjeve. Dyshemeja e hajatit ( në të dy anët e ndërmjetëses) si për herë është në nivel më të lartë nga dyshemeja e sallës së lutjeve dhe të terrenit pranë xhamisë së Hadumit. Edhe dushemeja e hajatit në kohë ishte e shtruar me pllaka prej tullash (dheu i pjekur) gjashtëkëndëshe, dhe ishin identike me dyshemenë e enterierit, sallës së faljeve. Pra siç shihet dyshemeja e hajatit të xhamisë paraqitet si një podium dhe kështu shërben si bazament ndaj arkadave mbi shtylla, kolona të mjedisit në fjalë.

### Arkada e hajatit

Arkada veri-perëndimore, pra e ballit kryesor të xhamisë së Hadumit, përbehet prej tri harqesh gjysmërrethore, që mbështeten në katër shtylla, kolona. Kolonat e hajatit të xhamisë nuk janë monolite, por të konstruktuara nga disa pjesë, përkatësisht nga tri pjesësh të gurëve masiv. Kolonat nuk kanë bazament dhe paraqesin një gjë të rastit në arkitekturën e periudhës osmane në Kosovë. Po ashtu, edhe kapitelet e shtyllave, janë tejet modeste. Në bazamentin e shtyllave si dhe para kapiteleve të tyre si pjesë dekoruese na paraqiten unazat e materialit të misingut. Nga ana lindore dhe perëndimore kemi vetëm nga një hark të mbështetur në kolonën e arkadës veriore dhe murit konstruktiv të pamjes kryesore të objektit sakral.
Ngjitur për hajat deri në pranverën e vitit 1999 ekzistonte edhe parahajati i shek. XIX i cili u dogj dhe tani nuk është më pjesë përbërse e xhamisë.

### Minareja

Si pjesë e skemës kompozicionale, si element i pandarë i xhamisë është edhe minareja, e cila si zakonisht zë vend në të djathtë të sallës së faljeve

DO NOT COPY

duke dal nga muri jug-perendimor. Me minare komunikohet me ndihmën e dy deriçkave, dyerve të vogëla. Njëra është në eksterier, kurse tjetra në enterier të objektit. Deriçka e eksterierit të minares ka një madhësi të vogël dhe është në nivel të dyshemesë së sallës së lutjeve. Ndërsa deriçka tjetër e minares është e konstruktuar në nivel të dyshemes së mafilit. Nga minareja nëpërmjet deriçkës së cekur komunikohet me mafilin dhe anasjelltas me minaren.

Baza e minarës ka planimetri, bazament këndëdrejtë që vazhdon me paputhen në formë të piramidës së cunguar duke përfunduar me një kornizë guri që del nga muri perimetral i elementit konstruktiv. Nga kjo pjesë fillon trupi i minares që ka formë shumë këndore a poligonale. Trupi i minares nga korniza e parë shkon duke u ngushtuar deri në kornizën e dytë. Prej lartësisë së kornizës së dytë, trupi i minares gjithherë, lehtasi, duke u ngushtuar mbaron me kornizën e tretë. Këtu trupi poligonal e përfundon me kazanin a sherefen e minares. Sherefeja në lëshime anëcake, nga disa rende gurësh të latuar, del nga muri poligonal perimetral i trupit të minares dhe kështu merr, fiton një gjerësi sa për të lëvizur në rast nevoje, për kryerjen e ndonjë ceromonie të caktuar fetar: thirrja e ezanit për tenbih etj. Kazani ka edhe parapetën e tij. Kjo pjesë, pra sherefeja në xhaminë e Hadumit paraqet një pjesë ku prezantohen gdhendje në teknikën e relievit, në plastikë të imët. Daljen në kazan na bënë të mundur një deriçkë e ngushtë dhe e ulët. Konstruksioni i minares nuk mbaron me kaq, por tani mbi kazan vazhdon pjesa e sipërme, petku i minares. Petku mbaron me pjesën konike të qyajtur qylah. Qylahu ka konstrukcion druri dhe është e mbuluar e veshur me mbulesë të plumbit. Në fund të minares si element përfundimtar, njëherit, edhe element dekoracioni me cilësi artistike e estetike është edhe alemi i minarës. Elementë të njëjtë dekoracioni na prezantohen edhe kuben e sallës së faljeve të xhamisë së Hadumit në Gjakovë.

Pos tjerash funksioni i mimares është që nëpërmjet shkallëve të saja të arrihet në kazan-sherefe. Shkallët janë nga gurët njëpjesësh të vendosura, konstruktuara edhe si pjesë të pa ndarë të mureve konstruktive të minarës që vazhdojnë njëra pas tjetrës në kontinuitet deri në deriçkën e sherefes. Enterieri i minarës në xhaminë e Hadumit ndriçohet nga një numër i vogël hapjesh, dritaresh. Këto hapje kanë formë të frengjisë. Hapjet të zënë n'gojë pos funksionit të cekur luajnë edhe rolin e ajrosjes së minarës.

## Dekoracionet murale-arabeskat

Në xhaminë e Hadumit, në veprën monumentale të mbuluar me kube, si dhe në disa vepra të tjera të karakterit dhe tipit të cekur në Kosovën të ndërtuara në shek. XV, XVI e XVII na prezantohen edhe pikturat, dekoracionet murale të cilat me ekzistencën dhe pamjet e tyre zbukuronin muret e objekteve sakrale islamo-shqiptare.(Fig. 8) Këso dekoracione kemi edhe në hapësirat, sipëfaqet e mureve të xhamisë së Hadumit në Gjakovë.

Enterieri, pamja kryesore e xhamisë, kubet e hakatit janë të dekoruara me pikturë murale të punura në seko teknikë. Motivet kryesore janë peizazhet e stilizuara (në disa raste e edhe me motive të arkitekturës popullore, kullave të rrafshit të Dukagjinit) me selvi, natyra të qeta, yje bosh, motive arkitektonike të objekteve të kultit-xhamit, ornamente të botës bimore, figura gjeometrike dhe citate të Kuranit. Edhe pse dekoracionet përsëriten ato nuk janë monotone, por me prezencën dhe pamjet e tyre ia rrisin vlerën objektit. Këto motive të prezantuara me përmbajtje të dekoracionit të tyre në artin Islam njihen si piktura murale a arabeska.

Dekorimte e cekura, paraqiten në kubeun kryesor si dhe ato në hajatin e objektit, në kurorë, nike, harqe dhe trompe. Njëherit duhet cekur se edhe

DO NOT COPY

mihrabi, mimberi, mahfili, pjesët e mureve të sallës së lutjeve për rreth dritareve, në veçanti janë të dekoruara me piktura murale. Ngjyra dominuese në këto dekoracione janë: e kuqja, e kaltëra, e gjelbëra, okër, e përhimtja e zeza e cila përdorët vetëm në citatet e Kuranit, si dhe në emrin e Allahut, Muhamedit si dhe pasardhësve të tij. Dekorimet e cekura i takojnë stilit të barokos islamo-shqiptar të realizuara në shek.XIX.
Në xhaminë e Hadumit kemi tri shtresa pikturale. Ekzistimi i shtresava në dekorimet pikturale është konstatuar gjatë punëve konservuese-restauruese të vitit 1981. Me këtë rast, në bazë të sondimeve të bëra në kuben e mesme të hajatit u vërejtën tri shtresa të pikturimit. Ndërsa në kubet anësore kemi nga dy shresa të dekorimit. Motivet në shtersat e gjetura janë nga bota bimore dhe figura gjeometrike ku dominon ngjyra e kuqe qeramidhe dhe e zeza. Motivet si dhe ngjyrat e cekura janë karakteristike edhe për dekoracionet e shtresës së dytë. Dy shtresat e para duhet të takojnë shek. XVII-XVIII. Shtrersa e tretë dekoruese kjo ekzistuesja është ndërtuar në vitin 1260 (sipas hixhrit), përkatësisht në vitin 1842. Këtë të dhënë e dokumenton mbishkrimi dhe data e shënuar në timpanonin e portalit kryesor.

### Plastika gurore

Si veprat të tjera monumentale të mbuluara me kube të trashëgimisë kosovare edhe xhamia Hadumit nuk është e pasur me plastikë gurore. Plastika gurore në këtë vepër sakral të ndërtimtarisë islamo-shqiptar na prezantohet kryesisht në ancakun e parapetës së sherefes së minares. Këto dekoracione janë të realizuara në teknikën e plastikës së imët. Edhe shtyllat e hajatit nuk kanë dekoracione plastike, por paksa veçohen me kapitelin në formë katrore ku na prezantohen lulet e stilizuara të realizuara në teknikën e plastikës së imët. Këto dekoracione përsëritën në katër shtylla të hajatit. Me profilizime cilësohen edhe dritarët, portali kryesor, kurorat e sallës së lutjeve, të hajatit si dhe vet parapeta e minaresë së xhamisë. Pra, në përgjithësi sipërfaqet e mureve, si dhe elementët arkitektoniko-konstruktive janë të pastëra dhe modeste e që kjo është karakteristike për arkitekturën e xhamisë në Gjakovë dhe më gjerë në territoret shqiptare. Po ashtu duhet të theksojmë se kubet e xhamisë me madhësi të ndryshme dhe ato me dinamikë dhe kontrast ndikojnë në thyerjen e monotonisë së objektit dhe japin pamjen estetike xhamisë.

Pos tjerash mund të konkludojmë se xhamia e Hadumit me proporcionet, format dhe trajtat e saj, përmban në vete diçka të fuqishme, e cila gjë ndikon dhe jep një ngohtësi objektit i cili në tërësi është kordinuar dhe jeton edhe sot e gjithë diten në ambientin e Çarshisë së Madhe në Gjakovë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



*Fig. 1*

DO NOT COPY



Fig. 2



DO NOT COPY

*Fig. 3*

DO NOT COPY

# Hadum's Mosque in Gjakova
## (History, architecture, painting and stone plastics)

Five-century long administrative, political and military domination of the Ottoman Empire in the territory of Kosovo was also reflected on the spiritual and material culture of the region. From figurative arts, architecture left the main mark by leaving monumental works of overall construction in the territory of Kosovo.

During the Ottoman rule, a considerable number of sacral works were constructed in Kosovo. These architectural works as monuments belong to the Islamic-Albanian, respectively Kosovar group. This is how we're going to refer to them because they can be found in the territory of Kosovo and contain special compositional qualities that make them somewhat distinguishable from the buildings of the same type and character. Some mosques constructed during the Ottoman period are distinguished by their monumentality and qualities. One of these works, monumental constructions realised during the relevant period is Hadum's mosque in Gjakova. This classical construction covered with a dome carries a standard solution to these works in Kosovo.

The donor or financier of Hadum's mosque was Hadum Sulejman-efendi-Hadum Aga. The mosque was built in the last decade of XVI century. This classic, sacral work of the Ottoman period is a one-space mosque covered with a dome of 13.5 m diagonal. Trompes rely on eight pilasters which together hold the dome. This presents the only solution in the regional level. Mosque's portico is plain and consists of three semi-arches covered with small domes. Pillars of portico's columns are not that high and have modest capitals and foundations. Plastic decorations are also poor and modest. These decorations presented in an ornamental form, realised in tiny plastic are found in the parapet of minaret's boiler and in mihrab. Windows, main portal as well as the roof's and portico's crown are shaped and affect the appearance of the mosque.

The interior, the main exterior appearance, domes of mosque's portico are decorated with mural paintings, arabesques realised in secco technique. Mentioned paintings belong to the Islamic-Albanian, respectively Kosovar baroque style. Main motives of decorations include landscapes with cypress, vegetative ornaments, geometric figures, architectonic religious motives, Qur'an quotations, still life etc. Pictorial decorations are presented in domes, in the crown of the dome, niche, arches and trompes. Mihrab, minbar, mahfil, parts of the wall in the praying hall and parts around the windows are also decorated. The dominating colours include ochre, blue, green, red, grey and black.

Hadum's mosque with its proportions, forms and shapes contains in itself something powerful which affects and gives warmth to the building which is in entire coordination and continues to live even today in the environment of Çarshia e Madhe in Gjakova.

DO NOT COPY

Skënder MIHALÇKA

# Piktura e Ardenicës*

*"Qe e vërtetë; që andej dukej e tërë bota. Në veri humbisnin në mjegull malet e Shkodrës, Krujës e Tiranës. Në Lindje, fare pranë, ngrihej hijerëndë Tomorri. Në Jug shtrihej fusha e Apolonisë e valëzuar nga kodra të buta ndërsa në Perëndim shkëlqente deti."*

Eduart Lir, 1848

## HISTORIA E MANASTIRIT

Silueta e Manastirit të Ardenicës me qiparisat, pishat dhe ullishtën që e rrethojnë shfaqet lart, nga rruga automobilistike që vjen prej qytetit të Lushnjës për të vazhduar pastaj në Fier, Vlorë dhe duke gjarpëruar nëpërmjet maleve të thepisura të Llogarasë ku përshkruan si një zinxhir fshatrat piktoreske të bregdetit të cilët lidhen me qytetin turistik të Sarandës ose më në Jug me qytetin antik të Butrintit. Por dhe një degëzim i rrugës nacionale që fillon nga qyteti i Fierit të përcjell në qytetin muze të Gjirokastrës, përshkon në Jug fushën e Dropullit deri në kufi me Greqinë (fig. 1).

Mbi kodrën e Ardenicës[1]) të vjetrit themeluan Manastirin që mban emrin "Lindja e Shën Mërisë". Ata i tërhoqi bukuria e vendit prej nga sodisnin peizazhin e gjerë të fushës së Myzeqesë me perëndimet e kuqërremta mbi Detin Adriatik dhe malin e bardhë të Tomorrit në Lindje (fig. 2).

Pylli gati i papërshkrueshëm i mbante të fshehur murgjërit larg jetës së gjallë të njerëzve, kështu ishte zakoni që prej shekujsh.[2])

Jeta e Manastirit e zhytur në atmosferën bizantine do të vazhdojë gjatë deri në fund të shek. XIX me lindjen e Ideve Kombëtare. Si institucion ai do të ruajë karakterin teocentrik të organizimit të jetës, objekti i fundit që është bashkimi me Zotin, përkufizimi i bukurisë dhe gjallërisë së natyrshme. Besimi dhe rregullat janë të njëllojta për murgjërit, besimtarët dhe laikët. I ndodhur në fushën e Myzeqesë, Manastiri përfshihet në një klimë mesdhetare dhe gërshetohet me atë malore të Gadishullit Ballkanik, duke krijuar kushte të mira për jetesën e populisisë, zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

Vendi ku është ndërtuar manastiri dhe tërë vargu kodrinor quhej nga të vjetrit *ardheas* ose *ardheus* për adhurim të hyjneshës ilire të bujqësisë dhe gjuetisë *Artemisa*. Shpjegim tjetër mund të ketë leximi i fjalëve *"dheu i artë"* si toponim i vendit duke lexuar *"Ardheas"*[3]). Studiesit thonë gjithashtu se në vendin ku ndodhet manastiri ka qenë ngritur qyteti i moçëm i *"Epidhavrit"* dhe se për të mos humbur hyjnizimin e këtij vendi i vunë emrin e qytetit të vjetër *Armisa* që kanë përcaktuar hartat e vjetra në tokën e Myzeqesë, që ndodhej në të majtë të lumit Shkumbin, fshati Babunjë e Re.

Që në kohët e lashta dhe mesjetare pellgu

i Myzeqesë ka lojtur një rol të rëndësishëm ekonomik, politik, shoqëror dhe kulturor. Këtë gjë do ta favorizonte pozicioni gjeografik i ndodhur në mesin e zhvillimit të botës antiko-mesjetare, me një kulturë etnike ilire të përcaktuar në një unitet gjuhe dhe kulture të diferencuar që nga shek. VI – VII[4]). Prej këtej do të kryheshin marrëdhëniet tregtare kulturore me vendet fqinje Greqinë, Italinë dhe më vonë me Perandorinë Romake, Bizantine dhe Osmane. Komunikimi nëpërmjet rrugëve detare[5]) dhe tokësore solli kolonët helenë të Korfuzit të cilët themeluan në shek IV p.e.s. qytetin e Iashtë të Apolonisë[6]) i cili duke komunikuar me Durrësin në Veri të saj do të bashkëjetonin duke krijuar marrëdhënie politike dhe shoqërore. Në Lindje zona e Myzeqesë takon me kryeqendrën e saj qytetin e vjetër të Beratit i cili pas pushtimit të Kostandinopojës më 1204 nga Kryqëzatat bëhet i rëndësishëm në Despotatin e Epirit.[7]) Nën Mihalin I Komnen tokat e të cilit do të zinin në Jug Artën, Shqipërinë e Mesme deri në Durrës duke përfshirë edhe Ohrin qendër e vjetër kulturore dhe fetare e Sllavëve të Jugut me kishën e *"Shën Klementit"* (Shën Mëria Pejribletos), ndërtuar nga dinjitori bizantin Progon Zguro[8]). Nën Despotatin e Epirit do të zhvillohet një veprimtari ndërtimore dhe artistike e rëndësishme gjatë shek. XIII – XIV, monumentet e të cilit dallohen për veçoritë lokale në qytetin e Beratit dhe fushën e Myzeqesë vrojtuar dhe për veprat artistike. Kështu do të themelohet Manastiri i Vjetër i Shën Mërisë në qytetin antik të Apolonisë[9]), por me vlera të mëdha për nga funksioni është trapezeria e manastirit me afresket e çmuara të ndikuara nga arti antik i Nikesë[10]). I kësaj periudhe mendohet të jetë ngritur edhe Manastiri i Ardenicës. Dokumentet e kohës përmendin si zotërim më të vjetër të krahinës Muzakajt të cilët mbaheshin si kultivues të rëndësishëm të drithit gjatë shek. XV[11]). Që me pushtimet e tyre arritën përtej Kosturit[12]) duke ndërtuar atje dhe një kishë, atë të Shën Thanasit[13]). Përsa i përket monumenteve të Myzeqesë, Manastiri i Ardenicës do të ruajë edhe sot rëndësinë e vlerave arkitektonike dhe artistike. I vendosur në një terren të përshtatshëm rrethuar me mure ai ruan karakteristikat mesjetare të një manastiri ortodoks. Nëpërmjet një porte me qemer të thellë hyhet në mjedisin trefaqësh të tij, në qendër të të cilit është vendosur *kathonikoni* dhe *kambaneria*. Përreth perimetrit të mureve rrethues zhvillohen ndërtesa dykatëshe të mbështetura në portikë guri dhe lart hajatet e hapura tipike popullore të cilat shërbejnë për banim[14]). Rruga përreth kishës nga ana perëndimore dhe veriore të çon në bodrume të rrënuara mbi të cilët ndodheshin qelitë e murgjërve dhe kisha e vjetër e Shën Triadhës, që përbën një kapelë të vogël njënefëshe përbri këndit verilindor të katonikonit. Ansambli vazhdon me ndërtesa të tjera që kanë shërbyer si shkolla dhe biblioteka, dhoma klerikësh të cilat mbyllen në anën lindore mbi strukturën e ngurtë të hyrjes duke krijuar një kompleks interesant arkitektonik. Manastiri frekuentohej shpesh nga nevojat e njerëzve për të kaluar natën, si pikë ndalimi të karvanëve dhe kryqëzim rrugësh për të vazhduar më tej për në Vlorë e Berat, në pjesën JL të vendit, në Korçë e Voskopojë dhe Veriu me Elbasanin, Shkodrën, Prizrenin dhe Ohrin. Në anën jugore të kodrave të Ardenicës përbri manastirit kalonte degëzimi i rrugës Egnatia, në gjurmët e së cilës funksiononte rruga deri në fillimet e shek. XX[15]). Nga kjo rrugë erdhi nga Durrësi për në Vlorë atdhetari Ismail Qemali që ngriti flamurin kombëtar më 28.11.1912. Në tërësinë e ansamblit ndërtimet e shumta dhe rrënojat përbëjnë elementë të dallueshëm dhe teknikës së ndërtimit që përcaktojnë karakterin dhe kohën e tyre. Zbukurimet e fasadave me mbeturina të antikitetit[16]) si fragmente skulpturash, stela varresh, gurë të punuar antikë, pjesë frontonesh nga tempujt etj. paraqesin gati një muze natyror. I përfshirë në një zonë mbulimesh antike nuk përjashtohet mundësia që manastiri të jetë ndërtuar në një nga

DO NOT COPY

këto ngulime mbi Tempullin e Artemisës[17]).

Ideja se materialet ndërtimore antike janë importuar vetëm nga qyteti antik i Apolonisë me të cilat janë ndërtuar dhe zbukuruar kishat e Myzeqesë të shek. XVIII dhe për rastin tonë Manastiri i Ardenicës në një kohë që ngulimet antike ishin në disa pika të vendit, mozaikë, varre antikë, fragmente të mbledhura andej – këndej të lënë të dyshosh edhe njëherë për një truall më të kultivuar. Gojëdhëna popullore tregon se manastiri u ndërtua me gurë të marrë dora – dorës nga gurorja e fshatit Karabunarë në afërsi të qytetit të Lushnjës.

Studiuesit themelimin e manastirit e përcaktojnë në shek. XIII – XIV nisur nga mbistrukturat që përkojnë me Despotatin e Epirit[18]) të restaurimit të tij duket pjesë e rëndësishme e Perandorisë Bizantine përballë frontit perëndimor të cilët dhe pas marrjes së Bizantit në 1204-ën synonin pushtimin e kësaj zone. Nga ana tjetër kjo pikë e rëndësishme i duhej Despotatit për konsolidimin e pushtetit politik dhe fetar, krahas shfrytëzimit ekonomik të kësaj pjese të Myzeqesë. Dëshmia e parë për historinë e tij është mbishkrimi i murosur në gurë mbi harkun e portës kryesore: AVOZ – 1 MAJ 1477, i cili sipas gjurmëve është më tepër një datë restaurimi e kësaj pjese të ansamblit sesa datë themelimi[19]). Interesante është ngjarja e fejesës së heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit – Skënderbeut me Andronikën, vajza e Gjergj Arianitasit më 26.4.1451 të cilët qëndruan këtu dhe kurorëzimin e morën nga dora e Peshkop Feliksit të Apolonisë dhe Bylisit[20]). Ne mësojmë se brenda mureve të manastirit funksionone shkollë që nga shek. XIII deri në v. 1684, e cila përgatiste klerikë për krahinën[21]) dhe do të vazhdojë të funksionojë deri me krijimin e shkollës kombëtare. Nga kjo shkollë kanë dalë peshkopët e Beratit, Dionisi nga fshati Perondi, Methodi (1736 – 1757) dhe Josafi (1752 – 1760) me origjinë nga Myzeqeja[22]). Në bibliotekën e pasur të manastirit ndodheshin dorëshkrime dhe libra të shtypura në Venecia, kode e korrespondenca dhe një letër e Ali Pashë Tepelenës që tregon lidhjet e Aliut me këtë institucion. Në këtë bibliotekë vinin studiues që nga Greqia, çka tregon interesin që kishin për vlerat dokumentare dhe letrare të tij.[23]) Peripecitë që ka kaluar manastiri vihen re në prishjen e kishës kryesore dhe restaurimet në shtesat e vazhdueshme të tij dhe ndryshimet e herëpashershme.

Manastiri i Ardenicës konstatohet i rëndësishëm pas restaurimit të kishës kryesore në gjysmën e parë të shek. XVIII, në një kohë që manastiri i Apolonisë e kishte humbur shkëlqimin e dikurshëm. Në shek. XVII – fill. XVIII rezulton se manastiri administrohej nga Patrikana e Ohrit siç mësojmë në një dokument të v. 1715[24]). Deri në vititn 1767 kur kjo e fundit i nënshtrohet Konstandinopolit. Të kësaj periudhe janë restaurimet kryesore, si *kathonikoni* i kishës qendrore dhe ndërtesat përreth që vazhduan me Josafët. Rindërtimi i kishës kryesore u bë më 10 maj 1743 në kohën e të shenjtit Method nga Bubullima, dhe zbukurimet e saj me piktura murore dhe vepra arti plastike në vitet 1744 – 1745, nga piktorët ikonografë Konstandin dhe Athanas Zografi dhe ikonat të piktorit ikonograf Konstandin Shpataraku.[25]) Nga mbishkrimet e kishës mësojmë se rindërtimi, zbukurimi dhe ideimi i saj janë një produkt kolektiv i përbërë nga peshkopi, prej priftërinjve, kujdestarëve, murgjërve, laikëve me ekonomitë e tyre. Këta njerëz "të ditur" kanë kontribuar edhe për ndërtimin e kishës së Shën Gjergjit në Libofshë në vititn 1776 në kohën e peshkop Josafit, me shpenzimet e igumenit të Manastirit të Ardenicës, zotit Klimi, muzikant, zotit Manosi dhe arkivistit Mihal. Duket se në Manastirin e Ardenicës funksionone muzika kishtare krahas liturgjisë dhe ceremonive fetare, ruheshin libra dhe dokumentimi i kohës. Attribute të ndryshme të krijuara nga lidhjet shpirtërore dhe fetare, krahinore që kishin krijuar qytetarët e Voskopojës me manastirin duken në mjaft elemente: si

DO NOT COPY

kontributi i esnafëve, bakërxhinjve, muratorëve për zbukurimin e ikonostasit, me ikona luksoze, punë e artistit Konstandin Shpataraku, relike e shkopit peshkopal të Methodit, dhuruar nga qytetari i pasur Janko Voskopojari[26]).

Lidhjet krahinore që kishte krijuar manastiri sollën vendosjen në këtë zonë të disa fiseve nomade (vllahe) nga krahinat JL të vendit, të cilat dimëronin me bagëtitë e tyre duke populluar vendet përreth manastirit. Fiset e ardhura nga krahina e Kolonjës së Korçës populluan fshatin Kolonjë. Të tjera fise erdhën nga qyteti i Voskopojës pas prishjes së tij në v. 1762. Ato u vunë në anën P të fushës duke u bashkuar me popullsitë e fshatrave Kolokondas dhe Libofshë, nga Grabova dhe Frashëri i Përmetit duke krijuar komunitet ortodoks ndihmës për manastirin. S'është e rastit edhe ardhja e Nektar Terpos pas prishjes së Voskopojës, autor i librit *"Ptisis"*, i cili do të gjente kushtet e nevojshme si murg pranë bibliotekës së pasur për të vazhduar punën e tij didaktike. Shekulli XVIII ka qenë një periudhë lulëzimi i jetës së këtij institucioni, qendër fetare dhe kulturore në krahinë që kishte krijuar marrëdhënie jo vetëm me qendrat lokale brenda vendit, siç ishte qyteti i pasur i Voskopojës, por dhe jashtë kufijve të vendit me qendra ndërkombëtare siç ishte Venecia me librat që importonte prej andej. Me Evropën L, Poloninë dhe Hungarinë manastiri do të ruante lidhjet nëpërmjet emigrimit të shqiptarëve që e ndihmonin me anën e shoqërive të krijuara në këto vende, siç ishte "Shoqëria Ortodokse". Por dhe me Vjenën ku arrinin rrugët tranzite dhe tregtare, pronë e të cilit ishte dhe një nga tregjet e saj, një kandar i cili me lejen e qeverisë austriake të ardhurat e veta ia dërgonte manastirit.

Nga një mbishkrim i ngurtë i zhvendosur i cili ruhet në tryezën e gurtë të altarit mësojmë se ndërtesat përreth anës P u rindërtuan gjatë shek. XVIII – XIX prej atë Vasilit, kujdestarit Kristo Lesit, këshilltarit Spiro Gjini, Jakov Vozhdu, Nikolla Gjergji, kleriku Marku me mjeshtrat dibranë Goli, Premti dhe Grigori, i cili dëshmon për veprimtarinë e atelieve dibrane në objekte kulti të krishtera gjatë shek. XVIII – XIX. Sipas mbishkrimeve të gurta janë ato të rindërtimit të kishës së Shën Triadhës në v. 1924. Ndërtimin e kambanerisë në v. 1934 nga Bozollarët e Kolonjës dhe vendosja e këmbanave latine në të, dhuruar nga familje të pasura të Beratit. Por edhe më shpejt një mbishkrim origjinal shqip me shkronja greke mbi ikonën gravurë të Shën Mërisë e v. 1731 me karakter teologjik është shembull i fjalëve të shkruara që ruhet nga fondi i literaturës së manastirit, si formë adoptimi të kulturës shqiptare në përdorimin e gjuhës shqipe, përpjekje që do të vazhdojnë për formimin më në fund të alfabeteve të gjuhës shqipe me shkronja latine[27]). Këto ndjenja do të zhvillohen në këtë kohë dhe nga frymëzimet e artistëve në veprat e tyre, si në ikonën e Shën Johan Vladimirit, në ciklin e së cilës është pikturuar princi shqiptar i shek. XIV Karl Topia. Artisti Konstandin Shpataraku do ta shkruajë "Mbreti i Shqipërisë". Sikurse Zografët do ta përcaktojnë identitetin e tyre nga afresket e manastireve të malit Athos "shqiptari", konsiderohen si elemente të ringjallijes së ndjenjave kombëtare të kultivuara në Manastirin e Ardenicës gjatë pushtimit osman.

Dihet aksioni përcaktues i shoqërisë shqiptare që administronte dhe frymëzonte mbajtjen gjallë të manastirit dhe të nismave të herëpashershme për ndërtimet, artin, të ndihmave që dhuronin dhe shtrirjen e rrezatimit të kësaj veprimtarie kulturore dhe artistike, si brenda sferës lokale dhe jashtë saj, duke rilindur një traditë rreshtuar atyreve të kaluara të vendit. Janë afreske të kishës me thurrjen ikonografike, përmbajtjen teologjike dhe didaktike, ikonat luksoze, objekte liturgjike të kultit dhe shkëlqimi në përgjithësi i monumentit, dëshmi të lulëzimit të kësaj periudhe. Që në vitin 1889 Ëeingard e përshkruan manastirin si qendër pelegrinazhi, frekuentuar nga të krishterë dhe muslimanë, që nga dhuratat e shumta tregonte se ishte i pasur, gjë që duket dhe me orenditë[28]). Po kështu dhe

DO NOT COPY

Belini e përshkruan kishën të pasur me afreske dhe ikona[29]), shembullin e shkëlqimit të dikurshëm të kishave monastike. Nën pushtimin osman manastiri do të administrohej sipas rregullave të statusit të përgjithshëm të komuniteteve ortodokse që jetonin në Turqi, status që ishte përpunuar në Stamboll në v. 1856 dhe rregullonte njëkohësisht funksionin e shkollave. Me krijimin e Kishës Autoqefale Shqiptare do të hartohej një status i ri në Berat në v. 1922. Një komision i përbërë nga fetarë, laikë dhe murgjër udhëhiqnin jetën shpirtërore dhe ekonomike të manastirit me në krye peshkopin që kishte rezidencën e tij në Berat.

## KISHA KRYESORE LINDJA E SHËN MËRISË
## ARKITEKTURA

Kisha e madhe e manastirit nga pikëpamja arkitektonike i përket tipit bazilikal[30]) të një "shkolle të re" ndërtimore që filloi me ngritjen e bazilikave të para në qytetin e Voskopojës dhe që do të përhapej me shpejtësi në krahinën e Myzeqesë. Tipi i vjetër i ndërtesës karakterizohej në plan (Plan I) prej një forme katërkëndëshe – këndrejtë dhe me një sallë të gjerë me përmasa: (14 m x 8.5 m) transpekti i së cilës përshkon anën lindore në atë perëndimore. Në hieroren ngrihet lart absida gjysmërrethore (rilevim I)) dhe në mjedisin e altarit me në qendër tryezën e gurtë, anash saj formohen mjediset e protezisit dhe të diakonikonit. Aktualisht aspekti i vjetër i Kishës së Ardenicës, nuk do të vonojë, ndërkaq, do të kompletohet dhe, në një masë do të modifikohet. Në periudhën e ardhshme trupit të kishës në anën P do t'i shtohet *narteksi* dhe *ekzonarteksi* dy katësh, viti 1756 në kohën e Peshkop Josafit. Narteksi dhe ekzonarteksi me stilin e hapur të arkadave dhe kolonave të gurta që vështrojnë në oborrin e manastirit krijojnë në aspektin e konstruksionit pavarësinë nën të tëra raportet e kishës. Pozita e kishës në ansamblin e manastirit është shprehje e karakterit centralizues të këtij institucioni. E ngritur me gurë kisha është vendosur në anën P të terrenit (rilevim II), që arrin kuotën më të lartë në anën V duke zbritur nga J me një pendencë që shtrihet me oborrin. Duket që ndërtesa është ndërtuar në një truall të niveluar, përgatitur nga mbushje dhe tarracime guri të cilat mbajnë terrenin e përgatitur për këtë qëllim. Në një pjesë të saj në anën P është vendosur fontana dhe sheshi i cili të përcjell në hyrjen kryesore të kishës. Prapa nga L shtrihen strukturë rrënojash me materiale antike. Rruga që rrotullohet rreth ndërtesës të çon në nëntokë ku ndodhen ndërtesa të vjetra siç është kompleksi i mullirit dhe i bodrumit(fig.3) Mjedisi nga ana V ngushtohet midis murit të kishës dhe murit rrethues duke krijuar një korridor të ngushtë kalimi, që mbyllet me kishën e vogël të Shën Triadhës.

Nëpërmjet mjedisit të qetë të oborrit me disa këmbë shkallë ngjitesh në portikun e hapur me kolona guri dhe harqe që përfshin anën J të ndërtesës, për të komunikuar nëpërmjet dyersh të ngushta për në kishë dhe në mjedisin e narteksit dhe ekzonarteksit dykahësh. Përveç kësaj hyrja për në kishë bëhet nga ana P që komunikon nëpërmjet narteksit dhe futesh në naos me anë të një porte të harkuar. Naosi ose salla ndahet transversalisht me dy rrathë kolonash druri të cilat mbajnë një tavan të rrafshtë mbi të cilën qëndron mbulesa dyniveleshe. Për së gjati kolonave janë montuar poltronat, radha e poltronave, froni i despotit, avoni dhe proksimitari. Ikonostasi i punuar me ar mban dy radhë ikonash të mëdha dhe të vogla mbi të cilën ngrihet kryqi me figurën e Krishtit të kryqëzuar. Kandilet e argjendta varen nga lart – poshtë prej gojës së pëllumbave, duke krijuar një shkëlqim sugjestionues. I gjithë interieri i kishës krijon një përshtypje solemniteti. Nëpërmjet ikonostasit ndahet salla nga mjedisi i altarit. Ky mjedis ndriçohet nga dritarja e ngushtë

DO NOT COPY

e absidës kurse hapësira e naosit ndriçohet nga dritare të harkuara të faqes V dhe asaj J. Salla ndriçohet gjithashtu indirekt nga muri P i narteksit prej katër dritareve, dy të sipërmet dhe dy nga të katit të poshtëm të narteksit.

Dyshemeja e shtruar me pllaka guri në qendër të saj ka një rozetë të punuar artistikisht. Dyshemeja e gurtë do të vazhdojë dhe jashtë me narteksin dhe ekzonarteksin.

Si të tjera monumente, Ardenica paraqet ndikime të ndryshme të stilit roman ose barok, por shpirti i arkitekturës bizantine është manifestuar me të gjitha karakteristikat në interierin e saj. Aspekti i jashtëm i kishës me gurët e punuar pak trashë krijon diferencat e teknikës në trajtimin që i bëhet kornizave të dritareve, buzës së harqeve me gurë të bardhë ose të dekorit të arkitekturës së absidës së jashtme plot elegancë. Forma e harqeve dhe tipi i kolonave me kapitelet, sipërfaqja e jashtme, gjerësia e mureve dhe thjeshtësia alternohen me qetësinë e këtij monumenti. Për nga pjekuria e konceptimit të saj ndërtesa e kishës shpreh një ansambël koherent dhe harmonioz, tipik për zonën e Myzeqesë. Nga pikëpamja e formës kisha e madhe do të ushtrojë një ndikim të fortë mbi të tëra kishat e zonës së Myzeqesë, vështruar dhe në veprat plastike, të dekorimit muror e të ikonografisë duke u konsideruar si "mëma" e të gjitha kishave të rajonit që u ndërtuan gjatë shek. XVIII – fill. XIX.

Gjatë punimeve të restaurimit dhe rikërkimeve për t'u zbuluan çka ishte zhdukur duke ruajtur raportin pikturë – arkitekturë, ndërhyrjet u përqëndruan në murin P të narteksit (rilevim VI). Nga zhveshja e murit nga suvatimet dhe badizhoni i gëlqeres në fasadën e murit doli në dritë teknika e veçantë e ndërtimit të kësaj pjese dhe elementë të rëndësishëm të stilit roman. Kështu u zbulua mbushjet me mur guri të dy dritareve origjinale dhe pjesës së sipërme të portës kryesore deri në përmasën e sotme. Në formën fillestare, pra arkitektura kishte portën e lartësuar dhe dy dritaret anësore të stilit roman, të cilat pushtonin në trajtën e tyre të gjithë murin. Dy dritaret ishin të hapura dhe komunikonin me hapësirën e naosit. Në këtë kohë nga vrojtimet që kemi bërë muri i narteksit ishte i shkëputur dhe pa lidhje me muret anësorë të kishës. Duket që ky mur nga teknikat e punimit me gurë të skalitur në këndet V dhe J, në harkun e derës dhe lidhjet e gurëve me pak llaç tregojnë për një teknikë të hollë të arkitekturës së shekullit XII.

Restaurimi dhe sondazhet arkeologjike rezultuan se ndërtesa e kishës ka kaluar në disa etapa restaurimi, modifikimesh dhe shtesash deri në gjendjen aktuale:[31])

Sondazhet arkeologjike të bëra në themelet e murit V zbuluan gurë në faqet e të cilave kishte intonako me afresk. Gurë të këtij lloji u zbuluan dhe në murin J.

Mbi këto themele u rindërtua nga themelet ndërtesa e kishës që daton vitin 1743. Muret e të cilit u bashkuan me murin P që i takonte naosit dhe narteksit. Në këtë aspekt në v. 1744 pikturohet i gjithë interieri i kishës dhe faqja P e narteksit.

Modifikimet do të ndodhin kur do të shtohet narteksi dhe ekzonarteksi. Për funksionin shoqëror të saj u çelën 4 dritaret, dy në katin e sipërm dhe dy në katin e poshtëm, duke prishur afresket si në anën e brendshme të interierit ashtu dhe në anën e jashtme të narteksit. Dritaret romane u mbyllën me mur guri dhe u përdorën si mbështetëse të arkadave të narteksit, por edhe porta e madhe u zvogëlua me një portë më të ulët me hark.

Ndryshime pësoi edhe dekorimi muror që u prish nga hapja e dritareve në faqen P të narteksit, kurse në interier ajo u ri-kompozua me anë të një lyerjeje të hollë afresku nga të njëjtët artistë, Zografët. Duken qartë dy fazat e pikturës dhe ngjitja e intonakos së hollë në perimetrin e kompozimit *fjetja e Shën Mërisë* dhe mbishkrimit të kishës.

Si përfundim dhe sipas mendimit tonë në terrenin e manastirit duke parë radhën e ndërtimeve dhe materialeve të zbuluara ekzistonte një "kishë fillestare" përpara shek. XII – XIII, gurët e së cilës me intonakon e afreskeve u përdorën

DO NOT COPY

për themelet e kishës së shek. XIV – XV. Kjo kishë fillestare ishte dhe embrioni i manastirit përreth së cilit u ngritën në shekujt e mëvonshëm muret rrethues të tij dhe u formua manastiri *Lindja e Shën Mërisë* si institucion.

## DEKORIMI MUROR STILI I PIKTURËS

Nga shpirti I përgjithshëm, dekoracionin e karakterizon në përmbajtjen artistike stili monastik i krijimit, që trashëgon ashpërsinë e mjedisit shpirtëror të murgjëve, duke përdorur mënyrën e qartë të shprehjes plastike.

Atmosfera hijerëndë zotëron interierin e sallës, përmbajtja e së cilës tregohet me shkrimet evangjelike, me subjekte nga bibla[32] realizuar nga ngritja e përgjithëshme e kulturës dhe formacionit artistik bashëkohor gjatë shek.XVIII.

Kisha e manastirit është një shembull I dekoracionit, ikonografisë dhe tematikës që zhvillohet në raportet me sipërfaqet e gjera të mureve dhe polikronisë së pikturës. Megjithë ndryshimet që solli stili piktural në rritjen e subjekteve mbushur me personazhe, nevojë kjo e domosdoshme për plotësimin e hapësirave dhe kërkesave për zhvillimin e liturgjisë, piktura e Ardenicës do të ruajë trashëgiminë artistike të vendit, si nga pikëpamja e programit dhe të adoptimeve të temave të mëdha të trajtuara në një[32] *Ungjilli I Shenjtë, K.Kristoforidhi, Tiranë 1936. L.Reau, Ikonografie de l'art chretien, Nouveau Testament, Tome II, Paris 1974* gjuhë të thjeshtë dhe popullore. Ekzekutimi I temave fetare, sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe procedimit teknik, tregojnë për shkencën e njohur nga piktorët: historisë, ikonografisë, teknologjisë dhe teknikës pa të cilat artistët nuk do të realizonin afreskat me figurat, lëvizjet dhe qëndrimet qe shpjegojnë ngjarjet, portretet me karakteristikat e vecanta ose temat e ditës që u përshtaten rrethanave të kohës duke përpunuar në themel estetikën dhe mënyrat e artit të vjetër.

Programi i plotë ikonografik që do të "rilulëzojë" në këtë kohë karakterizohet nga harmonizimi i kompozimeve të cilat i përshtaten perceptimit vizual të spektatorëve. Ciklet ikonografike zhvillohen ne 4 fasadat e mureve dhe në fasadën perëndimore të narteksit. Duke iu përshtatur ansamblit ikonografia shtjellohet sipas sistemit rrethor dhe funksionit liturgjik. Salla e ndarë në tre nefe lejon zhvillimin e cikleve duke u vënë përballë syve të spektatorëve pjesë të rëndësishme të afreskave. Në 4 zonat të regjistave të vendosura një mbi një nga të cilët dy të sipërmet që kufizohen me vijën e tavanit ndahen nga skena katërkëndore, nën ato regjistri i ngushtë i medalioneve të gërshetuara nga ornamentika e degëve të hardhisë dhe në zonën e poshtme tre planësh pikturohen shenjtorët e kishës.

Në ambientin e altarit të përbërë nga absida dhe dyniket afreskat i përkasin pikturimit të Platiterës me krahët e hapura poshte saj në këtë zonë Kungimi i Apostujve dhe Etërit Meshtarë. Zona midis nikeve i përket njërës protezisit dhe tjetra diakonikonit me figurat e Shën Stefanit dhe Vikentit i cili të sugjestionon me vështrimin ballor dhe temianicën që mban në dorën e djathtë. Në të dy anët e absidës pikturohen mesa duket nga rëndësia që kanë Shestia e Krishtit dhe Pentakostia, kurse mbi harkun e absidës në formën e një frizi zhvillohet Tryeza e Shenjtë.

Cikli ikonografik kushtuar jetës së Shën Mërisë hapet në murin jugor me episodin, Lindja e Virgjëreshës kompozim ky që i atribohet emrit të pardones së kishës deri tek Hyrja e Shën Mërisë në Tempull, vazhdon me Ungjëllizimin poshtë dhe përfundon tek nisja e Josifit që e mbyll ciklin. Pothuajse të gjithë sipërfaqen e regjistrave do të përfshihet nga Jeta e Krishtit që përbën dhe dy skenat simbolike, Pagëzimin ne lumin Jordan

DO NOT COPY

dhe Metamorfoza. Skenat nga fëmijëria do të vazhdojnë në regjistrin e dytë ku spikat kompozimi me Magët duke vazhduar në pjesën e murit perëndimor që mbyllet me Ipapandinë.

Me zgjimin e Llazarit hapet cikli i Jetës publike të Krishtit dhe mrekullive të tij, vazhdon horizontalisht deri tek Tradhëtia ku fillojnë episodet e Vuajtjeve që do të referohen në fasadën perëndimore me Gjykimin dhe Rrahjen. Panoja masive Fjetja e Shën Mërisë dominon ikonografinë në mesin e fasadës perëndimore. Në mungesë të dekoracionit nga prishja e afreskave ngjarjet pasojnë me skenat që ruhen si Vajtimi, Ringjallja dhe episodet pas Ringjalljes që përfundojnë me Shërimin e Ulokut. Afreskat paralelizojnë me skenat simbolike të Krishtit dhe Virgjëreshës si Nënë e Zotit. Të pikturuar dy e nga dy në sipërfaqet e harkuara të dritareve janë paraqitur profetët si Joil, Jezukil, Amon, Osie dhe mbi harqet Isai e Zaharia, Davidi e Nauni në murin verior. Shenjtorët e kishës në fundin e mureve I përshtaten rëndësisë hierarkike, në krye të murit janë pikturuar Kryeapostujt Petri dhe Pavli, Shën Gjergji,Shën Prokopi, Trifoni deri tek Julita,

Kryeëngjëlli Mihail me madhësi mbinatyrale simetrizohet me grupin e Peshkopëve në faqen e murit perëndimor. Në murin perëndimor vazhdojnë figurat e shenjtorëve si Shën Damaskinos, Kukuzeli, Kostandini e Helena. Megjithë të·dëmtuara në murin verior mund të dallojmë Shën Athanasin, Shën Grigorin etj. në fasadën perëndimore të narteksit paraqitet në pjesën e sipërme Gjyqi i Fundit dhe poshtë tij Apokalipsi.

Kemi të bëjmë me një ansambël të shumanshëm që organizohet me variacione të pasura koloristike me akse të ndryshme e me lëvizje energjike të qëndrimeve të figurave që ekuilibrohen me të kundërtat e me përmbajtje shprehëse. Përfshirja ikonografike e temave dhe të kundërtat e vazhdueshme, harmonizimi koloristik dhe siluetat e gjetura me mjeshtëri përcaktojnë mbi të gjitha karakterin kompleks të veprës. Përshtypja e përgjithëshme është në veprim me anë të lëvizjes ose qetësisë që përshkon sipërfaqet piktorike, duke rrezatur me kohën edhe elementin emocional si gjendjen psikologjike të zhvilluar të personazheve nëpër skena që udhëhiqen nga figura e Krishtit. Kjo do të thotë për zbërthimin e mendimit fetar në personazhet në një botë të ndjeshme të subjektit njerëzor.

Nëpër skenat elementët përcaktues janë peizazhi natyror, skenografia e arkitekturës ku figura e njeriut zë vendin kryesor. Në kompozimet shpjegohet parashikimi i veprimit nëpërmjet zgjidhjes kompozicionale, thekson gjendjen emocionale dhe e përcakton burimin e pregatitjes së tematikës fetare. Personazheve u krijohet vendi i përshtatur në plan të parë ose të dytë sipas subjekteve përkatëse. Këto figura dhe lëvizjet e tyre përcaktojnë edhe hapësirën e raportet, krijojnë përshtypjen e thellësisë me anë elementësh të perspektivës duke dhënë prioritet anës ideore të subjektit. Mjedisi e personazhet mpleksen ndërsjelltasi në mënyrë mistike si psh te skena Larja e Këmbëve (fig.4). Krishti i mënjanuar me anë të kompozimit me lirë të përveshura i lan këmbët Petros duke krijuar marrëdhënie nderimi. Grupi apostujve në anën tjetër të kompozimit përgatisin veten e tyre për t'u paraqitur te Zoti. Interesante në këtë kompozim është figura në plan të parë e Shën Ilias i cili i emocionuar pret rradhën. Në sfond duket skenografia e shtëpive dhe siluetat e pemëve që mbushin peisazhin. Nga pikëpamja e përgjithëshme dekoracioni krijon te shikuesi përshtypje prej lëvizjeve të ndryshme dhe siluetave të qarta të cilat dendësohen sipas episodeve apo rrallohen e shtrihen ritmikisht me ngjitje të përmbajtura. Figurat janë plastike, në grupime të shumta që ruajnë lidhjen me prototipin e tyre e u nënshtrohen ligjeve të krijimit artistik. Me silueta të shpeshta të pikturuara me shkathtësi figurat e dy regjistrave një mbi një organizojnë hapësirën e shkaqjeve me anë të ndryshimit të madhësive dhe

DO NOT COPY

plasticitetin e ngjyrave të tyre. Nga afër ato japin përshtypjen e një maketi memorial në dimensionet e veprës. Në zonën e poshtme, figurat e mëdha të shenjtorëve gati natyrale krijojnë figurën e lëvizjes në hapësirë me marrëdhënie reciproke të këndëshme me qëndrimet që krijojnë variacion dhe stabilitet.

Etërit e kishës me shkrimet e hapura nëpër duar, ëngjëjt satelit tek Tryeza e Shenjtë ku spikat njëri prej tyre (fig.5) që mban trupin e Zotit është një nga afreskat më të bukura të kësaj zone piktorike. Prej këndej nga muret e altarit çojnë në kompleksitetin qëndror të pikturës së absidës që dallohet për ekuilibrimin e pjesëve që e përbëjnë. Figura kulminante e Platiterës tregon forcën dhe ndjeshmërinë e mjeshtrisë së njërit piktor apo tjetrit nga Zografët që krijuan këtë ansambël artistik.

Monumentaliteti, qartësia e siluetës, trajtimi i gjerë i palave që derdhen nga krahët dhe perthyerja e këmbëve që shkelin në piedestal i japin figurës bukurinë klasike që rrjedh nga epoka e artit të vonë të paleologëve. Përpara saj ulen në prehër Krishti fëmijë i cili paraqitet në njërën dorë të mbështetur te globi dhe tjetrën gjysëm të ngritur me gishtërinjtë e mbyllur në formë bekimi vështron nga spektatori. Lëvizja e gjallë e Krishtit qe merr në prehrin e nënës e bëjnë këtë figurë mjaft ekspresive. Është interesant portreti i Shën Mërisë me fytyrë rinore, freskinë dhe vështrimin e butë që e largojnë tipin e saj nga prototipat e mëparshëm (fig.6). Afresku i Shën Mërisë, Platitera, besojmë se është vepra më e mirë e këtij lloji që është pikturuar në bazilikat e shek.XVIII.

Në të dy anët e Shën Mërisë qëndrojnë kryeëngjëjt me ilitot e hapura deri poshtë të cilët shquhet për qëndrimin elegant dhe trupin e përkulur në formë nderimi. Njëri prej tyre mund të dallohet për trajtimin artistik të fytyrës në dhënien e psikologjisë dhe ndjeshmërisë (fig.7) ndaj Shën Mërisë.

Në tërësinë kompozicionale zotërojnë ngjyrat e ngrohta duke filluar nga e verdha okër, gështenjë, gri, e kuqe karpllak, si në maforion dhe petkun e Shën Mërisë përkatësisht me variacione tonale dhe motive të shumta fiorale në petkat e ëngjëjve që mbajnë trupin e Zotit te Tryeza e Shenjtë. Një e kuqe e ndritëshme pikturon imation e Shën Mëhillit, që gjallëron paraqitjen e përgjithëshme të dekoracionit. Në unitetin e përgjithshëm të ansamblit e kuqja është përhapur mirë dhe përbën një element kromatik të rëndësishëm të veprës. E kuqja trëndafil e çelët, gri kobalti, bluja, e gjelbërta e ullirit, e bardha dhe e zeza me variacionet që krijojnë, pikturojnë figurat e tjera.

Nga ngjarjet e viteve të fëmijërisë së Krishtit zhvillohet cikli me Dijetarët. Episodi i pare, që titullohet Rruga e Zotit YII, tregon drejtimin e tre kaloresve të udhëhequr nga ëngjëlli i vogël në vendin e lindjes së Krishtit. Në sfondin e skenës janë paraqitur dy male të thepisur dhe errësira e natës që krijojnë atmosferën e tabllosë, në kontrast me dritën që zverdhëllon shpatin e malit, peisazhin poshtë në plan të parë, shtëpitë me pullazet e kuqe dhe figurat në miniaturë të barinjve dhe lopëve, karakteristikë kjo për peisazhin e Myzeqesë duke evidentuar kështu figurat madhore të Dijetarëve dhe rolit që kryejnë ata në kryerjen e misionit për gjetjen e Krishtit të vogël. Cikli vazhdon me episodin e dytë, Dhurimin e dhuratave. Në qiell shndrit ylli pesë cepësh dhe në këndin e skenës është paraqitur një mal i dhëmbëzuar. Kompozimi lidhet me episodin e parë. Dijetarët e kanë gjetur fëmijën e porsalindur. Në plan të parë të skenës paraqitet Shën Mëria e ulur në një podium të lartë me Krishtin e vogël në prehër. Afër saj qëndron Josifi I cili vështron në drejtim të Dijetarit plak të gjunjëzuar duke i puthur dorën Krishtit të vogël. Dy personazhet e tjerë me dhuratat te cmueshme që mbajnë në duar I japin ton familjar skenës. Natyrshmëria e personazheve dhe zgjidhja origjinale e kompozimit e bën këtë të veçantë në tërësinë e ansamblit. Mendojmë se piktorët kanë

DO NOT COPY

një ndikim nga arti perëndimor në shfaqjen e kësaj skene sepse kjo shihet në petkat e Shën Mërisë dhe shprehjen psikologjike plot jetë dhe me tipare gati realiste kurse Dijetarët janë të veshur sipas stilit perëndimor. Kjo vihet re në pelerinat, kurorat dhe dhuratat (fig.8).

Cikli i çudirave, te muri verior dhe në vazhdim ka karakter përshkrues dhe variacionesh në krijimin e vendit të skenave kompozimet janë në lëvizje. Vijat horizontale dhe diagonale i japin një lloj qetësie qe përputhet me përmbajtjen historike por në këtë qetësi të brendëshme pritet një nga mrekullitë e Krishtit, Ngjallja e Llazarit. Ai paraqitet në krye të apostujve me një dorë të ngritur në drejtim të Llazarit kurse para këmbëve të tij janë kërrusur përvajshëm Maria dhe Martha që i luten për të vëllanë. Krishti ka kryer mbrekullinë. Elementi më i gjallë i kësaj skene është figura e të riut, që i ka zgjidhur fashat e trupit dhe po e nxjerr nga sarkofagu. Pamja vërtetonjëse dhe e qartë e skenës sinkronizohet edhe me elementët e tjerë qe influencojnë, siç janë grupi i grave me cohat që kanë mbuluar hundët nga era e rëndë e varrit (fig.9).

Nga kronologjia e skenave vihet re efekti tregrimtar i ngjarjeve biblike. Modelimi i ngjeshur, organizimi I dendur dhe pjesëmarrja e kompozimeve ndryshon nga ato pasuese, si tek Lutja e te Tradhëtia. Në këto dy skena, modelimi i portreteve ka më tepër dritë dhe qetësi në shkallëzimet tonale të ngjyrave. Tek Lutja, në Getseni, orët plot agoni jehojnë në natyrën e peisazhit, tek pemët e rralla dhe në personazhet që janë grupuar në anë të skenës. Ëngjëlli që vjen nga lart drejt Zotit, me aurolë të ndritëshme dhe me imatio të kuqe në krahë, thekson poetikisht hapësirën kozmike të errët dhe të pafund, në krahasim me figurën e vogël të tij. Imazhi I Krishtit përsëritet poshtë në planin e parë, me Petron, i cili rri zgjuar në pritje të Zotit. Të ngjeshur pas njëri-tjetrit, të shkujdesur dhe të munduar nga gjumi janë paraqitur në grup nxënësit, të cilët të çuditur zgjohen nga ardhja e Krishtit (fig.10).

Në Tradhëtinë, vëllimi i dendur i malit është I shqetësuar si vetë patosi i njerëzve, që trondit grupet e dendura dhe duket me lëvizjet e sforcuara të figurave, që kanë rrethuar Krishtin. Në të djathtë të tij, Juda ka afruar fytyrën dhe pregatitet të japë të puthurën por, tashmë vështrimi i Zotit shikon në të kundërtën e tij, tek shërbëtori që bëhet gati t'I ngulë shpatën hebreut. Figurat e tyre me shkopinj në duar, me lëvizjet e gjalla dhe shprehje kërcënuese përbëjnë elementë ikonografikë bashkëveprues në shfaqjen e skenës (fig.11).

Në aspektin memorial, artistët në fasadën e murit perëndimor kanë pikturuar skenën masive Fjetja e Shën Mërisë dhe sipas subjektit të saj përmban edhe titullin e padrones së kishës. Panoja zotëron pjesën e mirë të fasadës. Ajo zhvillohet horizontalisht dhe në thellësi në sfondin e mbushur me personazhe të shumte që krijojnë një atmosferë solemne (fig.12). nga erërat e qiellit pikturuar Brenda mandorlës ka zbritur Krishti me imazhin e Shën Mërisë që e mban të dorë dhe për të marrë shpirtin e saj. Në të dy anët figurat e ëngjëjve lavdërojnë dhe ngrëbnë latr madhështinë e tij. E veshur me mafior vishnje të kuqe është shtrirë për së gjati Virgjëresha në krevatin e mbuluar me pluhur të bardhë stolisur me lule që vë në pah bukurinë fizike dhe shpirtërore të saj. Praën trupit janë përkulur apostujt të ndarë në dy grupe kompozicionale. Njëri prej Apostujve qëndron prapa krevatit i pari i grupit duke vajtuar. Dorën e mban të mbështetur te faqja. Mateu ka mbuluar fytyrën me të dy duart duke ndjerë kështu peshën e rëndë të pikëllimit. Njëri nga apostujt, më i vjetri, është përkulur mbi Shën Mërinë (fig.13). Në grupet e kompozimit janë gratë e mbledhura kokë më kokë, që vajtojnë dhe bisedojnë për momentet e vështira të jetës së saj. Papritur, me një shikim mjaft shprehës, dallohet portreti i një hierarku në plan të dytë, i cili bën efekt me shprehjen e tij tej

DO NOT COPY

emocionale. Siluetat e ndërtesave dhe mureve të qytetit duken në plan të dytë, duke përcaktuar kufirin e hapësirës qiellore prej nga zbresin në fluturim ëngjëjt, mbi shtëllungat e bardha të reve. Peisazhi në thellësi jep planin fundor të skenës, me kodrat e ndritëshme dhe me dy figurat interesante në prespektivë, ajo e një plaku dhe e një të riu, që bëjnë pregatitjen e varrimit[33].

Cikli i çudirave në murin verior ka karakter përshkrues dhe variacionesh, në krijimin e vendit, të skenave dhe figurave të veçanta. Mbi harkun e dritares është pikturuar profet Nauni, i cili shquhet për shprehjen ekspresive dhe lëvizjen e trupit (fig.14). Në njërën dorë mban shkrimin hapur, me përmbajtje profetike dhe tjetrën e mban qe tregon skenën poshtë tij, Mosbesimi i Thomait. Skena përshkruan ngjarjen e çuditshme të vërtetimit të Ringjalljes së Krishtit. Ai qëndron në piedestal me ndryshimin e raporteve të fizionomisë së tij me atë të Thomait ndërsa Krishti është krejtësisht I hapur dhe tregon vendin e gozhdës në kraharor. Thomai paraqitet I mbyllur në shprehje dhe mosbesues derisa vendos gishtin në vrimën e gjoksit. Skena ka marrëdhënie në modelimin, tipollogjinë, shprehjen figurative. Ajo plotësohet si gjithmonë nga dy grupet e apostujve me shprehjet e tyre teatrale duke ndjekur çudinë. Në skenë influencojnë arkitektura e ndërtesës mbrapa Krishtit që kulminizon me dramacitetin shprehës dhe ekspresiv të tij (fig.15).

Në zonën e poshtme të mureve janë pikturuar shenjtorët në këmbë të cilët na imponojnë në përgjithësi dukurinë e figurave jetësore në lëvizje dhe në pozicionet me çehre të ndritur dhe stolisje të pasura nëpër veshjet e tyre. Fizionomia, trupi, qëndrimi dhe lëvizjet e duarve japin përshtypjen e një dukurie të përafërt me njeriun që vepron në kohë dhe tension në ndihmë të të kuptuarit nga besimtarët. Kompozimi I shenjtorëve në hapësirën e dhënë realizohet me dallime në qëndrim dhe lëvizje, të ballancuara dhe modelim të guximshëm duke krijuar kështu marrëdhënie ndërmjet tyre. Zografët kanë paraqitur një galeri personazhesh të portretizuar që përbëjnë vlera piktorike në interierin e Ardenicës. Ata kanë zgjedhur, duke u mbështetur në Bibël, shenjtorët që nga më të vjetrit deri te më të rinjtë.

Kryeapostujt Petri dhe Pavli (fig.15-16) janë paraqitur me një qëndrim të njëjtë, gjysëm të kthyer nga njëri-tjetri. Të dy mbajnë në dorë maketin e kishës. Modelimi i tyre me rrobat shumëpalëshe që I varen te këmbët tregon elegancën e trupave. Fizionomia e plakur, flokët e bardhë dhe mjekra e shkurtër, vëshrimi i përqëndruar dhe i qetë karakterizojnë tipin e trashëguar nga e kaluara. Apostulli Pavli pikturohet me qëndrim karakteristik të këmbëve të bashkuara dhe palat e shumta që I bien nga rrobat deri poshtë. Në dorën e majtë mban Ungjillin e mbyllur. Fytyra fisnike me ballë të lartë dhë pak flokë ndriçuar nga drita, sytë dhe vetullat e harkuara, hunda e zgjatur dhe pak e kthyer ngjasojnë me prototipin e këtij personazhi. Ndër shenjtorët e rinj piktorët kanë zgjedhur Shën Gjergjin dhe Shën Prokopin.

Shën Gjergji është paraqitur në pozicion frontal me këmbë pak të hapura në tokë dhe që I japin lëvizje të lehtë krejt figurës. Në dorën e djathtë të ngritur mban një kryq të cmuar dhe dorën tjeter e mban të mbështetur te bastuni. Është e vecantë veshja etij me pelice e cila i hapet duke lënë të shihet hitoni i zbukuruar me ornamentikë floreale dhe petkat që i bien deri te këmbët. Fizionomia rinore e fytyrës me flokë të dendura të valëzuara që e rrethojnë si kurorë dhe vështrimi kureshtar e bën portretin e tij mjaft tërheqës. Në anë të tij Shën Prokopi paraqitet me veshje të kushtueshme që i nxjerrin në pah trupin e derdhur. Pelerina i mbulon supet dhe nën të një brez i linjtë i zbukuruar me motive popullore i mbështjell mesin. Në dorë mban kryqin afër gjoksit dhe me tjetren te ulur poshte, ka kapur thiken e vogël. Flokët e errëta i rrethojnë kokën e bukur duke rënë prapa qafës me përdredhje. Fytyra e gjallë dhe e rregullt përshkohet

DO NOT COPY

nga soditja dhe ëndërrimi djaloshar (fig.17-18).
Shën Trifoni është pikturuar i ri dhe melankolik në shprehjen e fytyrës, ka kthyer kokën në gjysëm profil dhe shikon nga spektatori. Hapi i lehtë dhe këmba e majtë e përthyer te gjuri harmonizohen me dorën e djathtë që mban draprin e vogël dhe tjetrën të ngritur prane trupit. Pelerine e gjatë i mbështjellë shpatullat dhe hapet me pala te valëzuara. Këmisha e hollë nën të është e lidhur pas mesit me anë të një brezi në formë kordele që i nxjerr në pah bukurinë trupore (fig.19).
Shenjtorët Kozma dhe Damiani (fig.20-21) janë paraqitur në pozicion pothuajse statik, të heshtur me vështrim nga spektatori. Kanë fizionomi të ngjashme me njëri-tjetrin si nga format e hequra të fytyrës, flokët, mustaqet dhe mjekrat e holla. Të dy kanë veshur rroba që krijojnë pala të shumta. Ata mbajnë në dorën e djathte solinger dhe në tjetrën Shën kozmai një kuti të ngushtë ilacesh dhe Shën Damiani një kuti me kapak të hapur. Këta dy shenjtorë janë mjekë ashtu sic tregohen në historinë e tyre.
Në njohjen e teknikës së pikturës dhe të stilit duket konceptimi unik i afreskave. Zografët i mbeten besnik kanonit tradicional të pikturës gjë që vihet re më mirë te figurat e shenjtorëve. Ata duke trashëguar tekniken e vjetër i japin shprehjë dhe forcë portreteve. Harku i ngritur i vetullave, qe rrudhos pak ballin i jep shikimit theks dhe shprehjes forcë dhe ekspresivitet. Sytë zakonisht tek të rinjtë tek cepat ngushtohen, hunda është e hollë dhe e zgjatur plot elegancë kurse goja është e vogël. Flokët dhe mjekrat sjellin me valëzime dhe shpesh kurorëzojnë fytyrën. Tonalitieti me ngjyrë gështenjë I tyre ose ngjyra e bardhë tek të vjetrit krijojnë silueta brenda aurolave. Vizatimi i madh përcakton të përgjithshmen e figurës duke ndalur pastaj në karakteristikat, dhënien e formave dhe ndricimet e sipërfaqeve që i japin vellimet e ngjeshura të krijuara organikisht në një ikonë që buron nga ideja e caktuar e bukurisë fizike dhe asaj shpirtërore.
Kështu me mjeshtëri paraqiten ndryshimet në moshë, në karakterin, në tipin të të gjithë shenjtorëve të kishës. Në përgjithësi figurat kanë lëvizje, imponojë personalitet dhe shprehin moralin si tek Petri dhe Pavli, mirësinë shpirtmadhësinë si tek Kozmai dhe Damiani, bukurine dhe melankolinë si tek Prokopi dhe Trifoni gjë që I cojnë figurat në një botë ideale.
Njohja e teknikës së pikturës tek Zografët tregon për një konceptim unik të caktuar dhe kjo vihet re në të gjithë pikturën e Ardenicës dhe metodën që kanë përdorur. Ne dime qe ata kanë pasur edhe një manual (Korçe) të hartuar nga ata vetë me përmbajtje hagjeografike, teknologjike, teknike I cili është vlerësuar edhe në malin Athos. Pra,piktorët ndiqnin linjën e tyre. Afreskat ata i ekzekutojnë me tre tonalitete bazë dhe në secilin ton krijojnë variacionet e ngjyrave duke filluar që nga e errëta deri tek e ndricuara. Ata e fillojnë vizatimin nëpërmjet sinopios së kuqe, vendosin tonin e pergjithshëm bazë ose local, krijojnë vëllimet e përgjithshme me një ton të dytë kurse me një ton tjetër më mbulues përfundojnë pikturën dhe njekohesisht me shkathtesi përcaktojnë vizatimin dhe thekset. Portretet modelohen me pjesë të ndricuara, palat e rrobave janë të lehta ose të rënda, me thurje të ndryshme që vizatohen me silueta të qarta.
Vëllezërit Kostandin dhe Athanas Zografi nga Korca realizuan këtë vepër në manastirin e Ardenicës që u bë themeli I punës së tyre së mëvonëshme në manastiret e malit Athos[34]. Punët e tyre reflektojnë nivelin artistic të pikturës shqipëtare gjatë shek. XVIII por edhe shqetesimet fetare dhe ideologjike të shoqërisë. Në pikturën e Ardenicës ne vëmë re këto tipare:

DO NOT COPY

1. Piktorët Kostandin dhe Athanas Zografi janë artistë të "mësuar"[35] por edhe të talentuar të cilëve iu besua jo vetëm dekorimi imanastirit të Ardenicës por edhe veprat në malin Athos gjatë shek.XVIII.
2. Për të parën herë, artistët do të paraqesin në artheksin e Ardenicës Gjyqin e Fundit dhe skenat masive te Apokalipsit. Afreskat pasqyrojnë në mënyrë origjinale idetë ereja të kësaj periudhe, shpresën e clirimit nga mëkatet që korespondon me clirimin e vendit nga otomanët.
3. Ciklet ikonografike paraqesin ato të paleologëve të trashëguara që nga shek. XIV por që shumohen në dekoracionin dhe marrin karakter tregimtat dhe didaktik në shërbim të besimtarëve por edhe të integrimit të fasadave të interierit. Këto krijime vine nga Testamenti i Ri dhe Jeta e Shenjtorëve, Tradita kishtare, Mitologjia dhe jeta e përditëshme e frymëzuar nga ambjenti local. Ne stilin e pikturës vihen re elementët natyralistë, delikatë, të hijshëm dhe efekte qe pasuruan në këtë periudhë artin figurative.
4. Piktorët pavarësisht nga stili i "kompromisit" ose dobësia artistike që rrallë vihët re në ansamblin u mbështetëm në traditën e vjetër të shek.XIV por duke e zhvilluar atë në kushtet e reja megjithë influencat e fuqishme të artit perëndimor të cilat i adoptonin sipas estetikës bizantine dhe stilit piktorik të tyre

DO NOT COPY

*)Shkrimi është një sintezë e shkurtër e studimit mbi Manastirin e Ardenicës në përmbajtjen e të cilit është vepra e artit e vendosur në kohën dhe vendin që është realizuar. Gjithashtu ky monument mund të shërbejë zhvillimit të turizmit kulturor në këtë rajon.

[1]) Mbi kuotën 195 m mbi nivelin e detit. *Harta e Republikës së Shqipërisë*, shk. 1 : 250 000.

[2]) N. Jorga, Leson – Sorbone 1928, "Fjala Bizantin ka qenë gjithmonë përdorur çfarë ishte e kaluar ne Europën L që në fillim të shekullit IV. Ky ishte një gabim, ky term ka qenë përdorur nga drejtuesit e tyre, panegyristët e tyre, pushtuesit e tyre, paraqitësit e literatures kanë parasysh gjithmonë Perandorinë Romake. Provincat jetonin një jetë të pastër. Unë pranoj që kryeqyteti me këtë paraqiste si klasë dominuese, gjithmonë të transformuar me elementët e vet nacionalë, por duke konservuar të njëjtët pushtues."

[3])*Gazeta Shqiptare*, Bari – Itali, nr. 304, dt. 22.12.1929.

[4])A. Buda, *Mbi disa aspekte të njësisë dhe të ndryshueshmërisë në historinë e popullit shqiptar, dhe popujve të tjerë të Ballkanit*, "Shënime Historike", Tr. 1986, f. 284.

[5])A. Baçe, *Rrugët shqiptare në Mesjetë, shek. VII – XV*, "Monumentet", Tr. 1984, f. 60.

[6])H. Ceka, *"Apolonia"*, Tr. 1958.

[7])A. Baçe, *Kalaja e Beratit*, "Monumentet e Kulturës në Shqipëri", Tr. 1975, f. 54.

[8])A. Grabar, *L'art du moyen age en Europë Orientale," editions albi michel"*, Paris 1968, f. 138.

[9])A. Meksi, *Arkitektura dhe datimi i kishës së Manastirit të Pojanit*, "Monumentet", Tr. 1971.

[10])V. Puzanova, Dh. Dhamo; *Njekatorije pamjatniki monumentalnoi yzivopisi XIII – XIV vjekov Albanij*, "Studia Albanica", Tr. 1965, f. 155 – 163.

[11])A. Ducellier, *La façade meritene de l'Albanie au moyen age, Durazzo et Valona, XI – XV siecle a Institut for Bolkan Studies Thesaloniki, 1981, f. 131.*

[12])F. Noli, *Historia e Skënderbeut (Gjergj Kastriotit), Mbretit të Shqipërisë, 1412 – 1468, Boston 1921, f. 84 (Ch. Hopf, Chroniques Greco – Romanes Inedites ou peu Connsues), Berlin 1874, 4.*

[13])Kastoria – Buzamnee Art Grecce, *Hogios Athanasios Tou Monzaki.*

[14])A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo; *"Historia e arkitekturës shqiptare", Maket, Tr. 1979, f. 278.*

[15])H. Ceka, *Dega J e rrugës Egnatia*, "Monumentet", *1971/2, Tr. 1971, f. 25 – 31.*

[16])L. Rey, *Guide d'Albanie, Paris 1930, f. 119.* Prachniker, *Myzeqeja dhe Mallakstra (përkthim), Vjenë 1928.*

[17])Prachniker, *vep. cit.*; S. Kosta, *Gjurmë mozaikësh*, "Tradita në Kulturë dhe Art", *(Almanak), Fier, 1980.*

[18])Pandelejmon, *Manastiret e Dioqezës së Beratit*, "Jeta Kristiane", *viti IV, nr. 5 – 6, Tr. 1943, f. 175 – 178.*

[19])Aleksudhi, Metropolit i Beratit që përshkroi Dioqezën e Beratit thotë se mbishkrimi ka qenë vendosur mbi kishën dhe kur u rindërtua kjo është vënë në vendin e sotëm.

[20])Bardhyli, *Historia e bibliotekave në Shqipëri*, "Ylli i Dritës", *nr. 4, Tr. 1941, f. 162 – 169.*

[21])Bardhyli, *vep. cit.*

[22])Th. Popa, *Materiale epigrafike kishtare të vendit si burim për historinë e kulturës së popullit tonë, "Konferenca I e Studimeve Albanologjike, Tr. 1965.*
[23])Bardhyli, *vep. cit.*
[24])I. Sarejejov, *Historia na ohridskata Arkiepiskopija – Partiarskija ot podaneto i pod Turcit do ne inoto unishçozhenie (1394 – 1767), Sofia 1934.*
[25])Th. Popa, *Piktorët mesjetarë shqiptarë, Tr. 1967, f. 16.*
[26])Th. Popa, *Materiale epigrafike…; vep. cit.*
[27])Dh. Shuteriqi, *6 tekste të vjetra shqipe, III, Tr. 1952, f. 17.*
[28])Weingard Gust, Dio Dromenen; *Ethnografie – Phitologi Hist. Untersuechungen, Kl. I ceipsip 1894, f. 86.*
[29])Bellini, *Testimonianze di civilta e d'arte in Albania, Vol. I, Venezia 1938, f. 138.*
[30])V. Puzanova, *Mbi artin shqiptar të shek. XVIII, "Buletin i Shkencave Shoqërore", 1958, f. 40;* A. Meksi, P. Thomo, *Arkitektura pas-bizantine në Shqipëri, "Monumentet", 1971, nr. 11, f. 131.*
[31])R. Gega, *Arkitektura dhe Restaurimet në Manastirin "Fjetja e Shën Mërisë" në Ardenicë, "Monumentet", 1988, f. 150 – 153 †S.* Mihalçka, *Manastiri i Ardenicës dhe konservimi i pikturës murore, "Monumentet", 1986, f. 77 – 97.*

32) S.Mihalçka, Të dhëna mbi disa vepra të artit kishtar në vendin tonë, (Kumtesë), 2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri, Tiranë 2000, faq 245

*34) Georgios Tsigaras, Piktorët Kostandin dhe Athanas nga Korca dhe veprat e tyre në malin Athos (Kumtesë), 2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri.Tiranë 2000, faq.279-280.*

*S.Baltojanis, Piktori dhe restauratori grek në muzeun Benakis, Athinë në bisedë e sipër e pëlqeu pikturën e Ardenicës dhe e Krahasoi atë me veprat më të mira të malit Athos,shek.XVIII. Bisedë e bërë në Ardenicë 1986*
*35) V.Puzanova. Mbi artin shqiptar… vep.cit*

DO NOT COPY

DO NOT COPY

**Plani I- Kisha Kryesore "Lindja e Shën Mërisë"**



DO NOT COPY

**Ril. I - Manastiri i Ardenicës 1983-1987**



DO NOT COPY

Ril: II - Kisha kryesore, "Lindja e Shën Mërisë"



DO NOT COPY

## Manastiri i Ardenicës shek. XIV - XVIII

**Narteksi - fasada perëndimore**
**Ril: III**



DO NOT COPY




Fig.1

DO NOT COPY



*Fig. 2*



*Fig. 3*

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

DO NOT COPY



*Fig. 10*



*Fig. 11*

DO NOT COPY



*Fig. 12*



*Fig. 13*



Fig. 14



Fig. 15

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 16



Fig. 17-18

DO NOT COPY



Fig. 19



Fig. 20-21

DO NOT COPY

# The Monastery and fresco in Ardenica

Our forefathers founded on the hill of Ardenica the monastery named "The born of Saint Mary." Life in this monastery will continue to be deeply submerged under the Byzantine atmosphere up to the end of XIX century when was born the National Joke. The historical sources show that the monastery of Ardenica is built during the time of Despot of Epirus in XII-XIV century, time when, in the antic town of Apollonia, started to be built the monastery of "Saint Maria"

The central church of the monastery, from the architectural point of view, belongs to the Basilica type of church. During the restoration and researching work to find out what has disappeared, keeping the level between picture and architecture, the work was concentrated in the western wall. The soundings on the walls discovered important elements of the architecture, construction technique, and roman style. The central church was the embryo of the monastery around of which were raised the surrounding walls of the assemble.

The decoration of the church is characterized by the monastic style of creation that inherits the cruelty of the spiritual environment of the monks, using the plastic expression. The church of the monastery is an example of the decoration, iconography, and theme developed in relationship with the broad surfaces of the walls and the polychromic picture. Taking in consideration all the changes brought the pictorial style in the growing of subjects full of personage, an immediate need for filling in the space and the request for the holding of liturgy, the picture of Ardenica will keep the artistic heritage of the country considering its program and adoption of the important themes treated in a simple and popular language.

This art work in the monastery of Ardenica realized by the brothers Constantine and Athanas from Korca was used as the foundation of their future works in the monasteries in Athos Mountain.

These two brothers are talented painters that were trusted for the painting of this monastery and other monuments.

-Those two artists will introduce in the narthex of Ardenica "The last trial" and the massive scenes of Apocalypses. The frescos reflect in original way the new ideas of this period, the hope for release from the sins, which corresponds with the freedom from the Ottoman Empire.

-The iconographic cycles are similar to those of the paleologs inherited from the XIV century, which are multiplied in the decoration and take a narrative and didactic character for the believers, but also for the integrity of the interior facades.

- The artists independently from the "Compromise" style or the artistic weakness, that is rarely noticed in the assemble, were based in the old tradition of the XIV century, developed in the new conditions of the western art influence adopted this art in their Byzantine pictorial style.

DO NOT COPY

Adrian ÇENE
Gentian VOKOPOLA

# Një Krisht i rrallë nën gëlqere

"Kisha e Shën Mërisë në Labovën e Kryqit , në afërsi të Gjirokastrës , është një nga monumentet më të rëndësishme mesjetare të Shqipërisë dhe njëkohësisht të mbarë arkitekturës Bizantine " thekson studiuesi gjerman Gutram Koch ( fig. 1) . Emri i Labovës është i lidhur ngushtë dhe me kryqin e saj , ku akoma dhe sot thuhet se ky kryq ishte i pajisur me drurin e shenjtë ku u kryqëzua Krishti, fakt i cili përmendet edhe në Kronikën e Drianopojës .

Kisha e Labovës është e tipit kryq i brendashkruar me kupolë , e cila ka mjaft tipare të veçanta që e dallojnë nga tipi . Kisha në gjendjen e sotme përbëhet prej bërthamës së vjetër gati katrore në plan dhe shtesave në anët jugore , veriore dhe perëndimore . Gjithashtu në vitin 1776 janë rindërtuar absidat dhe janë bërë një sere përfocimesh në brendësi për të mbajtur strukturat e dëmtuara të kishës .

Vetë kisha e vjetër përbëhet nga pjesa qendrore katrore e mbuluar me kupolë, nga e cila hapen katër krahët e kryqit të mbuluar me qemerë cilindrikë , ndër të cilët ai lindor është i shkurtër . Pjesa qëndrore me kupolë ndahet nga pjesët anësore nëpërmjet arkadave treshe dykatëshe , duke u theksuar në këtë mënyrë si vëllim qëndror i naosit . Kupola mbështetet mbi harqet mbajtëse që ngrihen mbi katër pilastra masive në këndet e këtij vëllimi qendror . Këto pilastra, në anën lindore, shërbejnë për të formuar ambientin e altarit , ndërsa në anën perëndimore për të veçuar si ekzonarteks krahun perëndimor të kryqit dhe ambiente këndore . Takohen dy raste të përdorimit të tullave në tërë lartësinë , Shën Mëhilli në Berat , ku klausonazhi fillon që nga niveli i tokës dhe Shën Mëria në Labovën e Kryqit , ku pjesa e poshtme ndërtohet me gurë dhe tulla , ndërsa pjesën e sipërme vetëm me tulla. (Fig.2)

Në Shqipëri ka kisha mjaft të arritura me kupola të vogla (Mborje, Shën Mëhilli në Berat) e deri te strukturat hapësinore mjaft komplekse si në Mesopotam , Labovë e Kryqit , ku gjithshka reduktohet në një system mbulesash të harkuara që mbështeten në shtylla dhe pilastra në mure , duke zvogëluar në minimum trashësinë e këtyre të fundit . Në të dy shembujt e fundit zgjidhjet ishin jo vetëm origjinale por edhe të guximshme . Ka monumente në vendin ku hapësira e brendëshme është karakteristike për arkitekturën bizantine dhe kjo është arritur si në kishat me karakter intim si në Mborje dhe në Berat ashtu edhe në ato kur e madhërishmja është krejtësisht e arritur , në Mesopotam dhe në Labovën e Kryqit . (Nga Historia e Arkitekturës Shqiptare (maket), Tiranë 1979).

Faltorja më e vjetër dhe më e nderuar e krahinës është Kisha historike (Lindja e Hyrelindses) në Labovën e Sipërme . E ndërtoi sipas legjendës,

perandori Justinjan (527-565) dhe e pasuroi me një copë Druri të Shenjtë . Këtë legjendë e zë me gojë "Kronika e Driopidës" (Bot. Ath. Petridhi, 1871, f. 18 ), e cila shkruan sa më poshtë ;

...Dhe deri dje në Justinianitin e Madh këto vende faleshin , por jo larg në mbretërinë e Konstandinit . Atëherë u nisën dhe vajtën tek i madhi JUSTINIAN I dymbëdhjetë Drinopojas dhe dymbëdhjetë Kaonas , burra të zgjedhur , të habitshëm , trupmëdhenj dhe të urtë , dhe kur pa ato mbreti (perandori) u gëzua jashtë mase për bukurinë , mendjen dhe masat e buta të tyre , dhe fill pas tre ditëve iu dha grada të ndodhen pranë tij . Ndërsa tek vendi i tyre dërgoi të parin mbajtës të tij të shpatës , si vëzhgues dhe qeverisës në gjithë ato vende Aidhonisë , Finiqisë , Himarës dhe deri në Vlorë dhe Bellgradë (psh: përmendet Berati) dhe në kohë u paqësuan vendet siç deshën .

Me vdekjen e kryekordhëtarit Aleksandër, u bë qeveritar në vendin e tij Konstandin Drinopoliti nga Labova, i cili me investim mbretëror (perandorak) ndërtoi në atë vend një kishë, Lindjen e Tërëshenjtëruarës Hyrëlindëses të bukur dhe të habitshëm , siç dëshironte . Ai vend përmbante 910 shtëpi dhe burrat ishin të denjë dhe të bukur të gatshëm në përgjigje , ndaj e bënë atë vend të jetë Stavropojë (të varur direkt nga Patriku Ikumenik) autodespotike , që të jenë gjithmonë gati në shërbimet mbretërore (perandorake) ... . Për kishën mbreti (perandori) fali 20 pendë dhe dy mullinj (për bujqësi) , të cilat do të shërbenin për jetën e dymbëdhjetë priftërinjve , fali Drurin e Shenjtë . Përshkrimin e shkruar të kishës e ka dhënë dhe profesori epiratos Dh. Evangjelidhis në revistën "Neos Elinomnimos" , vol. 10 (1913) . Më vonë botoi një studim të imët për arkitekturën e kishes Fr. Versaqi në gazetën arkeologjike të 1916, f. 108. P. Pulica kopjoi dhe botoi mbishkrimin , i cili është shkruar me gërma të mëdha rreth e rrotull në bazën e Trullos (kubesë) (shiko "Shoqata e Mirëmbajtjes së Studimeve Bizantine" nr. V (1928) faqe 64 . Është më e re e vitit 1806 dhe me shumë gabime:

+ VITI 55A (=551) INVESTIM I JUSTINIT TË MADH MBRETI (T) MBI DAROVËN E EPITROPIT KOSTANDIN LABOVITI TË ATIJ VENDI +U NDËRTUA E NDËRTUAR (A) DHE HYJNORJA KISHE (I HYRËLINDËSES SË MBISHENJËSTRUAR DHE) VIRGJERËSHES MARI, 1806 MARS ... QIELLIN QË MBI JU TË DËSHIRUARIT U FORCUAN, ZOT, KISHËN NDËRTUAT DHE FITUAT ME GJAKUN TUAJ TË NDERSHËM .

Në bërthamën fillestare të kishës së vjetër janë shtuar ndërtime të ndryshme në kohë të ndryshme. Ndërtesa e vjetër qëndrore e Kishës Kryesore na jep në prerje një brinjë gjatësie 12.30 . Në qendrën e katrorit ngrihet një truall i madh në qemer . Lartësia e brendëshme nga sheshi deri në majë të trullallit është 16.20m . Pamja e jashtme e kishës, ndërtimi, muret, dritaret harkore, sprethi, baxhatë, trulli janë të zbukuruar artistikisht me qeramoplastikë. Kjo kishë sipas burimeve i përket shekullit VI, periudhës së Justinianit të madh. Justiniani sundoi gjatë viteve 527-563. Ishte administrator i madh, legjislator, 'rivendosës' i perandorisë, jo vetëm në kufijtë e saj lindorë , por në shkallë më të gjërë dhe në dinastinë e mëparshme të Teodosit. I ungji , perandori Justini i Parë , sipas të dhenave ishte fshatar ilir , analfabet që u ngrit në shërbimin ushtarak dhe ishte pranuar si perandor nga ushtria. Ai mori si bashkësundimtar Justinianin, i cili ndryshe nga Justini, mori arsim te përsosur romako-bizantin.( V.F.Semjonov, Historia e Mesjetës , Tiranë , faqe 78). Në kishën e Labovës , në muret e fasadës së saj, ndërmjet gurëve janë futur tulla vertikale, teknikë kjo që nuk haset në kryeqytet, ku përdoret muratura thjeshtë me tulla ose në muraturën prej tulle ndërfuten breza të gjerë me gurë të punuar. Por kjo muraturë përdoret në Ballkan, provincë e arkitekturës kishtare bizantine, të cilën nëse e kundrojmë nga kryeqyteti, ku prej tij zhvillohet klausonazhi të cilin duke nisur nga periudha e mesme bizantine e

DO NOT COPY

gjejmë në ballkanin jugor domethënë në truallin e Greqisë dhe Shqipërisë jugore . Por kjo teknikë në Kishën e Labovës nuk është aq e rregullt si në kishën e Panajasë në Hosias Llukas të ndërtuar rreth vitit 975 . Për artin e të ndërtuarit në Despotatin e Epirit kemi një përfytyrim mjaft të mirë , meqenëse nga kjo kohë ruhet një numër mjaft i madh kishash . Labova shkëputet krejtësisht prej tyre , ndërsa Kisha e Mesopotamit qëndron në lidhje të ngushtë me to. Kisha e Shën Mërisë në Labovë nuk të krijon kurrësesi përshtypjen e një krijimi provincjal . Dekori i jashtëm i Kishës së Labovës veçanërisht në krahët e kryqit është jashtëzakonisht i pasur , pa asnjë paralele . Kjo sjell vështirësi më të mëdha për përcaktimin kohor (GUTRAM KOCH, "Disa mendime për Kishën e Labovës së kryqit" , MONUMENTET nr. 1/1987, Tiranë ) .

Piktura murale shfaq probleme degradimi dhe mbivëniesh me gëlqere. Kjo duket qartë në apsidë në skenën e Panagisë së Madhe e tipit Platitera, te piktura në krahun jugor ku kemi Odigitrian "udhëheqësen", dhe dy medalione të mbuluar me gëlqere, si dhe në pikturën madhështore të kubesë së Kishës. Lidhja e intonakos (shtresa ku është realizuar piktura) me suportin mbajtës (murin) paraqet xhepa dhe boshllëqe. Ato kanë ardhur dhe nga çedimet e mëvonëshme të kubesë . Këto boshllëqe të shumta ndikojnë në shkëputjen e mëvonëshme të pikturës nga muri mbajtës, si dhe rënien e saj si pasojë e lagështirës së brendshme në ajër.

Në një zonë të madhe të skenës Platitera kemi rënie të ngjyrës. Kjo për arsye dhe të lidhjes jo shumë të mirë të pigmenteve me arricion, por sidomos si rezultat i pranisë së gjatë të lagështisë së ajrit në interierin e kishës. Rënia e pelikulit të ngjyrës me kalimin e kohës do të bëhet një problem mjaft shqetësues, gjë që çon në humbjen e vetë pikturës dhe të çdo hipoteze të plotë për të. Kjo ka ardhur si pasojë e lagështisë së ajrit të brendshëm të kishës, që tani pas një ndërhyrje konservuese të mëparshme paraqitet në gjendje më të mirë.

Prania e kripërave duket qartë gati në të gjithë pikturën murale të kësaj kishe. Ajo ka krijuar velatura në gri , gjë e cila ndikon në moskuptimin e qartë të imazhit ikonografik si dhe në degradimin e mëtejshëm të pelikulit të ngjyrës , ku pigmente të veçanta mund të shfaqin ndryshime në përmbajtjen e tyre. Më parë lagështia e brendshme e ajrit ka stimuluar mjaft praninë e kripërave në pikturë. Kripërat kanë lënë mjaft gjurmë në të gjithë pjesën e sipërme të pikturës duke na paraqitur një velaturë pak sa të bardhë, e cila vështirëson dukjen e plotë të imazhit të pikturuar.

Në të gjitha faqet shohim mungesa të pjesëshme të afreskut të pikturuar të cilat duhet ti nënshtrohen disa rregullave teknike më solide dhe ndërhyrjeve me specifike. Prania e llaçit në disa vende duhet zëvendësuar me rërë smërçi të përzier me gëlqere të stazhionuar mirë.

Një fenomen tjetër shqetësues është dhe prania e madhe e lyerjeve me gëlqere. Prani të gëlqeres dhe të lyerjeve të tjera kemi në shumë pjesë të pikturës. Pas sondazheve të kryera vite me parë ka dalë në pah ekzistenca e pikturës murale në apsidë, niket anësore , mafil, narteks dhe në kolonat e naosit.

Duke analizuar këtë problematikë komplekse në sektorin e artit monumental në IMK u krye një konsultë e gjërë me të gjithë specialistet dhe restauratorët. Në këtë konsultë u vendos hartimi i një projekti konservues-restaurues dhe për këtë u ngarkuan specialistët e sektorit të artit, pra dy artikullshkruesit. Hartimi i këtij porjekti u realizua në bazë të informacioneve të marra duke parë gjëndjen e pikturës murale në vend, duke vjelë të dhëna historike nga banorë të fshatit e studiues si dhe duke kryer të plotë dokumentacionin grafik e fotografik. Projekti u miratua më parë në sektorin e artit dhe me pas edhe në K.K.R. Ndërhyrjet që parashikoheshin në projekt konsistonin në konsolidimin e sipërfaqes së pikturës, çlirimin e

DO NOT COPY

DO NOT COPY

saj nga gëlqerja si dhe pastrimin, stukimin dhe integrimin piktorik. Punimet u kryen gjatë muajve gusht-shtator 2004, në bashkëpunim edhe me drejtorinë rajonale në Gjirokastër. Ato u shtrinë në të gjithë sipërfaqen e pikurës të kishës, në kolona, harqe por kryesisht u përqëndruan në narteks dhe në mafil. (faqen perëndimore të tij) ku u arrit të zbulohet një skenë mjaft e bukur, e plotë dhe e rëndësishme. Skena titullohet "Deisis" (Fig 3,4). Në mes të saj paraqitet "Krishti Pantokrator" në të djathtë "Shën Mëria" dhe majtas "Joan Pagëzori". Në fillim të punës u procedua me kryerjen e konsolidimeve të sipërfaqes së pikturës. Ky konsolidim u shtri në të gjithë sipërfaqen e pikturës pasi në një pjesë të konsiderueshme kishte xhepa dhe shkëputje të afreskut me suportin mbajtës. Për të kryer këtë procesi u përdoren dy mënyra. E para duke injektuar me anë të shiringave Ledan B72 dhe Akril 33. E dyta u përdor teknika e qepjes me fije plastike. Pasi afresku u konsolidua filloi puna për çlirimin e sipërfaqes së pikturës nga gëlqerja. Teknika që u përdor ishte ajo e heqjes së gëlqeres me bisturi, pasi sipërfaqja e pikturës ishte mjaft e lidhur me gëlqeren dhe procesi i pastrimit ishte mjaftë i vështirë dhe delikat. Që ky proces të përfundonte me sukses dhe pastrimi të bëhej pa dëmtuar pikturën shtresa e gëlqeres zbutej para ndërhyrjes me bisturi duke përdorur impako me arboçel (Fig 5). Vende – vende gëlqeren e zbutëm dhe me një përzierje uji të distiluar e alkooli ku morëm rezultatet e pritshme. Pas heqjes së gëlqeres u krye pastrami i gjithë sipërfaqes të çliruar nga gëlqerja me ujë amoniakal dhe Wishab. Më pas u bënë stukimet dhe bordurimet në zonat e dëmtuara që prishnin paraqitjen estetike të pikturës. (Fig 6). Në fund u krye integrimi piktorik me akuarel sipas seleksionit kromatik. Me të njëjtat teknika u ndërhy dhe në zonën e narteksit (ana veriore) ku u çlirua edhe aty një siperfaqe e konsiderueshme pikture. (Fig 7.)

Në skenen "Deisis" figura e Krishtit paraqitet më e plotë dhe e pastër (fig 8) kurse ajo e Shën Mërise në një imazh më të dobët (fig 9). Figura e Joan Pagëzorit paraqitet në nje gjendje më të dëmtuar kryesisht në portret. Skena "Deisis" është një nga skenat më të vjetra në ikonografinë bizantine. Ajo paraqet momentin më të rëndësishëm të tre personazheve kryesorë. Kjo pasi paraqet figurën e "Krishtit" si biri i Perëndisë dhe në të djathtë të tij "Shën Mërinë". Në të majtë të tij paraqet dishepullin "Joan Pagëzorin" duke kompletuar kompozimin me këto tre personazhe biblike. Figura e "Krishtit" ndodhet në qendër të kompozimit, sepse përfaqëson ideologjinë e tij dhe humanizmin që e karakterizon. Në portretin e tij mishërohen tiparet ikonografike dhe fizionomia e portretit. Në artin bizantin pak përjashtime gjen nga imazhet ikonografike sidomos të përfytyrimit të Krishtit. Imazhi i mrekullueshëm i këtij Krishti na paraqitet jo si një portret me forma astetike por të një njeriu që e tremb jeta e përjetshme, ku sytë nga të përvuajtur janë të ftohtë e disi të habitur. Buzët të holla e të vogla por jo aq të shtrënguara. Fytyra në tërësi nuk i ngjan një trekëndëshi të kthyer përmbys por është e plotë dhe mjekrra burrërrore. Megjithëse flokët dhe aureola e artë janë tipike të atij imazhi kanonik që njihet, ky Krisht ka një pamje mjaft njerëzore (Fig. 10). Piktori me mjeshtëri artistike dhe me penelata të shkathëta i ka dhënë freskinë kësaj skene, me dritëhijen e butë pa kontraste të forta grafike duke transmetuar një ngrohtësi piktorike. Me të njëjtin ekzekutim është realizuar edhe figura e Shën Mërisë dhe ajo e Joan Pagëzorit. E kaltërta që mbizotëron në sfond jo vetëm që përfaqeson ngjyrën e qiellit por piktori e shpërndan atë dhe në dritehijet e drapërive duke krijuar kështu një unitet artistik. Nëpërmjet sfondit paksa të errët krijohet ndriçimi i aureolës përreth Krishtit duke dhënë mesazhin e ndriçimit që buron nga shpirti i tij. Figura e Joanit pak e mënjanuar tregon tipin e pavarur, pasi ai ishte i pari që predikoi ardhjen e Krishtit. Skena "Deisis" duke qenë një nga skenat e para të ikonografisë është paraqitur për herë të

parë në kishën e Shën Sofisë në Kostandinopojë por në teknikën e mozaikut. Kjo skenë në Shën Sofi është monumentale sepse sipërfaqet e arkitekturës alternohen me figurat monumentale të personazheve. Figurat e veçuara larg njëra-tjetrës nuk dëmtojnë anën kompozicionale përkundrazi krijojnë afrimitet midis tyre.

"Deisisi" i Labovës së Kryqit në krahasim me shumë skena të tjera si ajo dhe në krahasim në tërësi me tipologjinë bizantine është interpretuar me një stil të lirë piktorik. Tonalitetet janë më të buta pa kontraste të thella e cila bën që portreti i mrekullueshëm i Krishtit të jetë më njerëzor dhe në harmoni me figurat e tjera të skenës. Nga i gjithë ky rezultat analitik në mendojmë se skena "Deisis" i përket periudhës pasbizantine.

Zbulimi i kësaj skene të mrekullueshme të jep të drejtën të mendosh që vazhdimi i çlirimit të sipërfaqes së pikturës nga gëlqerja mund të sjellë befasinë e skenave të reja duke kompletuar kishën e "Shën Merisë" në Labovën e Kryqit me gjithë madhështinë monumentale të saj, gjithashtu duke përfituar një objekt arti dinjitoz për turizmin kulturor.

*Fig. 1*



DO NOT COPY

DO NOT COPY



*Fig. 2*



*Fig. 3*



Fig. 4



Fig. 5

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9



Fig. 10

DO NOT COPY

## Summary

There are a lot of pictures at the Labov's church. A part of them are demaged from environmental causes and from the peoples careless. For a long time a part of them were damaged a lot.

Resenthy, the church has been fixed, restard from I.M.K. A group of speciality of art sector worced for a long time for this project. Menachile working they discovered a picture of CHESUS. It's an interesting. The are CHESUS was hideal at this church. Before restoring it they prepareid the ecuipments that they needed.

DO NOT COPY

Mustafa ARAPI

# Restaurimi i pikturës murale Të realizuar nga Onufër Qiprioti dhe Alivizi Foka, në kishën shën mëria në fshatin Vrahogoranxi

Kisha e Shën Mërisë në fshatin vrahogoranxi është e tipit bazilikal i përbërë prej tre nefësh (foto 1). Nefi qendror është përbërë nga tavani në formë të



*Foto 1*

harkuar. Ndërmjet kollonave të para dhe të dyta, ndërmjet kalotave në formë trëkëndëshi, ngrihet tamburi në formë të rregullt rrëthore duke u mbyllur me kupolën në gjysmërrethore, kurse kollonat e dyta me të tretat mbajnë tavanin, duke u lidhur me faqen perëndimore e duke luajtur rolin e kornizës së skenës "Fjetja e Shën Mërisë". Ndërtesa ka një shtrirje gjatësore duke u theksuar më shumë me narteksin. Hyrja nga brenda për në kishë nëpërmjet derës së vogël, të imponon një përkulje pak sa të lehtë. Pasi hyn në naos papritmas të shfaqet




*Skica 1*

një madheshti, gjë e cila nuk mund të përfytyrohet nga jashtë. Nga kupola qëndrore deri në dysheme ka një lartësi rreth 15m. Harqet mbi të cilat

DO NOT COPY

mbahet kupola në pjesën qëndrore të narteksit, mbështeten direkt në mur. Nefi qëndror është i dallueshëm nga të tjerët jo vetëm nga kupola që e kurorëzon, por edhe se është më i gjerë, më i lartë dhe me tavan në formë qemeri si në naos e në kungë, ndërsa në narteks ai merr formën e kupolës. Nefet anësore janë më të ngushta dhe më të ulët dhe me tavan në trajtë çerek harku. Për ndarjen e njërit nef nga tjetri, mjeshtri ka përdorur vargun e harqeve të lartë, harkadën që përfundon poshtë te shtylla në murin kundrejt. Shtylla të tilla ndarëse e mbajtëse në të njëjtën kohë në narteks fillimisht nuk duhet të ketë pasur.. Shtyllat ekzistuese prej muri së bashku me kollonën e ngurtë, duhet të jenë shtuar harkut djathtas si mbështetje plotësuese pas dëmtimit që mund të ketë pësuar monumenti ndoshta nga rënia e ndonjë termeti (skica 1).

Kisha është ndërtuar në çerekun e parë të shekullit të 17. Të dhëna të sakta për këtë jep mbishkrimi i gjendur mbi derën e faqes perëndimore të naosit e cila tregon se kjo kishë i dedikohet Hyjëlindjes dhe gjithmon Virgjëreshës, me mendimet dhe shpenzimet e Onufër Qiprioti dhe Alivizit më 16221). Kjo shpreh qartë se autorët e zbukurimit të gjithë interierit janë piktorët e sipërpërmendur. Onufër Qiprioti është piktor ikonograf i njohur për krijimtarinë e tij, kurse i dyti Alivizi, deri tani nuk e ndeshim në ndonjë objekt tjetër ikonografik.

Afresku është realizuar në teknikën bizantine dhe i mbështetur mbi suport muri me një trashësi që arrin deri në 70 cm. Suvaja (arriccio), e cila arrin deri në 2 cm, është e përbërë prej gëlqerje e lidhur me kashtë të stazhionuar. Pas kësaj, shtresa e intonakos me trashësi prej 0.2 Mm përbëhet po nga gëlqere, ku sipërfaqja e lëmuar e saj ka ndihmuar në realizimin e pikturës.

Sipërfaqet e mureve në përgjithësi janë të onduluara. Nuk është ruajtur sipërfaqja e rrafshtë si dhe konture të drejta. Kjo sipërfaqe e onduluar krijon një gjendje të ngrohtë përsa i takon vizionit estetik. Valëzimi i pikturës në vetvete luan rolin e krijimit të thellësive të planeve si dhe krijimin e lëvizjeve dhe të marrëdhënieve hapësinore të brendshme pikturore.

Afresku mbulon të gjitha faqet e mureve të interierit, të tamburit, kupolën, kalotat, tavanin, harqet ndërmjet kolonave që ndajnë nefet, faqen jugore, veriore, lindore si dhe të gjithë faqet e narteksit së bashku me tavanin. Interieri i kishës krijon një gjendje emocionale nga marrëdheniet e drejta dhe dinamike të tyre midis volumeve e harqeve të zbërthyera drejt në marrëdhënie më hapësirën



Skica 2



Skica 3



*Skica 4*

të pikturës murale (Onufër Qiprioti) botuar në revistën "monumentet" 2004

### 1.Ekzaminimi arkeologjik dhe kritik

Në këtë ekzaminim kishim si pikësynim të gjenim se çfarë konsistonte saktësisht në vepër. Për të saktësuar se çfarë është ajo aktualisht, zanafilla e saj dhe ndryshimet e bëra gjatë historisë. Studimi arkeologjik dhe kritik ju drejtua të gjitha metodave të përshtashme për arkeologjinë, historinë dhe kritikën e artit. Ky studim u mbështet në literaturat



*Skica 5*

në përgjithësi (skica 2, 3, 4, 5, 6, 7.
Projekti dhe restaurimi u mbështet në studimin dhe ekzaminimin shkencor në të gjithë objektin dhe në veçanti të pikturës murale.

Në studimin historik u synua në vlerat artistike dhe fetare, në analizat tipologjike dhe të programit ikonografik të saj.Gjatë këtij studimi një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe monografia kushtuar këtij autori

PROTOKOLL

DO NOT COPY

e vëçanta, arkivat, dokumëntet grafike etj.

Çështjët kryesore përzgjidhje u ndanë në tre tipe:

1. Rindërtimi ideal i veprës fillestare.

2. Kronologjia e veprës dhe identifikimi i mbivënieve ose të shndërrimeve që ka pësuar gjatë historisë

3. Zgjidhja për gjendjen në të cilën vepra duhej të rikthehej me anë të trajtimit konservuese.

Ekzaminimi vuri në dukje të gjitha gjurmët e elementëve të zhdukura si për shembull nga prishjet e pësuara, nga ngjyra për shkak të ndryshimeve kimike osë fiziologjikë, nga ritokimët me ngjyrë ose me llaç etj, si dhe prishjet e shkaktuara nga restaurimet e mëparshme. Të



*Skica 6*




*Skica 7*

gjitha këto të dhëna materiale plotësuan në interpretimin kritik në funksion të tërësisë në të cilën bën pjesë piktura, kur muri i pikturuar kishte njohur më shumë zbukurime të njëpasnjëshme dhe shndërrime kuptimplote gjatë historisë. Jemi munduar të përcaktonim kronologjinë në funksion të tërësisë dhe brenda mundësive të rimëkëmbim në mënyrë ideale çdo fazë të dëshmuar e cila do të bëhej me anë të metodave të sondazhit dhe të stratigrafisë.

- Përcaktimi i gjendjes udhëzuese për trajtim.

Mbasi patëm të gjitha informatat paraprake përcaktuam

politikën e trajtimeve nga pikëpamja e interpretimit kritik.

## 2. Ekzaminimi fizik e teknologjik

Nëpërmjet ekzaminit fizik e teknologjik përcaktuam pjesët e strukturës së monumentit, të ndryshimeve që kishte pësuar në kohë si dhe të ndryshimeve që ishin modifikuar me qëllim nga njerëzit, trasformimeve, prishjeve etj, në percaktimin e degradimeve. Duke kërkuar origjinën e proceseve degraduese, prej pasojave dhe së fundi duke bërë diagnostifikimin e shkaqeve si dhe në ekzaminimin teknologjik, gjithashtu duke parë dhe zanafillën e proceseve të dëmtimeve që kishte pësuar monumenti. Gjithashtu duke përshkruar dhe kronologjinë e shfaqjieve të prishjeve. Ky ekzaminim u bë në dy nivele, me sy ose me vegla të thjeshta (skica 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18.



*Skica 8*



*Skica 9*

- Ekzaminimi në laborator i të dhenave karakteristike
- Skema e ekzaminimit sistematik

Për përcaktimin e teknikave dhe të materialeve të përdorura, si për ato të ndryshimeve dhe të shkaqeve të tyre u verifikuan sistematikisht që nga suporti deri në shtresën pikturale duke përfshirë dhe mjedisin klimatik.Ekzaminimi i plotë na çoi në këto pika:

1- Mbajtësi

A- natyra, përbërja, struktura e mbajtësit.

B- gjendja e ruajtjes,

DO NOT COPY



Skica 10

qëndrushmëria (problemi i lagështisë)si p.Sh

- Lagështi e kapilaritetit (tokë e lagur e ftohtë, gur i murit poroz ose jo)

- Lagështi kondensimi (në këtë rast mbulimi me një perde të bardhe të shndritshme kripërash që shfaqen në ndertimet e nëndheshme në anën veriore)

-Lagështi infiltrimi që kishte të bëntë mbi zbulimin dhe eksopozimin e mureve të hapur me shiun

2- Arriccio- intonako

A- natyra, përbërje, struktura

B- gjendja e ruajtjes, identifikimi i prishjeve dhe i ndryshimëvë

3- Shtrati piktural

A-identifikimi i materialeve përbërës dhe i teknikave të përdorura, marrja e mostrave të zgjedhura me arsyë lidhur me ekzaminim laboratorik.

B-gjendja e konservimit

C- përcaktimi i shkaqeve

4.Identifikimi i teknikave

Ndërhyrjet konservese – restauruese në kishën e "shën mërisë" në fshatin vrahogoranxi ishin një domosdoshmëri dhe tepër urgjente.Ky ekzaminim konsistoi në tre aspekte kryesorë:

1. Studimi i natyrës dhe i përbërjes së materialeve të afreskut si suporti ,arricio,intonako dhe ngjyra,pra në njohjen e lëndëve të para që formorjnë këto elementë në tërsi ose në pjesët e saja dhe si rezultatet në njohjen e teknikës me të cilën është realizuar vepra.

2. Datimi dhe dedikimi i veprës së artit në raport me natyrën, në cilësinë dhe sasinë e për-



Skica 11

DO NOT COPY

DO NOT COPY

bërësave të saj dhe në raport me teknikën e përgatitjes së saj

3. Përcaktimi i vërtetësisë në falsifikimin e veprës, nga raporti i natyrës së përbërësave të saj dhe në teknikën e përdorur për realizimin e pikturës.

4. Ekzaminimi u bazua në disa pika aksionometrike themelore dhe çdo qëndrim analitik na dha një gjykim absolut mbi natyrën, përbërjën dhe strukturën. Ky gjykim lindi nga përpunimi racional i të dhënave analitike si p.Sh: analizat mikroskopike të fragmenteve dhe të seksioneve, aplikimi i rrezeve të padukshme ultraviolet, të cilat na lejuan të marrim të dhëna analitike të rëndësishme mbi natyrën e ekzaminimit spektografik (ekzaminimit të spektrit), karakteristike për çdo element, ku morëm spektogramat që lëjuan të përcaktoheshin përbërësit e një substance minerale të çdo pigmenti (skica nr 17, 18, 19, 20).



*Skica 12*



*Skica 13*

Dokumentacioni fotografik

Aplikimi i fotografisë qoftë me makro ose mikrografi (fotomikrografi), pati një rëndësi të madhe për analizat, duke plotësuar një dokumentacion stabël të rezultateve, qoftë në ekzaminimin mikroskopik direkt, qoftë në ekzaminimin e fragmenteve dhe të seksioneve (prerjeve), qoftë për analizën mikrokimike dhe reaksionet që rrjedhin. Aplikimin e fotografisë e përdorëm si mjet direkt ekza-

DO NOT COPY



*Skica 14*

minues, meqë imazhi fotografik në kushte të ndryshme të ndriçimit dhe të zmadhimit, na lejoj që të shihnim detajet që shpëtojnë gjatë vështrimit direkt. Dokumentacioni fotografik u aplikua në të gjitha sipërfaqet e afreskut.

Me anë të ndriçimit tangent dhe përballë u evidëntua gjendja e afreskut si deformimët, xhepat, fugat, boshllëqet, zhvendosjet e volumeve, gjendjen ë kripëzimit nga lagështia, shkallën e saj të lëmuar ose më rrudha, struktura e krisjeve, shtrirja ë llaçit, trashësia e ngjyravë, bashkimi i puntatave dhe i xhornatave, rëniet, plasaritjet, pluhurzimi i shtratit të pikturës, formimi i afreskave në formë guackash gjë që trëgoi për lyerjen dhe tharjën e një lidhesi në pikturat aseko.

Me ndriçimin anësor, më realizimin e fotove u pasqyrua dhe natyra e dëmtimeve, relievin dhe ondulacionin e shtresavë që nxorrëm, (fjala është për mbivënie të ngjyrës dhe llaçërave të rëja mbi pikturën e vjëtër), gjithashtu u fotografua prerjet mikroskopike. Nga kjo proçedurë krijuam një njohuri më të madhe të natyrës së dëmtuar, ndërtimin dhe formën e elementëvë shkatërrues të elementit kryesor siç është piktura osë grundi, gjithashtu në realizimin fotomakro u pasqyruan më së miri dëmtimet si dhe elementët e keqpërdorur nga artisti .

-Dokumentacioni grafik

Në dokumentazionin grafik u fiksua gjendja




*Skica 15*

e pikturës si dhe në marrëdhenie me arkitekturën (suportin) të pasqyruar në vizatim ,skica,ku në të cilat u riprodhua në një gradë të caktuar.Ky dokumentacion fiksoi dhe ndërhyrjet restauruese që u bënë dhe u paraqitën në mënyrë konkrete pothuajse dhe ndërhyrjen me solucione në strukturën e elementëve përbërës të kësaj vepre. Në këtë proçes u përdorën dhe zmadhime me shkallë më të mëdha të natyrës së dëmtimeve dhe të gjendjes së përgjithmshme të afreskut gjë e cila shërbëu para,gjatë dhe pas restaurimit.Ky ëkzaminim nuk u bë për qëllime në vëtëvëtë .Ai paraqiti në tërësi një ansambël të dhënash ku përpunimi favorizoi bazën e një bashkëpunimi në një aspekt të specializuar nga pikëpamja artistike.



*Skica 16*

Gjykimi final ishte rezultat i këtij bashkëpunimi i cili na shoqëroi gjatë punës normale restauruese ë konservuese.

Njëkohësisht kërkuam dhe zbuluam në detaj sa më komplet gjithë elementët, që përbënin veprën dhe që mund të grupoheshin në dy grupe me natyra të ndryshme si p.Sh elementët artistikë dhe elementët material. Elementët artistikë,që në rastin tonë ishin faktura, stili, kaligrafia ,pastozitëti,incizimi,i gjykuam në mënyrën me të cilën materialet përbërës ishin vendosur e grupuar e sistemuar(rregulluar)etj.,Dmth.Strukturën intime të veprës dhe procesin që paraqet realizimin e tij ose të teeknikës së përgatitjes së saj. Ky qëndrim ishte i rëndësishëm për ne sepse nga ky bashkëpunim ose mpiksjen e këtyre grupeve të elementëve, d.m.th të dhenat shkencore artistike, na udhëhoqën në një rrugë konservuese e restauruese të qartë analitike, racionale e të kujdesshme. Kjo na mundësoi për njohjen e lëndëve, kushteve ku ka jetuar afresku,gjithashtu për njohjen e faktorëve të ambjentit dhe influencën mbi këtë vepër arti, si tymërat, pluhurat, lagështia, mikro-organizmat etj.

Nëpërmjet ekzaminit fizik e teknologjik, duke përfshirë këtu edhe përcaktimin e pjesëve të strukturës e të ndryshimeve të ambientit,të ndryshimeve që kanë ardhur deri në kohën tonë, dhe të ndryshimeve të bëra nga njerëzit,si p.Sh mbivëniet si dhe duke kërkuar origjinën e proceseve degraduese e shkaqet e tjera. Për studimin e teknikës së ekzekutimit, përdorëm ekzaminim me sy,me lupë, e me dritë tangente. Me këtë të fundit u rilevua struktura e sipërfaqes, e krisjeve, e të krakëlyrave, pastoziteti, mënyra e incizimit,vrojtimi i xhiornatave. Po kështu vrojtuam e rilevuam me sy dhe me lupe boshllëqet e sipërfaqeve ,floreshencat, aderencat e shtratin piktural dhe të

DO NOT COPY

DO NOT COPY




*Skica 17*

gjendjes së sipërfaqes në përgjithësi ,dhe kjo me dritë tangente, pluhrëzimi me anë të të prekurit, ndërsa përcaktimi i zonave të aderencës dhe të kohezionit të suvasë, u bënë në mënyrën e përftimit të akustikës ( duke e goditur me gisht) ku ajo të na jap një tingull bosh të përcaktuar edhe në bazë të kësaj, u përcaktua gjendja ,humbja e lidhjes me suportin e murit si dhe lokalizimin e këtyre xhepave( boshllëqeve).

-Ekzaminimi i shkaqeve

-Dëmtimi i afreskave nga lagështia

Dëmtimet që i atribohen këtij faktori,janë të shumtë, të cilët në llojet e tyre me origjinë të ndryshme, kishin sjellë një dëmtim zinxhir të el-




*Skica 18*

DO NOT COPY




*Skica 19*

ementëve konstruktivë,elementëve përbërës si dhe të pikturës. Duke analizuar e studiuar afreskun qysh nga krijimi deri në ditët tona, kanë qenë prezent dhe kanë qenë faktor determinues dhe shkatërrues,pothuaj se të gjitha llojet e lagështisë si ajo e kapilaritetit, infiltrimit si dhe ajo e kondensimit.Afreskat kishin pësuar veç prishjeve, për shkak të shtegtimit dhe të kristalizimit të kripërave të tretshme, një prishje kimike për shkak të veprimit të kombinuar të ujit dhe të anidritit karbonik të ajrit mbi karbonatin e kalçiumit (skica nr 15,16,17,18).

Lagështia e dëpërtimit

Lagështia e depërtimit apo e kullimit ka qenë e pranishme në kishën e vrahogoranxisë. Kjo lloj lagështië ka vepruar kryesisht para kohës së




*Skica 20*

ndërhyrjeve që janë bërë në (tambur, kupole, çati) etj. Depërtimi ishte shkaktuar gjatë çarjeve të brendshme dhe të tejpërtejme të mureve sidomos në tavane.

*- Lagështia e kapilaritetit*

Kjo lagështi u vu re në themelet e mureve dhe në kombinim me mungësën e ventilacionit solli ngjitjen e lagështisë deri ne 3 m lartësi. Në disa zona kishte humbje të aderencës.

*- Lagështia e kondensimit*

Lagështia e kondensimit mbetet një shkaktar kryesor. Këtë e tregonin njollat e bardha të shndritshme kripërash të kalciumit.

Lagështitë e ndryshme që shkaktohën nga prania ë materialëve hidroskopik si psh. Guri smerc solli dëmtimin e afreskut dukë krijuar kripëra të llojeve të ndryshme si ato të karbonatit të kalçiumit dhe të sulfatit të kalciumit në formë vëllojë.

*- Dëmtime nga mikroklima*

Duke bërë një vëzhgim të saktë me anën e aparatëvë matës të tëmperaturës,rëzultoi se temperatura në ambjentet e kishës karaktërizohëj nga oshilacione sidomos në ndryshimin e stinëve. Afresku i është nënshtruar kontraksionevë të ndryshme e të fuqishme të materialit mbajtës (suportit) dhe si rezultat i këtyrë qenë krijuar krakelyra (plasaritjë të grundit dhe të shtratit piktural)

*- Dëmtime mikrobiologjike në afreska*

Përveç ndryshimeve fiziko-kimike që vijnë nga një atmosferë jo e përshtatshme, ato mund të dëmtohen seriozisht nga organizmat biologjik. Gjatë vrojtimit të afreskave, njëkohësisht duke pasur parasysh lagështinë e dikurshme si dhe atë ekzistuese, u vu re në shumë zona si p.sh, në brezin e poshtëm të faqeve jugore e veriore si dhe në apside kishte patur veprime të mikroorganizmave të cilat patën sjellë dëmtime në pikturë. Aktiviteti i tyre si p.sh autropiheks (algat, likenet, streptomicina) i kishin dhënë pikturës një gamë apo filtër në ngjyrë jeshile të lehtë dhe të përhapura kudo. Nga prezenca e zgjatur ato kishin dobësuar shtratin e ngjyrës.

Edhe sulmi i baktereve kishte sjellë ndryshime në humbjen e ngjyrës origjinale. Në qemeret dhe harqet, apside, faqe jugore ë veriore, u vunë re ndryshimet e ngjyrës dhe pamjes.

*- Dëmtime nga lëvizjet, tërmetet*

Një faktor tjetër që kishte sjellë dëmtime të mëdha të afreskut, ishin lëvizjet konstruktive të shkaktuara nga lëkundjet sizmike, tërmetet. Nga ky vrojtim u vu re, se dëmtime të kësaj natyre ndodhin kryesisht në harqet e mëdha që lidhen më tavanin si dhe në kalotat duke vazhduar deri në tambur e kupolë. Gjendja e rëndë paraqitej sidomos në narteks në të cilin vihej re lëvizje e muraturës dhe e volumeve. Disnivelet e muraturës arrinin deri në 6 cm, duke u shoqëruar me çarje vertikale të një gjatësie prej 2.5 M të shoqëruara me degëzimë të tyrë. Kjo është ë qartë se këto çarje dhe lëvizje të mëdha, janë shkaktuar nga termetet.

Duke iu referuar skicës (nr.), U vu re natyra e të gjithë plasaritjëve që kishin ndodhur, drejtimet, vibrimet si dhe burimet e këtyre çarjeve. Tamburi së bashku me kupolën, kalotat, harqet etj. Kishin pësuar cedime, zhvandosje të mëdha gjë të cilën ë vërtetonin masat e marra si vendosja e pajantimeve të shumta prej druri të bëra para disa vjetësh dukë eleminuar kështu shkatërrimin e plotë, kjo sidomos në narteks. Por me gjithë këto masa përforcuese nuk kishin mundur të pengonin depërtimin e shirave për humë kohë.

DO NOT COPY

*- Dëmtimi i afreskut nga zjarri*

Pothuajse 80% e sipërfaqes së afreskut ishte e nxirë dhe errësuar nga tymërat dhe nga bloza në kohën kur ishte plotësisht amvona. Nxehtësia dhe flaka kishin shkaktuar dhe dëmtimin e shtratit piktural duke e përzhitur pikturën vënde - vënde. Gjatë çlirimit të nxehtësisë së krijuar kishin shndërruar karbonatin në oksid të kalciumit me një ndryshim të vëllimit që mund të kishtë shkaktuar një thithjë të re të lagështisë dukë degraduar intonakon dhe pigmentet.

*- Mbivëniet në pikturë*

Gjatë pastrimeve drastike që ishin bërë gjatë kohës së shërbësavë në kishë, kishin prishur cipën e shtratit të ngjyrës. Aplikimi i shumë produktëvë si vërniqët, vajrat, dylli, parafina dhe llojë yndyrërash që janë përdorur për shkëlqimin e pikturës kishin prishur pamjën estetikë të afreskut gjithashtu duke qenë të papërshtatshëm dhe të aplikuar keq kishin shkaktuar shkëputjen e pelikulit.

### 3.Egzaminimi laboratorik

Për konkludimin mbi gjendjen dhe degradimin e pikturës murale të kishës së "Shën Mërisë" në Vrahogoranxi u bënë ekzaminime dhe vrojtime të cilat na dhanë konkluzionet e mëposhtme: siç u njohëm deri tani me dëmtimet e afreskut në përgjithësi, kripëzimi përbënte një prej dëmtuesit më të fuqishëm të pikturës murale. Ky kripëzim varet nga një masë e konsiderueshme e përbërjes së suportit të shtratit piktural. Për këtë qëllim u rëalizua analiza e suvasë së pikturës e cila rezultoi se përbëhët nga 70% material copëzor i madhesisë së kuarcit si dhe pak kalcit me kokërriza të mëdha. Themi se mostra përfaqson një masë kryesisht gëlqerore dhe më pak ranor, dmth... Duke qenë se kemi shumë përmbajtje të gëlqerorit, gjendja e kripëzimit është me e madhe, gjë e cila ka lejuar emigrimin në sipërfaqie të pikturës duke dhenë degradimin e saj.

Analiza e mostrave të kripërave në formë velature, kokërrizore e puçroze, gjatë analizës me floureshencë të rrezeve x, rezulton me përmbajtje të lartë të kalciumit, pra kripëra të kalciumit. Kripërat kokrrizore dhe puçroze që ndodhen në afresk rezultoi se përveç përmbajtjes së lartë të kalciumit ka edhe gips prej 54.1% Silic, hekur, stroncium dhe plumb.

Të gjitha këto tregojnë se kripërat nuk janë thjesht me përmbajtje kalciumi por kanë edhe përmbajtje gipsi e rëre.

Për saktësimin e gjendjes së lagështisë në afresk janë bërë matje me aparatin protimeter me elektroda. Rezultatet japin vlera të larta të lagështisë, veçanërisht në zonat e brezit të poshtëm të faqes lindore, perëndimorë, jugore, veriore të kishës, si dhe më shumë në tavanin e narteksit. Gjithashtu, janë bërë matje të lagështisë me diferencë peshash kryesisht në pjesët e poshtme të faqeve të mureve.

U kryen analizat spektrale të pigmenteve të ngjyrave të cilat u kryen pranë laboratorit të fizikës berthamorë në tiranë me anë të floureshencës të rrezeve "x" ku morëm këto rezultate (skica nr 19,20,21,22).

Ndërhyrjet konservuese-restauruese që u kryhen

*1. Injektime:*

U kryen në ato vende ku intonaku paraqitet i shkëputur nga arricio është i shkëputur nga suporti i murit.(Shih skicat e projektit). Në këtë proces u injektua material ledan tb1 dhe primal me anë të përdorimit të shiringave të madhesive të ndryshme, si dhe përdorimi i tullumbave llastiku në formë dardhe.Para përdorimit të ledanit u injektua ujë i distiluar për të pastruar nga papastërtitë

DO NOT COPY

faqet e brendshme të intonakos, arricios dhe të suportit si dhe për të konstatuar daljet apo rredhjet e ledanit.Në këtë proces u pat kujdes nga rrjedhjet në mënyrë që të mos lihen gjatë mbi afresk pasi krijon vështirësi në pastrim e tijë.Trashësia e ledanit do të përdoret sipas rastit.

*2. Qepje plasaritjesh*

Ky proces përfshinte gjithë plasaritjet si dhe çarjet e mëdha që janë pasqyruar në skicat e projektit.Plasaritjet u mbushën me material pluhur mermeri + pluhur smerc + pluhur guri + gëlqere dhe ledan. Aty ku çarjet ishin të mëdha si fuga që arrijnë thellësira të mëdha do të injektohet me anë të pompave metalike gëlqere + pluhur vullkanik + rërë të larë e të situr.

*3. Heqje, trajtim dhe rivendosja afreskut.*

Heqjet u aplikuan aty ku afresku u paraqit gati në rënie kur kishte humbur 90% të lidhjes me suportin.Heqja e afreskut u realizua me anën e përdorimit të sharrave të llojeve e të madhesive të ndryshme,thikave të llojeve të ndryshme.Pra u aplikua teknika e stakomaçelos, duke përdorur si ngjites solucionin paralelid b72+ aceton. Pasi u bë tharja u bë prerja dhe shkulja e saj.Pas shkuljes u vendos në një sipërfaqe të rrafshtë për tu trajtuar, për të bërë hollimin ë tij me anë të bisturive thikave e sharrave duke arritur në një trashësi afro 3-5 mm.Ndërkohë kishim trajtuar dhe suportin nga ku ishte shkulur afresku pasi në të shumtat e rasteve suporti është i dëmtuar.

Më pas mbi një suva të freskët të shtruar në moment,me kujdes dhe me shpejtësi u vendos afresku i trajtuar.Pasi e lamë 48 orë që të përfundonte ngjitja dhe tharja hoqëm me kujdes garzat e ngjitura dhe më pas pastruam afreskun nga ngjitësi.

*4. Zbulim i afreskut nga gëlqerja,llaçrat dhe nga mbushja me çimento*

Në shumë sipërfaqe të afreskut si në faqet e naosit,të nefeve dhe në narteks(kryesisht në brezat e poshtëm)u bënë lyerje me gëlqere ku trashësia arrinte nga 1mm deri në 3mm.Nëpër plasaritje , çarje dhe fuga u bënë mbushje dhe me llaçra të dobët apo të fortë por edhe me mbushje me pluhur vullkanik. Pra siç e pamë ishin bërë ndërhyrje pa kriter mbi afresk,nga njerëz profane,jo kompetente por edhe me materiale të papranueshme dhe të parekomanduara në shkencën e rëstaurimit.Largimi i këtyre mbivënieve ishte një proces i vështirë dhe shumë delikat pasi kishim të bënim me ndërhyrje direkt mbi pelikulin e ngjyrës.Heqja e tyre u bë me anën e përdorimit të lamave të bisturisë.Pas largimit piktura e zbuluar iu nënshtrua një pastrimi të lëhte me gomë speciale.

*5. Qethje e bordurave të afreskut dhe rimbushje me llaç i boshllëqeve*

Këtu kishim të bënim me dy procese. Para rimbushjes me llaç special iu bë qethja e buzëve të afreskut,pastrimi nga mbetje të suvasë dhe të mbetjeve të intonakos me anë të përdorimit të bisturive.Më pas u bë plotësimi i boshllëqeve me llaç të përgatitur me rërë të larë + gëlqere + pluhur mermeri + pluhur guri + pluhur smerc.

*6. Konsolidim i pelikulit të pluhurëzuar*

Në ato zona ku ishin vënë re dëmtim i pelikulit dmth.Ciflosje,përzhitje apo shkëputje nga intonako ku u bë konsolidimi i saj.Duke u nisur nga kjo gjendje e dëmtuar dhe shumë delikate, u aplikua mbi shtatin e ngjyrës,letër japoneze e mbi të kaluam me anë të furçeve me qime të buta paraloid b72 të holluar me aceton, për të realizuar ngurtës-

DO NOT COPY

imin dhe ngjitjen e pelikulit të dëmtuar në suportin e intonakos.Pas tharjes larguam me kujdes letrat e ngjitura.Me këtë proces konsoliduam pelikulin, si dhe realizuam fiksimin e afreskut.

*7. Pastrimi i pikturës, largim i kripërave.*

Gjatë këtij operacioni të vështirë mësuam se: zjarri i rënë në kishë para shumë dekadash, duke djegur anvomën si dhe elementët e saj të drurit, kishte shkaktuar një dëm të madh, jo vetëm objekteve të drurit si ikonostasi dhe ikonat, por edhe pikturës murale duke e bërë më të vështirë heqjen e mbivënieve mbi pikturë.

Gjatë djegies së materialit të drurit së bashku me vajrat, që kanë qenë lyer objektet, kanë çliruar jo vetëm flakë, nxehtësi ,temperaturë të lartë ,por dhe avujt e tymrave, gazra të përzier me yndyrna. Temperaturat e larta kanë vepruar me kalcifikimin e tyre me shtratin e ngjyrës, duke krijuar një shtresë të trashë e të shkëlqyer, të fortë gati të paheqshme në trajtë glazure. Në figurën e krishtit pantokrator,në kupolë si, dhe tek shenjtorët u përdorën solucione nga ato me veprime më të dobëta deri tek ato më të forta, si dymithyl formamid dhe amyl acetat. Këtu, mendojmë se sipërfaqja e pikturës ka qenë më pak në kontakt me tymërat dhe nxehtësinë, pasi ka qenë në dalje nga dritaret e tamburit.

Ndërsa në naos e aq më tepër tek faqet e mureve ,kanë qenë më në kontakt për një kohë të gjatë më to dhe kjo e ka bërë më të vështirë procesin e pastrimit të pikturës.Megjithatë në këtë proces delikat ne nuk tentuam të arrinim deri tek shtrati i ngjyrës, por duke i lënë asaj një shtresë të hollë, një pamje të pranueshme e të lexueshme, dmth, patinën e kohës e cila është një nga elementët estetike më të çmuar për veprën e artit. Solucioni që dha më shumë rezultat ishte receptura e pascelulozës.

DO NOT COPY

## Foto e gjendjes para restaurimit dhe mbas restaurimit



*Para restaurimit*



*Pas restaurimit*

DO NOT COPY










DO NOT COPY










DO NOT COPY










DO NOT COPY




Gjatë restaurimit

DO NOT COPY







DO NOT COPY

DO NOT COPY


















DO NOT COPY



*Para restaurimit*



DO NOT COPY

*Pas restaurimit*





DO NOT COPY

DO NOT COPY



*Para restaurimit*



*Pas restaurimit*


Gjate restaurimit


Pas restaurimit


Pas restaurimit


Pas restaurimit

DO NOT COPY



Pas restaurimit



Pas restaurimit

DO NOT COPY







DO NOT COPY







DO NOT COPY

DO NOT COPY



*Mbishkrimi*



**Skicat:** *Autori*
**Fotot:** *Autori*
*dhe Zamir Marika*

DO NOT COPY

# Restoration of the wall painting in "Saint Maria" Church in Vrahogoranxi village realized by Onupher Qiprioti and Alivizi Foka

The church of St. Maria in the village of Vrahogoranxi belongs to the basilica type made of three half circled nymphs. The church is built in the first quarter of the 17th century. The fresco is realized in the Byzantine technique. It is based on a wall support which is 70 cm thick.

The interior of the church creates an emotional mood considering the right relations and their dynamic, between the volumes and the arches disassembled right in relation with space in general. We aimed to find out what exactly was in this art work, to determine what it is, actually, its origin and the changes it has suffered along the history.

Through physical and technological examination we determined the parts of the structure of the monument, the changes that are modified by people, transformation, destroying, and the determination of decay.

In the graphic documentation is fixed the condition of the picture and its relations with architecture (support) reflected on the drawing, sketches, where was reproduced in a certain level.

To come to a conclusion, on the condition and degradation of the wall painting of the church of St. Maria soundings and examinations were done, which discovered that salting was the main noxious factor for the wall painting decay.

Spectral analyzes of color pigments were done in the laboratory of nuclear physics in Tirana with the method of fluorescence of the "X" rays where are taken the following results shown in the sketches (19, 20, 21, 22).

DO NOT COPY

Solinda KAMANI

# Qeramika mesjetare dhe pas-mesjetare e kishës së Shën Ndout

Gjatë muajve maj - korrik të vitit 2000 në kishën e Shën Ndout në Kepin e Rodonit (rrethi i Durrësit), u kryen gërmime të karakterit kompleks, në kuadrin e një projekti të gjerë restaurues, të financuar nga Instituti Monumenteve të Kulturës dhe Ambasada e Republikës të Gjermanisë në Tiranë.

Kepi i Rodonit njihet ndryshe edhe me emrin Muzhli i Skënderbeut. Në pjesën veriore të kepit, midis dy kodrave të ulta, disa metra larg bregut të detit adriatik, gjenden rrënojat e manastirit të shën mërisë, i cili përmendet në disa burime historike , si dhe kisha e shën ndout. Arkitektura e kishës bën pjesë në tipin kishave romaniko – gotike. Gërmimi arkeologjik në kishën e shën ndout kishte për qëllim të nxirrte në pah bashkëlidhjet midis ndërtimit dhe fazave të mëvonshme restauruese të këtij monumenti. Nga materiali arkeologjik i mbledhur gjatë gërmimeve, në këtë studim do të jepet vetëm qeramika, e vështruar nga pikëpamja tipologjike. Kjo për arsye se materiali nuk vjen nga shtresa të rregullta arkeologjike dhe kësisoj e bën të vështirë përcaktimin e saktë kronologjik të qeramikës.

Materiali qeramikë i zbuluar ndahet në dy grupe kryesore:

1- Enë transporti

2- Enë kuzhine

Për datimin e qeramikës kanë shërbyer në radhë të parë elemente të teknikës dhe të dekoracionit, të cilat janë analizuar tashmë edhe në vendgjetje të tjera të rëndësishme të vendit tonë . Duke u nisur nga kjo, qeramika e gjetur në kishën e shën ndout, në përgjithësi reflekton karakteristikat e qeramikës së thjeshtë e asaj të glazuruar të shek xiv - xix.

**Enë të transportit (tab. I)**

Enët e transportit përfaqësohen në gjetjet e deritanishme nga amforat dhe amforat - shtambë. Ato janë punuar me deltinë në ngjyrë rozë në okër. Për nga forma, ato iu afrohen më tepër shtambave, prandaj edhe janë quajtur shpesh amfora - shtambë. Trupi i tyre ka zakonisht trajtë boshti, me qafë të shkurtër e vegje të ngritura mbi buzë. Paretet e këtyre enëve janë më së shumti të thjeshta e pa zbukurime, në pak raste ndeshet ndonjë ekzemplar, paretet e të cilit janë zbukuruar me kanelyra të gjera.

Midis enëve të këtij lloji ka edhe ekzemplarë me glazurë. Në një fragment vegje (tab. I, 5) është përdorur glazura në ngjyrë kremi, mbi të cilën janë trajtuar linja me penel të hollë në ngjyrë të kaltër, të cilat imitojnë trajtat e valëzuara dhe thonjëzat. Enë me zbukurime të tilla janë zbuluar më parë në Ballsh dhe datohen në shek. Xii - xiv . Midis pareteve veçohen tre prej tyre (tab. I, 1 – 3), të zbukuruar me motive hullizash në trajtë tufash prej 5 - 6 vijash të cekta; ato kryqëzojnë shpatullat dhe

barqet e enëve, duke ndjekur një linjë koncentrike. Këto motive ndeshen në enët e së njëjtës kategori, të zbuluara në rrethinat e Durrësit . Në një fragment tjetër (tab. I, 4) vërehen gërvishjte në trajtë thonjëzash, të ngjashme me ekzemplarët e gjetur në kalanë e Bllacës në rrethin e Pogradecit dhe në kryemëdhenj të rrethit të Durrësit . Shtambat, vegjët e të cilave kanë formë bishtkungulli, datohen në shek. XVII - XVIII, periudhë kur gjeti përdorim glazura me ngjyrë kafe në çokollatë, me shkëlqim shumë të theksuar (tab. I, 6).

**Katalogu***

1. Fragment pareti me nr. Inv. 202 (Tab. I, 1). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 5/6. Fakturë e hollë, zbukuruar në anën e jashtme me motive hullizash në trajtë tufash prej 5 - 6 vijash të cekta drejtvizore dhe të valëzuara, të cilat qarkojnë shpatet dhe barkun e enës, duke ndjekur një linjë koncentrike.

2. Fragment pareti me nr. Inv. 194 (Tab. I, 2). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 5y 6/6. Trup në trajtë boshti, fakturë mesatare dhe qafë e ngushtë. Motivet e zbukurimit si te nr. Inv. 202.

3. Fragment pareti me nr. Inv. 143 (Tab. I, 3). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 5yr 6/8. Fakturë e hollë, zbukuruar në anën e jashtme me motive të ngjashme si te nr. Inv. 202. Mbi sipërfaqe dallohen dy vija të inçizuara.

4. Fragment pareti me nr. Inv. 141 (Tab. I, 4). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 6/6. Fakturë e hollë, zbukuruar në anën e jashtme me tufa hullizash drejtvizore dhe të valëzuara. Midis dy tufave paralele janë vendosur hulliza të tjera, të inçizura në trajtë thonjëzash.

5. Vegje me nr. Inv. 42 (Tab. I, 5). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 8/4. Vegja është e tipit petullicë, lyer me glazurë në ngjyrë kremi mbi të cilën janë trajtuar linja me penel të hollë në ngjyrë të kaltër, që imitojnë një trajtë të valëzuar dhe thonjëza.

6. Vegje me nr. Inv. 156 (Tab. I, 6). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 7/4. Qafë e ngushtë cilindrike me vegje në formë bishtkungulli që ngrihet mbi grykë. Lyer me glazurë në ngjyrë kafe në çokollatë me shkëlqim të theksuar. Vegja është zbukuruar me një thimth. Diam. 4,2 Cm.

**Kotruvet (fig. 1)**

Kotruvet janë enë me brumë të njëjtë dhe pjekje të ngjashme si edhe shtambat. Ato imitojnë format e amforave - shtambë, duke iu përmbajtur atyre në miniaturë. Kotruvet (fig. 1, 7-8) Janë të glazuruara dhe të zbukuruara me motive të ndryshme. Në një vegjë (fig. 1, 8) Duken gjurmët e glazurës në ngjyrë të kuqe të ndezur dhe me pak shkëlqim, e cila, nga zbulimet e bëra në kullat mesjetare të qytetit të Durrësit dhe në Ballsh, rezulton t'i përkasë fundit të shek. XIV dhe fillimit të shek. XV.

**Katalogu**

7. Buzë dhe vegjë me nr. Inv. 112 (Fig. 1, 7). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 7/6. Sipërfaqja e lyer me angobë në ngjyrë 10yr 8/6. Qafa është e ngushtë, me vegje horizontale petullicë që ngrihet mbi buzë. Diam. 3 Cm.

8. Vegjë me nr. Inv. 157 (Fig. 1, 8). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 5yr 7/6. Vegje vertikale me prerje elipsoidale. Lyer me glazurë monokrome në ngjyrë të kuqërremtë me pak shkëlqim.

**Broket (tab. Ii)**

Edhe kjo kategori përbëhet nga forma të njohura të enëve mesjetare. Balta e tyre ka pjekje në ngjyrë okër me parete të holla. Trupi ruan forma globulare, qafa është e trashë dhe e lartë. Pjesa më e madhe e brokeve është zbukuruar me mo-

DO NOT COPY

tive të ndryshme. Për nga stili i zbukurimit, broket me glazurë në ngjyrë të gjelbër dhe ulliri, siç është rasti i enës së paraqitur në tab. Ii, 9, i takojnë shek. XV. Enë të tilla, me glazurë të ngjashme, por pa ruletë janë gjetur në shumë treva të shqipërisë, ku janë datuar në shek. XIV - XV. Enët e zbukuruara me ruletë, por me angobë në ngjyrë kafe, i përkasin shek. XV . Fragmenti i vegjes me nr. Inv 6 (tab. Ii, 14) është tipik për shek. XVI - XVII . Broket e tjera (tab. Ii, 10 – 13, 15) përputhen në kohë me serinë e brokeve italike të shek XVI - XVII .

**Katalogu**

9. Fragment ene të mbyllur, paret me nr. Inv. 213 (Tab. Ii, 9). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 5yr 7/6. Ena është e lyer me glazurë vetëm nga ana e jashtme, me ngjyrë të gjelbër, me shkëlqim dhe zbukuruar me ruletë.

10. Fragment pareti me nr. Inv. 208 (Tab. Ii, 10). Baltë e pastër me parete të holla dhe pjekje në ngjyrë 2.5Y 8/3. Trup vezak. Glazurë me ngjyrë te bardhë dhe me pak shkëlqim. Zbukuruar me motive floreale, të realizuara me penelata të holla në ngjyrë të kaltër dhe blu.

11. Fragment pareti me nr. Inv. 9 (Tab. Ii, 11). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 8/3. Trup globular, parete të holla. Glazurë në ngjyrë të bardhë me shkëlqim. Zbukuruar me penelata në ngjyrë të gjelbër.

12. Vegje me nr. Inv. 91 (Tab. Ii, 12). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 8/3, vegje vertikale petullicë. Glazuruar me ngjyrë të bardhë. Vegja ndahet në mes nga një hulli dhe është zbukuruar me thimtha.

13. Fragment pareti me nr. Inv. 23 (Tab. Ii, 13). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 8/3. Glazuruar me ngjyrë të bardhë me shkëlqim. Me penelata në ngjyrë të gjelbër, blu dhe të zezë janë pikturuar motive floreale.

14. Fragment pareti me nr. Inv. 18 (Tab. Ii, 14). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 8/3. Trup globular me parete të holla. Glazuruar në ngjyrë të bardhë me shkëlqim. Me penelata të holla në ngjyrë të verdhë dhe portokalli janë pikturuar rrathë koncentrikë dhe motive floreale.

15. Fragment vegje me buzë me nr. Inv. 6 (Tab. Ii, 15). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 10yr 7/4. Buzë të holla dhe të drejta, që ngrihen mbi buzë. Vegje vertikale. Glazuruar në ngjyrë të gjelbër me pak shkëlqim në anën e jashtme deri në gjysmë gishti nën buzë në faqen e brendshme. Me penel linjëtrashë në ngjyrë mjalti është realizuar poshtë buzës së brokes një shirit i çrregullt gjerësor, ndërsa me penel linjëmesatar janë vizatuar gjysmëharqe të gjelbër. Diam. I buzës 9,4 cm.

**Enë kuzhine (fig. 2)**

Enët e kuzinës janë shumë të kufizuara në lëndën e gjetur. Ato përfaqësohen vetëm me dy fragmente. Njëri prej të cilëve i takon një vorbe të thjeshtë (fig. 2, 17) Me parete të holla në ngjyrë të kuqërremtë të ndezur, ku vende - vende nga brenda dhe jashtë duken njollat e djegieve dhe një pjesë e pareteve është pothuajse e djegur. Ajo që bie më tepër në sy është glazura nga brenda dhe një tejpashmëri qelqore. Fragmenti tjetër (fig. 2, 16) i takon një tave, e punuar me dorë prej balte jo shumë të pastër. Variante të tilla tavash janë ndeshur në territorin e Apolonisë, ku janë trajtuar si të shek. XIV , gjithashtu në Itali, ku datohen në shek. XIII - XIV si dhe në greqi, ku ato janë datuar diçka më herët .

**Katalogu**

16. Buzë tave me nr. Inv. 228 (Fig. 2, 16). Baltë jo shumë e pastër me pjekje jo të njëtrajtëshme, thelbi në ngjyrë 5yr 6/6 dhe sipërfaqja në ngjyrë 7.5Yr 5/6. Sipërfaqja është e mbuluar me ajkë

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të dobët në ngjyrë 10yr 6/4. Buzët janë të trasha dhe të profiluara nga brenda. Punuar me dorë. Diam. 40 Cm.

17. Buzë vorbe me nr. Inv. 5 (Fig. 2, 17). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Yr 6/8. Trup globular, buzë të holla dhe të profiluara nga jashtë. Në anën e jashtme të buzës vërehet një hullizë në pjesën e sipërme dhe një tjetër në pjesën ku buza bashkohet me trupin. Lyer me glazurë transparente. Vende - vende, si nga jashtë ashtu dhe nga brenda, duken njollat e djegieve, ndërsa një pjesë e paretit është djegur pothujase plotësisht. Diam. 11 Cm.

**Tasat (tab. lii - iv)**

Kjo kategori enësh është më e pasur në numër, krahasuar me të tjerat. Balta është në ngjyrë të ndezur dhe kafe me tone të çelta deri në okër. Tasat ruajnë formën trungkonike, me fund të sheshtë unazor dhe buzë të profiluara nga brenda. Glazura është bërë kryesisht në faqet e brendshme deri një gisht ose dy gishta në faqen e jashtme. Më të përdorura janë glazurat me dhe pa shkëlqim në ngjyrë të verdhë, të bardhë e çokollatë. Në disa prej tasave janë trajtuar mbi glazurë zbukurime të ndryshme. Në një fragment të vetëm (tab. Iv, 27) dallohet motivi i kombinimit të teknikës sgrafitto me njolla në ngjyrë të gjelbër dhe kafe, ashtu sikurse në gjetjet e mëparshme nga qyteti i Durrësit, petra dhe symiza, të cilat datohen më herët në shek. XII - XIV, ndërsa fragmenti ynë i takon një periudhe më të vonë, shek. XVI deri në mesin e shek. XVII. Në një fragment tjetër (tab. lii, 22) motivet përfaqësohen nga rrathë koncentrikë në ngjyrë kafe, ku gjithashtu janë përdorur edhe motivet zigzake që ngjasojnë me motive të tjera vegjetale, njësoj si në qytetin e Durrësit, ku datohen në shek. XV . Në një fund tasi (tab. IV, 25) është aplikuar spirali, i trajtuar në mënyrë të çrregullt, që fillon nga qendra dhe shpërndahet deri në faqet anësore. Tre fragmente tasash (tab. lii, 21, 23; tab. Iv, 24), për nga mënyra e glazurimit janë të ngjashëm me prodhimet e shek. XVI - XVII, që vijnë në rodon nëpërmjet marrëdhënieve tregtare me punishtet italike. Veçanërisht interes paraqet figura antropomorfe në fundin e tasit me nr. Inv 71 (tab. lii, 23), të lyer me glazurë në ngjyrë të bardhë me shkëlqim. Ajo është majolikë, në faqen e brendshme të së cilës me linja të holla në ngjyrë të zezë, të kaltër dhe të verdhë është pikturuar figura, që duhet t'i përkasë një personazhi të huazuar nga mitologjia (eros) .

Nga tasat dallojnë veçanërisht ata, ku glazura në ngjyrë kremi paraqitet e leskëruar dhe që në anën e jashtme janë lyer me penelata të çrregullta në ngjyrë kafe, bezhë, ose të gjelbër (tab. III - IV, 18, 19, 25, 26), të cilët datohen në shek XVI – XVII . Fragmente të tilla, janë gjetur edhe në kanaparaj të durrësit dhe në mashkjezë, të cilat janë datuar në shek. XIV . Fragmentet e tjera të kësaj kategorie (tab. IV, 20, 28, 29) për nga mënyra e glazurimit (slip-painted) përfshihen në prodhimet e shek. XVI - XVIII .

**Katalogu**

18. Tas i plotë me nr. Inv. 67 (Tab. lii, 18). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 5yr 6/8. Forma trungkonike me buzë të profiluara nga brenda dhe fund i sheshtë unazor. Lyer me glazurë në ngjyrë kremi, që është e plasaritur në faqen e brendshme. Faqja e jashtme është zbukuruar me penel linjë e çrregullt në ngjyrë kafe te errët. Diam. 15,2 Cm.

19. Buzë me nr. Inv. 181 (Tab. III, 19). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 7/8. Trup gjysmëglobular, buzë të rrumbullakosura dhe të profiluara nga brenda. Lyer me glazurë në ngjyrë kremi me pak shkëlqim në anën e brendshme deri dy gisht në anën e jashtme. Zbukuruar me njolla në ngjyrë të gjelbër. Diam. 17 Cm.

20. Fragment pareti me buzë me nr. Inv. 200

(Tab. III, 20). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 7/4. Trup gjysmëglobular, buzë të rrumbullakosura dhe të profiluara nga jashtë. Lyer me glazurë në ngjyrë kafe me pak shkëlqim në anën e brendshme deri një gisht nën buzë në anën e jashtme. Me penelata të trasha në ngjyrë kremi janë pikturuar linja rrethore koncentrike dhe të valëzuara. Në pjesën e sipërme të buzëve dhe në paretin e të dyjave anëve ndodhet nga një vrimë, që ka shërbyer ndoshta për të varur. Diam. 32 Cm.

21. Fund tasi me nr. Inv. 27 (Tab. III, 21). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 7/4. Fund i sheshtë unazor, parete të trasha. Lyer me glazurë të bardhë në anën e brendshme. Zbukuruar me penelata në ngjyrë të zezë, kafe dhe të verdhë. Diam. 5,5 Cm.

22. Fragment tasi me nr. Inv. 165 (Tab. Iii, 22). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 7/4. Buzë të profiluara drejt, fund i sheshtë unazor. Glazuruar në ngjyrë të verdhë me shkëlqim në anën e brendshme deri gjysmë gishti nën buzë në anën e jashtme. Në të gjithë gjerësinë e buzëve janë pikturuar tetë rrathë koncentrikë me penelata në ngjyrë kafe në te kuqe, ngjitur me to janë vizatuar motive zigzake dhe të tjera që ngjajnë me motive vegjetale në ngjyrë të gjelbër dhe kafe. Diam. 18 Cm.

23. Fragment tasi me nr. Inv. 71 (Tab. III, 23). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 8/3. Trup gjysmëglobular, buzë të holla dhe të profiluara nga brenda, fund i sheshtë unazor. Lyer me glazurë të bardhë me shkëlqim. Në faqen e brendshme është vizatuar një figurë me linja të holla të zeza, të kaltra e të verdha, e cila ndoshta duhet t'i përkasë një personazhi të huazuar nga mitologjia (eros). Diam. 15 Cm.

24. Buzë me nr. Inv. 28 (Tab. IV, 24). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 7/4. Buzë të holla e të profiluara nga jashtë. Lyer me glazurë të bardhë me shkëlqim. Me penelata në ngjyrë të gjelbër, të kaltër, të zezë, portokalli dhe të verdhë janë vizatuar rrathë koncentrikë dhe motive zigzake, që ngjasojnë me ato vegjetale. Diam. 22 Cm.

25. Fund tasi me nr. Inv. 205 (Tab. IV, 25). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 6/4. Fund i sheshtë unazor. Glazuruar në ngjyrë kremi me pak shkëlqim në anën e brendshme. Në fundin e tasit është aplikuar një spiral i trajtuar në mënyrë të çrregullt që fillon nga qendra dhe shpërndahet në faqet anësore, i realizuar me penelata të trasha në ngjyrë të gjelbër dhe kafe. Diam. 7,5 Cm.

26. Buzë tasi me nr. Inv. 21 (Tab. IV, 26). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 5/6. Tas i thellë me buzë të profiluara pak nga jashtë. Glazuruar në ngjyrë kremi me pak shkëlqim. Me penelata në ngjyrë kafe dhe të gjelbër janë pikturuar shirita koncentrikë në formë gjysmërrethi. Diam. 21,4 Cm.

27. Fund tasi me nr. Inv. 70 (Tab. IV, 27). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 5yr 6/8. Fund i sheshtë unazor. Nga ana e jashtme, në pjesën ku fundi lidhet me trupin, krijohet një hullizë. Glazuruar në ngjyrë kremi me shumë pak shkëlqim në anën e brendshme. Zbukuruar me kombinimin e sgrafitto-s linjëhollë, me të cilën janë pikturuar motive floreale e valëzuese, me ngjyra në ngjyrë të gjelbër e kafe. Diam. 5,5 Cm.

28. Buzë me nr. Inv. 14 (Tab. IV, 28). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 6/6. Buzë të holla e të drejta. Glazuruar në ngjyrë kafe në pjesën e brendshme. Me penelata në ngjyrë të verdhë janë vizatuar rrathë koncentrikë. Diam. 17 Cm.

29. Buzë me nr. Inv. 207 (Tab. IV, 29). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 6/6. Buza e profiluar pak nga jashtë. Glazuruar në ngjyrë kafe. Zbukuruar në anën e jashtme me linja koncentrike dhe të valëzuara në ngjyrë kremi. Diam. 20 Cm.

PHOTOCOPY

Pjatat (tab V - VI)

Edhe për këtë seri enësh është përdorur baltë e njëjtë si ajo e tasave. Pjesa më e madhe e pjatave është lyer me glazurë, po njësoj si te tasat. Mënyra e glazurimit duket se nuk bën dallim nga enët e tjera të tryezës, por nga forma pjatat mund të ndahen në dy grupe: të cekta dhe të thella. Disa prej fragmenteve ka lidhje me enë të tipit pjatancë (tab. V, 30, 31; tab.VI, 40, 44). Midis pjatave të thella tërheqin vëmendje dy fragmente (tab. VI, 45, 46) glazuruar në ngjyrë kremi me plasaritje. Në buzën e tyre është përdorur zbukurimi me penel të hollë në ngjyrë të gjelbër, që paraqet motive të valëzuara, të kombinuara me harqe. Këto dhe disa ekzemplarë të tjerë (tab. V, 30, 31; tab. VI, 39) glazuruar me ngjyrë të gjelbër, kafe, të verdhë e të kuqe, u përkasin tipave të njohur të shek. XVIII - XIX . Disa fragmente të tjera (tab. V, 37; tab. Vi, 38, 43, 44) nga mënyra e glazurimit përfshihen në importet perëndimore të shek. Xvi . Dy fragmente pjatash (tab. VI, 40, 41) i përkasin serisë së shek. XVI-XVII.

Përsa u përket pjatave të lyera me glazurë në ngjyrë kafe dhe të zbukuruara me linja peneli koncentrike dhe të valëzuara, me pigmente të trasha në ngjyrë të verdhë, të bardhë dhe çokollatë (tab. V, 32 – 36; tab.VI, 42), ato janë trajtuar deri më sot si të kohës së sundimit osman të shek. XVI- XVIII .

**Katalogu**

30. Buzë me nr. Inv. 192 (Tab. V, 30). Baltë e pastër me pjekje jo të njëtrajtshme, thelbi në ngjyrë 5yr 6/6 dhe sipërfaqja në ngjyrë 7.5Yr 7/6. Buzë të gjera dhe të shpërvjelura nga jashtë. Lyer me glazurë monokrome në ngjyrë kremi, e leskërzuar në faqen e brendshme. Diam. 18 Cm.

31. Pjatë me nr. Inv. 172 (Tab. V, 31). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 6/4. Pjatë e gjerë, me fund të sheshtë unazor dhe buzë të gjera e pak të pjerrta nga jashtë. Lyer në anën e brendshme me glazurë në ngjyrë 2.5Y 7/6 me pak shkëlqim. Diam i buzëve. 19,9 Cm; diam i fundit. 13 Cm

32. Buzë me nr. Inv. 177 (Tab. V, 32). Baltë e pastër me pjekje jo të njëtrajtshme, në thelb në ngjyrë 5yr 6/6 dhe në sipërfaqe ngjyrë 7.5Yr 7/6. Fakturë mesatare, buzë të profiluara nga jashtë. Faqja e brendshme është glazuruar në ngjyrë kafe. Zbukuruar me linja koncentrike peneli të drejta dhe të valëzuara në ngjyrë kremi, të ngritura pak në reliev. Diam. 22 Cm.

33. Buzë me nr. Inv. 77 (Tab. V, 33). Baltë e pastër me pjekje të njëtrajtshme në ngjyrë 10yr 7/4. Buzët janë paksa të kthyera nga brenda. Faqja e brendshme deri një gisht nën buzë, nga ana e jashtme, është glazuruar në ngjyrë kafe dhe është zbukuruar me penelata në ngjyrë të verdhë në trajtë rrathësh koncentrikë dhe linjash të valëzuara. Diam. 24 Cm.

34. Buzë me nr. Inv. 201 (Tab. V, 34 dhe 34/1). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 6/4. Buzë të profiluara, të gjera e të sheshta. Faqja e brendshme deri gjysmë gishti nën buzë nga ana e jashtme është glazuruar në ngjyrë të verdhë. Zbukuruar me linja koncentrike të realizuara me penelata në ngjyrë kafe. Në syprinën e buzës janë vizatuar rrathë të vegjël, me të njëjtën ngjyrë, të ngritura paksa në reliev. Diam. 23 Cm.

35. Buzë me nr. Inv. 1 (Tab. V, 35). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 5yr 6/8. Buzë të shpërvjelura pak nga jashtë. Pjata është lyer me glazurë në ngjyrë çokollatë në të dyja faqet. Me linjë penelatash në ngjyrë të verdhë janë vizatuar figura rrathësh koncentrikë dhe të valëzuar, që përshkojnë gjithë diametrin e pjatës. Diam. 18 Cm.

36. Buzë me nr. Inv. 12 (Tab. V, 36). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 10yr 6/4. Buzë të drejta, që krijojnë një kanal të hollë dhe të cekët në pjesën e sipërme. Faqja e brendshme deri një gisht nën buzë nga jashtë është lyer me gla-

DO NOT COPY

zurë në ngjyrë të verdhë. Me penelata vijëhollë në ngjyrë kafe janë realizuar rrathë koncentrike, ndërsa me penelata mesatare linja të valëzuara. Diam. 36 Cm.

37. Buzë me nr. Inv. 13 (Tab. V, 37). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 8/4. Buzë të profiluara nga jashtë. Glazuruar në ngjyrë të bardhë. Motivet e zbukurimit janë gjeometrike dhe floreale, të realizuara me penelata në ngjyrë blu, portokalli, të gjelbër dhe të verdhë. Diam. 29 Cm.

38. Buzë me nr. Inv. 26 (Tab. VI, 38). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 6/4. Buzë të drejta, pak të pjerrta nga jashtë. Glazuruar në ngjyrë të bardhë në faqen e brendshme, mbi të cilën është realizuar vizatimi me penelata linjëmesatare e të trasha polikrom, që realizojnë linja harkore dhe të valëzuara. Diam. 32 Cm.

39. Buzë me nr. Inv. 81 (Tab. VI, 39). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 8/4. Buzë të gjera, të profiluara nga jashtë dhe pak të harkuara. Glazuruar në ngjyrë kremi në faqen e brendshme. Zbukuruar me penelata të trasha e mesatare në ngjyrë të kuqe dhe të gjelbër. Diam. 23 Cm.

40. Buzë me nr. Inv. 178 (Tab. VI, 40). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 5/6. Buzë të pjerrta. Glazuruar në ngjyrë kremi në faqen e brendshme deri një gisht nën buzë nga ana e jashtme. Zbukuruar me penelata në ngjyrë të gjelbër dhe kafe. Diam. 27 Cm.

41. Fund me nr. Inv. 72 (Tab. VI, 41). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 5yr 6/8. Fund i sheshtë unazor. Glazuruar në ngjyrë kremi në pjesën e brendshme, ndërsa në faqen e jashtme vërehen disa linja të çrregullta po me të njëjtën ngjyrë. Zbukurimi është realizuar me penelata në ngjyrë të gjelbër dhe kafe. Diam. 10,8 Cm.

42. Buzë me nr. Inv. 76 (Tab. VI, 42). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 7.5Yr 7/4. Buzë të gjera në trajtë strehe, të shpërvjelura nga jashtë, në buzë gjendet një vrimë, e cila mund të ketë shërbyer për vendosjen e vegjës. Me glazurë në ngjyrë çokollatë dhe me shkëlqim është lyer ana e brendshme deri një gisht nën buzë nga ana e jashtme. Me penel linjëmesatar në ngjyrë të verdhë janë pikturuar linja të drejta e të valëzuara koncentrike. Diam. 24 Cm.

43. Fragment pareti me nr. Inv. 199 (Tab. VI, 43). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 7/3. Pareti i pjatës është glazuruar vetëm në anën e brendshme me solucion të bardhë me pak shkëlqim. Me penelata mesatare në ngjyrë gri, të gjelbër dhe të verdhë janë pikturuar motive floreale. Diam. 40 Cm.

44. Buzë me nr. Inv. 168 (Tab. VI, 44). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 7/4. Fund i sheshtë unazor, buzë të profiluara nga jashtë. Glazuruar në ngjyrë të bardhë me pak shkëlqim. Me penelata të holla në ngjyrë të zezë janë vizatar mbi buzë dy harqe rrethore, paralel njëri me tjetrin, dhe në mes tyre lule të vogla më të njëjtën ngjyrë; hapësira midis dy harqeve është lyer me ngjyrë të gjelbër. Diam. 23 Cm.

45. Buzë me nr. Inv. 4 (Tab. VI, 45). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 5yr 5/6. Buzë të drejta, që dhëmbëzohen në fundin e tyre. Lyer në faqen e brendshme me glazurë në ngjyrë kremi me pak shkëlqim dhe e plasaritur. Buza është zbukuruar me penelata linjëholla në ngjyrë të gjelbër, që paraqesin motive të valëzuara, kombinuar me harqe. Diam. 22 Cm.

46. Buzë me nr. Inv. 8 (Tab. VI, 46). Baltë e pastër me pjekje të mirë. Ngjyra dhe glazura janë si te nr. Inv. 4. Diam. 23 Cm.

**Frutierat (tab. VII)**

Nga gërmimi nuk dolën pjesë të plota të kësaj kategorie enësh, por disa funde me fron shumë të lartë (tab. VII, 47) si edhe ndonjë fragmet me fron të ulët. Të parët i përkasin prodhimit vendas. Balta e tyre është në ngjyrë kafe në rozë, glazura e verdhë me njolla të gjelbra ose në kafe, zbu-

DO NOT COPY

kurimi është realizuar me harqe dhe njolla pa formë (tab. VII, 47). Enë të tilla u përkasin shek. XVI - XVII.

Në ndryshim nga të parat, frutierat prej balte të pastër në ngjyrë okër të çelët dhe të glazuruara në ngjyrë të bardhë (tab. VII, 48 – 50), të cilat përfshihen në kategorinë e majolikës, janë të një cilësie më të lartë. Motivet e tyre janë spirale, por edhe të huazuara nga fauna. Në fundin e njërës prej tyre (tab. VII, 49) gjenden edhe disa sigla që riprodhojnë gërmat b, z dhe h. Enë të tilla janë përdorur nga fundi i shek. XV dhe në fillimin e shek. XVI , ku për plotësimin e kërkesave të larta dhe në rritje të popullatës së asaj kohe për servise të tilla, ato impotoheshin nga italia e veriut .

**Katalogu**

47. Fund frutiere me nr. Inv. 2 (Tab. VII, 47). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 5yr 5/8. Fron trugkonik, paksa i shpërvjelur nga jashtë. Glazuruar në ngjyrë kremi në faqen e brendshme, vende - vende me njolla në ngjyrë të gjelbër dhe kafe. Diam. I fundit të enës 14 cm, i sipërmi 9,3 cm.

48. Fund frutiere me nr. Inv. 183 (Tab. VII, 48). Baltë e pastër me pjekje në ngjyrë 2.5Y 8/3. Fund unazor me këmbë të trasha. Lyer me glazurë në ngjyrë të bardhë, që përfshihet në kategorinë e majolikes. Motivet e zbukurimit janë gjeometrike, të realizuara me penelata në ngjyrë të verdhë e të kaltër, që krijonë linja koncentrike. Diam. I sipërm 6,5 cm, i poshtmi 10,1 cm.

49. Fund frutiere me nr. Inv. 155 (Tab. VII, 49). Balta, pjekja dhe ngjyra si te nr. Inv. 183. Në fundin e enës vërehen disa sigla, që riprodhojnë gërmat b, z, dhe h. Diam. I sipërm 7,6 cm, i poshtmi 11,2 cm.

50. Fund frutiere me nr. Inv. 79 (Tab. VII, 50). Balta, pjekja dhe ngjyra si te nr. Inv. 183. Fund unazor dhe me këmbë të holla e të kthyera nga brenda. Glazuruar në ngjyrë të bardhë me shkëlqim. Me penelata në ngjyrë të verdhë, të zezë, kafe dhe bojëqielli janë vizatuar motive nga fauna, një kokë gjarpri dhe insekte. Diam. 7,6 Cm.

**Llullat (fig. 3)**

Janë punuar me finesë prej balte të një cilësie shumë të lartë në ngjyrë portokalli në kafe. Ato paraqiten në formë hinke në miniaturë dhe janë të zbukuruar me motive të ndryshme, kryesisht hulliza koncentrike dhe motive floreale, të realizuara me anë të gërricjes. Objekte të tilla janë gjetur me shumicë në Durrës dhe në Krujë, të cilat i takojnë kohës së pushtimit osman deri në fund të shek. XIX .

**Katalogu**

51. Fragment llulle (kokë dhe bisht që nuk bashkohen) me nr. Inv. 140 (Fig 3, 51). Baltë e cilësisë së lartë me pjekje në ngjyrë të kuqe. Kokë në trajtë këmbane. E gjithë sipërfaqja mbulohet me angobë monokrome në ngjyrë tulle. Buzë të holla, të profiluara nga jashtë dhe që formojnë një kurriz rretheqark. Bishti i llullës, së bashku me grykën, formon një kënd të ngushtë. Nga brenda, koka e llullës ka marrë ngjyrë të zezë nga djegia e duhanit. Në pjesën e jashtme është zbukuruar me gdhendje në formën e rombeve të vegjël, të mbushur secili me katër pika, të ngritura pak në reliev. Bishti ka formë cilindrike. Fundi ka buzë të fryra dhe të shpërvjelura nga jashtë. Në fundin e tij janë realizuar me inçizim tetë gjysmëharqe, dy hulliza koncentrike dhe një vulë.

**Përfundime**

Studimi i materialit qeramikë nga kisha e shën ndout dhe mjediset përreth saj na jep disa të dhëna me interes, lidhur me kohën e ngritjes dhe funksionimit të këtij vendbanimi kishtar. Nga analiza tipologjike, teknologjia e përpunimit dhe dekori i shumicës së gjetjeve të qeramikës si: enët e

DO NOT COPY

transportit (amforat), kotruvet dhe enët e kuzhinës, del se shek. XIV mund të pranohet si një terminus post quem për datimin e kësaj kishe. Edhe krahasimet me vendgjetje të tjera të afërta, të zbuluara brenda territorit të vendit tonë, përputhen me këtë datim. Datimi i vendosur në këtë punim (shek. XIV), përkon edhe me të dhënat e studimit arkitektonik të kishës së shën ndout , ndërkohë që datimi i Ippen-it në shek. XV mbështetet më tepër në elemente, të cilët mund të kenë marrë formën e plotë mbas fazës fillestare të ndërtimit të monumentit.

Qeramika e studiuar i takon aktivitetit të përditshëm jetësor të banorëve (kryesisht enë transporti për prodhime bujqësore dhe enë kuzhine me përdorim zjarri), si edhe enë me glazurë që vijnë në Rodon nëpërmjet marrëdhënieve tregtare, kryesisht me gadishullin Italik (krahinat qendërveriore të Italisë). Për vazhdimësinë e jetës së kësaj qendre kishtare deri në fundin e shek të xix, flasin tiparet e qeramikës së thjeshtë dhe asaj të glazuruar, sidomos në kategori të tilla enesh, si: shtambat, broket, pjatat dhe llullat. Nëse gërmimet do të vazhdojnë më tej, studimi i një materiali më të bollshëm do të lejoj saktësime në datimin e fazave të veçanta të këtij monumenti.

DOKTORATURA

**Bibliografia**


Anamali, s. Gërmimet arkeologjike të vitit 1983 në Ballsh "Iliria" 2, 1983.

Antiche ceramiche italiane tra le due sponde dell'adriatico dal palazzo di diocleziano a spalato alla fortezza di pescara, 2001.

Bakirtzis, h. Byzantina tsukalologina. Thessaloniki, 1984.

Ceka, n. & A. Baçe. Vrojtim arkeologjik në rrethin e Pogradecit, Luginën e Devollit dhe të Shkumbinit "monumentet" 3, 1972.

Gustin, m. Ceramiche medievali e postmedievali da pirano e san giovanni, koper, 2004.

Hahn, m. Byzantine and postbyzantine pottery from the greek - swedish excavations at khania, crete "recherches sur la ceramique byzantine" bch supplement xviii, 1989.

Hayes, j. W. Excavations at saraçhane in istanbul, vol. 2, 1992.

Hoti, a. Kërkime arkeologjike në zonën e kryemëdhenjt në rrethin e Durrësit "Iliria" VII - VIII, 1977 – 1978.

Ndihmesë për hartën arkeologjike të rrethit të Durrësit "Iliria" 1, 1987.

Enë me glazurë nga qyteti i Durrësit (shek X - XV) "Iliria" 1, 1989.

Qeramika mesjetare e zbuluar në durrës (shek. VII - XV), disertacion 1990.

Ippen, th. Denkmaeler verschiedener altesstuffen in albanien "alte kirchen und kirchenruinen in albanien", 1900.

Karaiskaj, Gj. Raport mbi gërmimet e viteve 1973 - 1974 në gradishtën e symizës "buletin arkeologjik" 5, 1975

Gradishta e Symizës në periudhën e vonë antike dhe mesjetare "iliria" ix - x, 1979 – 1980.

Komata, D. Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në kalanë e Kaninës, "Buletin Arkeologjik" 4, 1974.

Qendërbanimi i fortifikuar i kaninës në rrethin e Vlorës "Buletin arkeologjik" 5, 1975.

Gërmime arkeologjike të vitit 1983 në kalanë e Gjirokastrës "Iliria" 2, 1983.

Meksi, A. Kishat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut "monumentet" 1, 1984.

Tartari, F. Lëndë arkeologjike nga petra (shkëmbi) "Buletin Arkeologjik" 5, 1975.

Zagarčanin, m. Stari bar: pottery from the venetian period, 2004.

Whitehouse, d. The medieval and renaissance pottery "Papers of the British School at Rome" 48, "Tuscania" 1972.

Vroom, j. Byzantine to modern pottery in the aegean: an introduction and field guide, 2005.

The medieval and post-medieval fine wares and cooking wares from the triconch palace and the Baptistery, në r. Hodges, w. Bowden, k. Lako "byzantine Butrint, excavations and surveys 1994-1999", 2004.

DO NOT COPY




Fig. 1




Fig . 2

DO NOT COPY




Fig . 3




Tab. 1

DO NOT COPY




Tab. 2




Tab. 3

DO NOT COPY




Tab. 4




Tab. 5

DO NOT COPY




Tab. 6




Tab. 7

DO NOT COPY

## Abstract

# The medieval and post-medieval pottery from the church of st antonio

The focus of this paper is the medieval and post-medieval pottery found in the church of st antonio, rodon's cape (durrës). In general the definite dating of most of the pottery has been difficult because the material was not found as a result of a stratigraphical research. The dating process has been done by comparing the samples with those found in other areas. According to this the medieval and post-medieval pottery from the church of st antonio in general reflects the characteristics of the unglazed and glazed pottery of the xiv – xix cent. The pottery is mainly represented by local kitchen ware, and fine ware which are mostly imports from northern regions of italy.

This presentation of the limited amount of medieval and post-medieval pottery has provided the opportunity to establish the xiv cent as terminus post quem for church's dating. This dating agrees with the evidences coming from the architectonic study of the church by meksi, meanwhile ippen's dating of the church (xv cent), probably is based in elements which could have taken their complete form after the first phase of church's building.

DO NOT COPY

Uliam ÇIKOPANO

# Mozaikë antikë e paleokristianë në Apoloni

Apollonia e themeluar që në shekullin VI p.e s. bën pjesë në qyetet e mëdha të antikitetit. Përmendet për herë si koloni helene në vitin 583 p.e.s. Të dhënat historike me të hershme sipas Plutarkut tregojnë se korintasit tashmë ishin vendas të ardhur që në kohën e Periandros, shumë më parë se viti 450 dhe ndoshta në gjysmën e dytë të shek.VI p.e.s. 1 Tuqiditi ndërmjet të tjerash thotë se Apolonia ishte koloni e korintasve. Historianë e autorë të tjerë të kohës antike si Polybi, Skylasi, Straboni etj, e përmendin Apollonínë në ngjarjet e rëndësishme të kohës. Ciceroni e cilëson si një qytet shtet të madh e hijerëndë. Një gur miliar i gjetur këtu dëshmon se qyteti antik përfshihej në itinerarin e rrugës Egnatia që nisej nga Durrësi në Apolloni dhe vazhdonte në drejtim të Vlorës rikonstruksioni i kësaj rruge u bë nga perandoria rromake në vitin 146 p.e.s. 2

Kolonitë Helene të ardhura nga Korinti dhe Korkyra (Korfuzi), ngritën qytetin e Apollonisë mbi majën e një kodre jo shumë larg bregdetit Adriatik në luginën midis lumejve Apsus (Semanit) dhe Aoos, (Vjosës). Në kushtet e një pozicioni gjeografik të favorshëm apoloniatët ditën të shfrytëzojnë burimet natyrore, zhvilluan ndjeshëm bujqësinë e blektorinë duke e kthyer në qytet me ekonomi të qëndrueshme një zhvillim të vrullshëm qyteti mori në shek.IV- II p.e s., Kryesisht në fushën e ndërtimit. Në ndërtimet e kësaj kohe, bëjnë pjesë vepra dinjitoze e madhështore si monumenti i Agonotetëve, Odeoni, Teatri, Shetitorja, Fontana etj., që dëshmojnë për një zhvillim të madh dhe për një jetë intensive e luksoze që bënte aristokracia apoloniate. Këtu bëjnë pjesë asamble banesash të pasura qytetare, vepra të ndryshme arti punishte qeramike, atëlie për punimin e gurit etj.

Pas rënies së perandorisë romake dhe largimit të saj nga Iliriku duket se intensiteti i jetës në këtë qytet bie ndjeshëm, informacionet për të janë më të pakta pra duket se populsia ka filluar të largohet dhe qyteti të braktiset. Shkak për këtë braktisje masive duhet të ketë qenë një tërmet i fuqishëm që faktohet nga rrënimet e objekteve publike, banesa me mure të rrëzuara dhe spostime të blloqeve të rëndë prej guri të mureve rrethuese të qytetit. Shkak tjetër i largimit të popullsisë duhet të ketë qenë devijimi i Vjosës që ndikoi ndjeshëm në bujqësi dhe në lundrim. Rënia dhe shkatërimi i Apolonisë si qytet ka filluar në shek. III- IV 3. Më pas në kohën e Justinianit Apollonia bënte pjesë ndër qytetet e preferuara të Perandorisë Romake të Lindjes dhe përfshihej në provincen e Epirit të Ri (Epirus Novas) që ishte nën juridiksionin e Vatikanit. Qyteti me një popullsi relativisht të vogël që tashmë e ka humbur madhështinë e saj kthehet në qendër episkopale. Këtë e dëshmon pjesëmarrja e peshkopëve të saj Eusëbio e Feliks në Koncilet

kishtare të Efesit në vitin 431 dhe në Koncilin e Kalkedonit në vitin 451.

Zbulimi i një mozaiku, Paleokristian nën dyshemenë e ambientit ngjitur me trapezerinë e kishës së Shën Mërisë në Apoloni përkon me periudhën e mbajtjes së Koncilëve atëherë kur Krishtërimi e kishte konsoliduar pushtetin e tij.

Nga zbulimet e deritanishme tre janë zonat që përfaqsojnë artin muziv në Apolloni. (Foto 1) vendin parësor e zë zona d, ku bën pjesë kompleksi i banesave të pasura qytetare të fillimit të shek. I, që ndodhet në anën Veriperëndimore të qytetit mbi fshatin Pojan. 4

Zona g, ndodhet në anën Jugperëndimore të qytetit dhe përfaqsohet nga një banesë me peristil banesa kufizohet nga korridore të shtruara me mozaik floreal e gjeometrik. Motivet kryesore janë rombet, katroret dhe zvastika.

Zona a, ndodhet në pjesën qendrore të qyetit përbri shetitores.Ajo përfaqsohet nga një ndërtësë publike rreth 350 m. Katror ku një pjesë e sipërfaqës është e shtruar me mozaike monokrom, ndërsa korridoret anësore janë të shtruara me pllaka të vogla qeramike të vendosura në forme parketazhi të rregullt

Nuk mund të lëmë pa përmendur zbulimin e fundit por të pa përfunduar në afersi të trapezërisë: bëhet fjale për mozaikun paleokristian të ndërtuar në dy faza dhe në dy tëknika të ndryshme. Është një nga kompozimet me të arritura dhe të punuara me mjaft mjeshtëri aty paraqitën bukur figurat e shtatë kafshëve midis tyre drerë, dhi, derra etj.Brenda një kuadri që kornizohet nga motivi i gershetit dhe i trekëndëshit në vazhdim.

Në interieret e këtyre banesave spikatin vepra dinjitoze të artit të përfaqsuar nga skulptura, skulptura arkitektonike dhe në veçanti nga arti muziv pjesa me e madhe e ambjentëve është e shtruar me mozaike, ndërsa pjesa tjetër me pllaka mermeri. Dhomat e gjumit dhe të pritjes janë të pajisura me sistem ngrohje (hipokaust) ndërsa muret janë të veshura me pllaka mermeri.Mozaikët kryesisht paraqesin motive gjeometrike e floreale dhe me skena të ndryshme nga mitologjia detare.

Mozaikët në Apoloni janë ndërtuar nga mjeshtra anonime, ato janë vepra dinjitoze dhe cilësohen si punime të një niveli të lartë.

Ndërmjet ambientëve veçojme mozaikun e aklit, përsosmëria e të cilit jep imazhin më të përkryer në realizimin teknik e artistik të artit mozaikor në shqipëri.

Gërmimet e para në Apoloni u bënë në vitin 1958-1961. Midis objekteve arkeologjike u zbuluan një numër i madh skulpturash të skalitura në mermer shtatore e relieve të shumta të punuara nga mjeshtrat apoloniaë.Një pjesë e skulpturave janë riprodhime të punuara në shek ii të. Ato përfaqësojnë modelet e skulpturave monumentale të shek. IV p.e.S.

Vlen të përmendim zbulimin e disa objekteve të artit si statuja bronzi në miniature, figurina e enë të ndryshme prej balte të pjekur, një pjesë prej të cilave janë të pikturuara me ngjyrë, ç'ka deshmon për një zhvillim cilësor në fushën e artit dhe të kulturës apoloniate. 5

Sondazhet tregojnë se nëntoka e qytetit antik të apolonisë ka objekte dhe vepra të tjera. Në gërmimet e me vonshme sigurisht do të zbulohen vlera të reja, ato do ta pasurojnë akoma me shume fondin kulturor, dhe do ti japin kontribut të vyer historisë së shqipërisë. (Foto 2) në kompleksin e banesave të pasura ndërmjet ambienteve të shtruara me mozaike, të tërheq vemendjen dhoma e nëreidës që ndodhet në jug të korridorit I. Dyshemeja e saj është e shtruar me mozaike shumëngjyrësh dhe përbëhet prej 3 pjesëve, nga emblema, kuadrati i madh,dhe nga korniza.

Emblema që ndodhet brenda një tetëkëndeshi përmban një nga kompozimet me të realizuara ku nëreida lundron mbi një delfin.(Foto 3) ky kompozim përbën subjektin kryesor të veprës. Jashtë

DO NOT COPY

formës tetëkëndeshe në kuadratin e madh janë vizatuar katër hipokamfe (kuaj deti) brenda gjysëm rrathëve, ndërsa në fushat e krijuara janë vizatuar peshq të ndryshëm. (Foto 4)

Pjesët anësore që kufizohen me muret e dhomës mbyllen me një kornize të gjerë të katërfishtë ku dominojnë motive të thjeshta si dopjo gersheti, rrombet dhe trekendëshi i përseritur. Mozaiku është realizuar me tëknika të alternuara, duke përdorur opus tësëllatum për sfondin dhe opus vermiculatum për figurat.

Ambjenti nr 2 akili është nga me të bukurit të realizuar në Shqipëri si në aspektin kompozicional e koloristik ashtu edhe në ekzekutimin teknik të tij. Kompozimi, me skena nga lufta e amazonave përbehet nga katër pjesë. Aty paraqitën figura të ndryshme luftëtarësh të armatosur me mjetet e kohës që ndeshën me amazonat (foto 5)

Në skenën e pare shohim një helen të sulmuar nga amazonat i cili është dorëzuar duke rënë në gjunjë me dorën e djathtë të ngritur lart.

Në skenën e dytë një luftëtar helen sulmon njëren prej amazonave, ndërsa në skenën e tretë dallohen këmbet e një kali dhe një mburoje që ka rënë në tokë. Pjesa qendrore e kësaj skene është e dëmtuar. (Foto 6)

Me e kompozuara dhe më interesante është skena e katërt.Aty paraqitet madhështore figura e akilit legjendar duke mbajtur në krahe mbretëreshen e amazonave pentënsilenë, të plagosur prej tij për vdekje.(Foto7)

Kompozimi nuk është i plotë.Në figurën e pentësilesë mungon portreti

Por dallohen qartë dhe të vizatuara bukur, trupi, këmbët, duart dhe flokët që i varen poshtë. Akili e mban në krahë, trupi i saj duket sikur po i rreshqet nga duart, ndërsa ai e ka ngulur shikimin në fytyrën e viktimës duke e parë me keqardhje. Kompozimi mbyllet prej një kornize të gjerë të përbërë nga pesë rjeshta me motive gjeometrike të ndryshme.

Në realizimin e këtij mozaiku janë përdorur dy teknika, opus të sëllatum

Për sfondin dhe opus vermiculatum për figurat.

Mozaiku ka një gamë të pasur koloristike, aty janë përdorur tëssëra natyrale e artificiale me ngjyra e tonë të ndyshme duke i dhënë më shumë volum e dritëhije figurave njërezore dhe veprës së artit në tërësi.

Ambjenti n 3. Qilimi është një mozaik i zbukuruar me motive gjeometrike me pamjen e një qilimi shumëngjyrësh i cili e mbulon të gjithë sipërfaqen e dhomës.(Foto8-9)

Në qendër të saj është emblema, me një lule gjashtë fletëshe që lidhet me dyzet e tëtë rrathe koncentrike që ndërpritën. Aty formohen trekëndesha të vegjël bardh e zi që të japin imazhin një disku rrotullues.(Foto 10 )

Emblema rrethohet nga trekëndësha dhe drejtkëndësha që përsëriten deri në kufi me kuadratin e madh që mbyllet me motivin e gershetit. Jashtë tij formohet një kornize e trefishtë me motive të ndryshme si zvastika, vija e thyer dhe rrombi i vazhduar. Mozaiku është punuar në opus tëssëllatum me tëssëra natyrale.

Dhoma kuadratike apo ambjenti nr.4 Me dimensionë 5x5ml është dekoruar me mozaik shumëngjyrësh. Brenda një kuadrati të madh që përfshin pothuajsë të gjithe dhomën janë vizatuar katër kuadratë me të vegjel të kornizuara dhe të vendosura në menyrë simetrike. Aty janë realizuar motive me gershetin e ndërthurur.Vizatimi mbyllet me kornizën që formohet nga bashkimi i motiveve të gershetit të dyfishtë dhe i rratheve kocentrike. (Foto 11)

Ambjenti nr 5. Është një panel i vogël 1 x 2.5 ml që ka mbetur i pa dëmtuar dhe ka një kombinim të bukur midis figurave gjeometrike .Ato ndërthuren me njëra tjetrën dhe formojnë figura të reja me tone e gjysëm tone me të errët (foto 12)

Në plan të parë janë rombet që lidhen zinxhir me njëri-tjetrin, ndërsa në hapësirat e krijuara mid-

DO NOT COPY

is tyre janë vizatuar katrore me motive të thjeshta mbi një sfond të zi.

Mozaiku i ambjentit nr.10 Me dimensionë 5 x 6ml ka të vizatuar motivin e rrathëve që ndërpriten kryesisht me tëssera bardhë e zi, në qendër është një katror ku brendashkruhen dy katrorë të tjere më të vegjël me pjesën qendrore të dëmtuar. Kufizohet me një kornizë të dominuar prej vijës së lakuar të mbushur me gjethe akanthi. (Foto13)

Ambjenti nr 11 aktori, përbëhet nga emblema dhe nga një kuadrat me brinjë të valëzuara që ka si motiv kryesor gershetin, (foto 14) ndërsa në qendër të saj brenda një rrethi të vogël është portreti i një aktori.(Foto15)

Kuadratë të tjerë me brinjë të valezuara të vizatuar njëri pas tjetrit krijojnë hapësira të vogla të mbushura me rrathë të vegjël brenda të cilëve janë vizatuar gjethe katërfletëshe.

Kompozimi mbyllet nga një kornizë e hollë që përbëhet prej gërshetit të dyfishtë të shoqëruar nga të dy krahët me rrjeshta të zinj.

Ambjenti nr 7 ndodhet në perëndim të banesës tërmale është një korridor në trajtën e shkronjës I me gjatësi të përgjithëshme 42.5ml dhe me gjerësi 4 ml i shtruar me mozaike bardh e zi. Është realizuar në opus tessellatum dhe me një motiv të vetëm të përbëre nga rrathe koncentrike.(Foto 16) rrathët ndërpriten dhe formojnë figura floreale. Në krahun gjatësor korridori kufizohet nga një kuadrat brenda të cilit janë kompozuar figura të ndryshme si pemë, gjethe e lule të realizuara me ngjyra të ngrohta.

Ambjenti pranë trapezerisë ndodhet brenda në oborrin e manastirit, në drejtimin verior të tij, rreth tetë metra larg ekzonartëksit të kishës së shën mërisë në apolloni.

Trapezeria së bashku me ambjentin pranë kanë shërbyer si dhoma ngrënie për besimtarët dhe pjestaret e kishës. Muret e saj janë ndërtuar me gurë dhe midis tyre të bien në sy blloqe guri të punuar, fragmente kollonash, friza e pjesë kapitalesh të murosura të hequra nga monumentë të tjere të përiudhës antike. Është ndërtim i shek. Xiii-të i ndërtuar mbi një monument me të hershëm. Gërmimet që u bënë në truallin e këtij ambjenti zbuluan një dysheme të shtruar me mozaik që i takon dy fazave të ndryshme ndërtimi. (Fot.17) Por më e rendësishme është kompozimi i përkryer në panelin paleokristian ku janë vizatuar kafshe dhe bime të ndryshme brendashkruar një drejtkëndëshi. (Foto18) kompozimi mbyllet prej një kornize të dyfishtë nga figurat e kafshëve veçojmë atë të kaprollit që qendron në këmbe me kokë të kthyer mbrapa, si dhe kompozimin dy figurësh që tregon lopen dhe vicin duke pirë. (Foto 19) bukur janë vizatuar edhe figurat e dy derrave që qendrojnë përballe njëri tjetrit. E gjithë skena ka përmbajtje biblike që presupozon kalimin e tyre në parajsë.

Mozaiku paleokristian është ndërtuar rreth mesit të shek.V. Gjatë restaurimit dhe nivelimit të sipërfaqës së mozaikut u zbuluan pjesë të tjera mozaiku ku tesserat ishin futur brenda rudusit gjatë hedhjes së mbeturinave për mbushjen dhe nivelimin e ndërtimeve që u bënë në shek. E XIII. Midis tesserave natyrale u gjenden disa të tjera të prodhuara artificialisht me brumë qelqi. Ato kanë ngjyrë jeshile smerald dhe u gjetën shumë të fragmentuara.Një pjesë e tyre u vendosën të bashkuara atje ku u gjetën për ti ruajtur si dëshmi të ekzistencës së tyre në ketë panel. Është i njohur përdorimi i tyre në mozaikët paleokristanë, ato i gjejmë në mozaikët e linit, në bazilikat e bylisit, në sarandë, butrint etj. Në së do të krahasojmë nënshtresat e mozaikut të shek. I me atë të panëlit paleokristian ndryshimet janë të dukëshme ashtu si materiali ndërtimor, tesserat dhe ikonografia.Në përfundim mund të themi së kemi të bëjmë me një ndërtim të përiudhës antike të transformuar apo të modifikuar në një ambient kulti të shek.V.

Banesa me peristil bën pjesë në banësat e

DO NOT COPY

pasura qytetare të ndërtuara në shek.I-II (Foto20) është një nga ndërtimet me cilësore si në aspektin arkitektonik ashtu dhe në atë zbukurimor që përfshin interierët e saj. Banesa me një oborr të shtruar me blloqe gurësh gëlqeror ka në mes të saj një tetëkëndësh të kornizuar me bordure guri të punuar me mjështëri. Duhet të ketë qenë ambjent dekorativ në përdorim, ndoshta një fontanë me dysheme të shtuar me mozaike. Këtë e dëshmon gjetja e një sasie të konsiderueshme tesserash bardh e zi të dimensionëve deri në 2 cm. Oborri rrethohet nga një hajat i shtuar me mozaikë gjeometrike e floreale ku janë përdorur pak ngjyra si e bardha e zeza, grija dhe ngjyra roze (foto21, 22)

Hajati lidhet me ambjentet ndihmëse të ngrënies, të fjetjes dhe të ndenjies. Krahu perëndimor i banësës nuk ekziston dhe është prishur për shkak të relievit të pjerrët. Në këtë krah duhet të ketë qenë portiku i hyrjes për në banesë. Gjatë gërmimeve arkeologjike midis të tjerave u zbulua shtatorja e Athinasë dhe portreti i një filozofi të punuara në mermer. (Foto23,24) ato janë vepra që i përkasin shek. IV p.E.S. Këto vepra sot ndodhen të ekspozuara në sallën e antikitetit të muzeut historik kombëtar në Tiranë. Krahas punimeve restauruese të karakterit mirëmbajtes në mozaike, u bënë sondazhe e pastrime brenda tetëkëndëshit që ndodhet në qendër të oborrit. Pas gërmimit dhe heqjes së shtresës së dheut prej 30 cm dolen 2 trakte muri tulle të lidhura me llaç gëlqere dhe një vaskë e sheshtë e veshur me pllaka prej balte të pjekur rreth 6x6 cm. Ka formën e drejtëkëndëshit dhe kornizohet me tulla të gdhendura duke formuar një bordurë të cekët përqark saj. Vaska nuk ishte ndërtuar në qendër të tetëkëndëshit por pak sa e spostuar nga jugu. Nga shtresa e gërmimit doli matërial i pasur arkeologjik, ndërmjet tyre pati fragmentë enësh prej qeramike me paretë të holla dhe një sasi e konsiderueshme tesserash mozaiku gelqëror, ngjyrë të bardhë e gri të errët.

Banesa publike paraqitet si një rast i veçantë në zgjidhjen e saj arkitektonike me hapësirë të madhe në ambientin qëndror dhe me koridore të ngushta përqark tij. (Foto25) ambienti qëndror, me sipërfaqe rreth 110 m² ka qenë i shtruar me mozaike monokrom me tessera të bardha me madhesi deri në 3x3 cm. (Foto26)

Mozaiku me gjithesë pjesërisht i prishur i ruan vlerat e veta për sa i takon teknikës së ndërtimit dhe shpërndarjes së harmonishme të tesserave. Është punuar në tekniken opus tessellatum mbi një suport shumë të trashë që arrin deri në 13 cm. Një shtresë e tille rudusi përbën një rast unikal në zbulimet e derisotme të Apolonisë.

Koridoret anësore me gjerësi 3m janë shtruar me pllaka të vogla qeramike të vendosura njëra pas tjetrës, në formën e një parketi të rregullt. (Foto27)

Banesa kufizohet me blloqe të rëndë gurësh shtufore dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 350m2. Pra siç shihet banesa ka qenë një ambient publik i rëndësishem i ndërtuar në shek. I.

Ambjenti nr. 2 (Faltorja) përbëhet nga dy ambiente. Njëri prej tyre është një dhomë e vogël me dysheme të thjeshtë të shtruar me pllaka balte të pjekur që ka shërbyer si ambjent ndihmës. Dhoma kryesore me përmasa 6x7 metra e shtruar me mozaike duket së ka shërbyer si qendër religioze në këtë lagje që ndodhet në veri perëndim të apollonisë.Gjatë pastrimit dhe konservimit të sipërfaqes mozaikore të kryera në qershor-tetor 2006 në anën perëndimore të dhomës u zbuluan figura të ndryshme të vizatuara me tëssëra ngjyre rozë që përfaqësojnë specie nga bota ujore. Ato janë të paqarta për shkak të dëmtimit të madh që ka ndodhur aty. Është e qartë vetëm figura e një karavidheje që u gjet pjesërisht e dëmtuar. (Foto 28-29) në anën lindore të kornizës, që mbyll kompozimin, gjejmë të vizatuar një vazo (kupe) nga e cila dalin e harlisen lastare e gjethe të

DO NOT COPY

akanthit. (Foto30) ky motiv përfaqëson elementin kryesor në kompozimin e eukaristisë. Në qendër brenda kuadratit të madh dallohet figura e një shpendi që ka ngjashmëri me rosën. Sondazhet në nënshtresë treguan strukturën e dobët të shtresës së mozaikut, që është karakteristikë e shtresave mozaikore të periudhës paleokristane. Tesserat u gjetën të shkëputura nga rudusi dhe rrinin të lidhura nga një lloj llaçi i përzier me baltë. Pasi stabilizuam tesserat që konturonin linjat e figurave të më sipërme dhe tesserat brenda figurave vazhduam me tëj me pllombimet e me pas me mbushjen lakunave në të gjithe zonën e demtuar.Llaçi në ngjyrë rozë që u përdor në mbushjen e lakunave u përgatit me pluhur vullkanik, me pluhur guri të kuq dhe me gelqere të vjetër. Pas këtij operacioni dhe integrimit të lakunave me sipërfaqen mozaikore gjendja u stabilizua duke përfituar një sipërfaqe të qëndrueshme. 6 Me rëndësi është dhe fiksimi i tesserave të figurave të pa kuptueshme të cilat në të ardhmen do të jenë objekt studimi. Ajo që vlen të përmendet është së pas zbulimit arkeologjik, identifikimi apo përshkrimi i ketij ambjenti nuk është cilësuar si një faltore apo vend kulti. Autorët e gërmimit mbi bazën e materialit arkeologjik të zbuluar e datojnë në shek.I re dhe sugjerojnë së dhomat kanë shërbyer si ambientë banimi luksoze në sherbim të aristokracisë vendase. 7 Duke u bazuar nga motivet dhe elementët stilistike, duket se këtu mbizotërojnë motive të simbolikës paleokristiane të përdorura që në hapat e para të krishtërimit.

DO NOT COPY

1- Francesco ercole rivista d'albania marzo 1941 fq.128.
2- Miller ir col 516-527 Ilirët dhe Iliria të autorët antikë fq.311.
3- Aleksandra Mano Apolonia e Ilirisë Tiranë 2006 fq. 32
4- Hasan Ceka Apolonia Tiranë 1958 fq.12-13. H.Sh.Tiranë 1959 fq.185
5- V.D. Bllavatski, Selim Islami gërmimet në Apolloni dhe Orik gjatë vitit 1958. Fq. 51 Bul. Shk.Shoq. 1960 \ I
6 - Në ndërhyrjet konservuese restauruese dhe dokumentuese të kryera në Apolloni në vitin 2006 morën pjesë restauratorët e sektorit të artit të I.M.K. Spiro Laçka, Olta Kore dhe restauratorja e drejtorisë rajonale të monumenteve Tiranë, Silvana Berhani.
7- Dhimosten Budina, Spiro Koço punimet restauruese në disa mozaikë në qytetin e Iashtë të Apolonisë. Fq. 217 Monumentet 1974 7-8.

DO NOT COPY




Foto 1

DO NOT COPY




Foto 2

DO NOT COPY



*Foto 3*




*Foto 4*

DO NOT COPY



*Foto 5*




Foto 6



Foto 7

DO NOT COPY

DO NOT COPY



*Foto 8*

DO NOT COPY




Foto 9



Foto 10

DO NOT COPY



*Foto 11*

DO NOT COPY



Foto 12



Foto 13

DO NOT COPY



*Foto 14*

DO NOT COPY



*Foto 15*



*Foto 16*

DO NOT COPY



*Foto 17*

DO NOT COPY



*Foto 18*

DO NOT COPY



*Foto 19*

DO NOT COPY



*Foto 20*

DO NOT COPY



*Foto 21*

DO NOT COPY



*Foto 22*

DO NOT COPY



*Foto 23*

DO NOT COPY



*Foto 24*

DO NOT COPY



*Foto 25*

DO NOT COPY



*Foto 26*



Foto 27



Foto 28

DO NOT COPY

DO NOT COPY

# Antic and paleochristian mosaics in Apollonia

During the Justinian period Apollonia was one of the most preferred towns of the Roman Empire of the East which was included in the region of New Epirus( EPIRUS NOVAS) which was under the juridiction of Venedict.

The discovery of a paleochristian mosaic under the floor of an ambience close to the trapezoid of the 'Saint Maria" church in Apollonia fits the period of conciles, time when christianity had consolidated its power.

The surveys up to now discovered three main zones which reprezent the mosaic art in Apollonia. (photo 1). The main zone is zone D, where is included the rich houses of the town which belong to the I st century, located in the North- west part of the town over the village of Pojan.4

Zone G, is located in the south –west part of the town and it is represented by a house with peristil. This house is surrounded by corridors with floral and geometric shape mosaic.

Zone A is located in the central part of the town close to the stoa. It is represented by a public building with a surface of 350m2. A part of the surface is covered with monocrom mosaics, while the side corridors are covered with small ceramic tiles placed in regular parketazh shape.

The first excavations in Apollania were done in 1958-1961. Apart from the archaeological objects were discovered a grate number of sculptures carved in marble done by the craft men in Apollonia. A number of sculptures are redone in the Ii century. They represent the models of monumental sculptures.

DO NOT COPY